- **Avancimi profesional për zbatimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunë.**
- **Ngritja e kapaciteteve për përkthyes** përmes trajnimeve dhe pjesëmarrjes në seminare të organizuara nga Komuna, Qeveria, Ministritë përkatëse dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare.
 - Trajnime, seminare dhe punëtori profesionale.
 - Shkëmbimi i përvojave të mira ndërmjet përkthyesve të komunave të Republikës së Kosovës, vendeve fqinje dhe vendeve të Bashkimit Evropian, lidhur me praktikën e përdorimit të gjuhëve zyrtare në administratën lokale.
- **Bashkëpunimi me institucionet qendrore** dhe zbatimi i Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë, si dhe i Rregullores komunale për përdorimin e gjuhëve zyrtare.
 - Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve me të gjitha Drejtoritë komunale lidhur me zbatimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare.
 - Zbatimi në praktikë i Rregullores mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunë.
- **Strategjia e punëve në përkthim në secilën Drejtori.**
- **Njoftimi dhe implementimi i përgjithshëm** i Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe i Rregullores së komunës për përdorimin e gjuhëve zyrtare.
 - Dërgimi i dokumenteve përmes shërbimit digjital për përkthim, kthimi dhe shpërndarja te pala përkatëse.
 - Komunikimi zyrtar dhe digjital ndërmjet drejtorive dhe Zyrës së Përkthimit, pa pasur nevojë që pala të jetë ndërmjetëse në këtë proces.
 - Përkthimi i të gjitha rregulloreve dhe akteve të tjera normative të miratuara nga Kuvendi i Komunës, si dhe i vendimeve të ndryshme, me qëllim informimin e qytetarëve për punën e Komunës në përgjithësi.
 - Bashkëpunimi me donatorë dhe partnerë të tjerë në fushën e përkthimeve.
 - Përkthimi i të gjitha dokumenteve dhe akteve të tjera të drejtorive dhe organeve të Komunës që dërgohen në Zyrën e Përkthimit.
- **Përgatitja e raportit vjetor të punës** dhe realizimi i Planit vjetor të paraparë.

- **Planifikimi i punëve nga Sektori për Teknologji Informative për vitin 2026**

- **Objektiva I:** Ngritja e kapaciteteve të stafit nga Sektori për Teknologji Informative.

- **Aktiviteti 1:** Organizimi i seminareve, trajnimeve profesionale specifike dhe punëtorive për avancimin e shërbimeve elektronike, digjitalizimin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe trajnimi i SHCK-së dhe stafit të TI-së.
- **Aktiviteti 2:** Vizita pune në vendet fqinje dhe në komunat e Kosovës me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe implementimit të ideve dhe praktikave të reja në punë.

- **Objektiva II:** Furnizimi me kamera, pajisje të zërimit dhe pajisje të tjera digjitale për Administratën komunale dhe objektet e SHCK-së.

- **Aktiviteti 1:** Mirëmbajtja dhe blerja e kamerave për objektet e SHCK-së.
- **Aktiviteti 2:** Mirëmbajtja dhe blerja e kamerave të qytetit.
- **Aktiviteti 3:** Blerja dhe vendosja e panove digjitale njoftuese në objektet e Administratës komunale.
- **Aktiviteti 4:** Blerja e pajisjeve të zërimit dhe softuerit për sallën e Asamblesë Komunale.
- **Aktiviteti 5:** Shtirja e rrjetit të internetit (fibër optike) në qytet për nevojat e komunës.

- **Objektiva III:** Avancimi i teknologjisë dhe rritja e kapaciteteve për ruajtjen e të dhënave.

- **Aktiviteti 1:** Hapja e një hapësire të centralizuar për ruajtjen e të dhënave për zyrtarët komunalë, ku secili zyrtar do të ketë hapësirë të veçantë për ruajtjen e të dhënave.
- **Aktiviteti 2:** Krijimi i bazave të të dhënave sipas kërkesave të drejtorive, të adresuara përmes Drejtorisë për Administratë.
- **Aktiviteti 3:** Blerja dhe zëvendësimi i kompjuterëve të vjetër me pajisje të reja, me teknologji bashkëkohore (p.sh. Windows 11), me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e efikasitetit të punës.
- **Aktiviteti 4:** Mirëmbajtja dhe avancimi i E-kioskut për ofrimin e shërbimeve cilësore 24/7 për qytetarët, përfshirë shtimin e shërbimeve të reja si lëshimi i kopjeve të planeve (në koordinim me ASHI-në) dhe digjitalizimin e QSHQK-së.

- **Objektiva IV:** Projekte që planifikohen të realizohen në rast të sigurimit të financimit nga grante apo donatorë.

- **Aktiviteti 1:** Projekti **Smart City (Qyteti i Mençur)** – avancimi i të gjitha shërbimeve digjitale brenda territorit të qytetit.
- **Aktiviteti 2:** Vendosja e radarëve në hyrjet e qytetit (nga Prishtina, Mitrovica dhe Deçani).

- **Objektiva I:** Mirëmbajtja dhe funksionalizimi i objekteve komunale.
 - **Aktiviteti 1:** Mirëmbajtja e objekteve komunale të administratës.
 - **Aktiviteti 2:** Mirëmbajtja e objekteve të zyrave të vendit në fshatra.
 - **Aktiviteti 3:** Mirëmbajtja e sistemeve të ngrohjes qendrore në objektet komunale.
 - **Aktiviteti 4:** Furnizimi me derivate për ngrohje gjatë sezonit dimëror.
 - **Aktiviteti 5:** Monitorimi i sigurimit fizik të objekteve komunale jashtë orarit të punës.
- **Objektiva II:** Menaxhimi i shërbimeve të pastrimit dhe mirëmbajtjes teknike.
 - **Aktiviteti 1:** Mbikëqyrja e shërbimeve të pastrimit në të gjitha objektet komunale.
 - **Aktiviteti 2:** Koordinimi me operatorët ekonomikë për pastrimin e objekteve publike.
 - **Aktiviteti 3:** Mirëmbajtja e pajisjeve teknike dhe administrative.
- **Objektiva III:** Menaxhimi i materialit shpenzues dhe inventarit.
 - **Aktiviteti 1:** Furnizimi me material shpenzues për drejtoritë komunale.
 - **Aktiviteti 2:** Menaxhimi i depozitimit dhe shpërndarjes së materialeve shpenzuese.
 - **Aktiviteti 3:** Evidentimi i të gjitha pajisjeve dhe inventarit përmes sistemit **e-Pasuria**, përfshirë furnizimin dhe raportimin.
- **Objektiva IV:** Menaxhimi i automjeteve dhe pajisjeve energjetike.
 - **Aktiviteti 1:** Mirëmbajtja teknike dhe servisimi i veturave zyrtare të komunës.
 - **Aktiviteti 2:** Furnizimi me derivate për automjetet zyrtare.
 - **Aktiviteti 3:** Menaxhimi dhe evidencimi i përdorimit të veturave zyrtare.
 - **Aktiviteti 4:** Mirëmbajtja dhe testimi periodik i gjeneratorëve elektrikë.
- **Objektiva V:** Mbështetja logjistike për organet dhe aktivitetet komunale.
 - **Aktiviteti 1:** Mbështetja logjistike për mbledhjet e Kuvendit Komunal.
 - **Aktiviteti 2:** Mbështetja logjistike për aktivitetet dhe ngjarjet zyrtare të Komunës.
 - **Aktiviteti 3:** Zbatimi i vendimeve të Kryetarit dhe Drejtorisë për Administratë në fushën e logjistikës.
 - **Aktiviteti 4:** Bashkëpunimi me drejtoritë komunale për identifikimin e nevojave logjistike.
 - **Aktiviteti 5:** Menaxhimi i kërkesave logjistike nga zyrat e vendit.
- **Objektiva VI:** Menaxhimi financiar dhe administrativ i shpenzimeve komunale.
 - **Aktiviteti 1:** Përgatitja e lëndëve për pagesa nga të gjitha Drejtoritë, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, për kompletimin e dokumentacionit, **vendosja dhe aprovimi i lëndëve në sistemin përkatës**, si dhe **procedimi i tyre për vazhdimin e pagesës në DBF**.
 - **Aktiviteti 2:** Realizimi i pagesave për të gjitha obligimet komunale (energji elektrike, ujë, mbeturina, shërbime të tjera).
- **Objektiva VII:** Monitorimi, raportimi dhe respektimi i procedurave.
 - **Aktiviteti 1:** Mbikëqyrja e kontratave logjistike në nivel komunal.
 - **Aktiviteti 2:** Përditësimi i të dhënave logjistike në sistemet e brendshme komunale.
 - **Aktiviteti 3:** Zbatimi i procedurave të brendshme dhe rregulloreve komunale.
 - **Aktiviteti 4:** Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore të sektorit.
 - **Aktiviteti 5:** Realizimi i detyrave të tjera logjistike sipas nevojave institucionale të Komunës së Pejës.

Objektiva I: Planifikimi dhe koordinimi i punës së Ekipit për Mbrojtjen e Fëmijëve (EMF)

- Planifikimi i takimeve të rregullta të EMF-së për vitin 2026.
- Organizimi i takimeve tremujore (4 takime gjatë vitit) me pjesëmarrjen e anëtarëve të EMF-së dhe përfaqësuesve të drejtorive komunale.
- Koordinimi institucional, zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve të Planit të Punës (2024–2026).
- Përgjegjës: Kryesuesi i EMF-së dhe Sekretariati, në kuadër të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

Objektiva II: Bashkëpunimi ndërsektorial me drejtoritë komunale

- Planifikimi i takimeve tematike me drejtoritë komunale relevante (Mirëqenie Sociale, Arsim, Shëndetësi, Urbanizëm dhe Shërbime Publike, Kulturë, Rini dhe Sport).
- Zhvillimi i 1–2 takimeve vjetore për secilën drejtori, sipas nevojës.
- Harmonizimi i veprimeve dhe zbatimi i aktiviteteve specifike për fëmijë, në përputhje me objektivat e Planit të Punës 2026.

Objektiva III: Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të planit

- Realizimi i dy takimeve monitoruese dhe raportuese (gjysmëvjetore dhe vjetore).
- Vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve, përgatitja e raporteve periodike dhe nxjerrja e rekomandimeve për përmirësim.
- Përgjegjës: EMF dhe drejtoritë komunale përkatëse.

Objektiva IV: Bashkëpunimi me partnerë institucionalë dhe organizata joqeveritare

- Planifikimi i takimeve koordinuese me institucione lokale dhe qendrore, si dhe me OJQ që veprojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.
- Harmonizimi i bashkëpunimit për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta gjatë vitit 2026.

Objektiva V: Fuqizimi i pjesëmarrjes së fëmijëve përmes Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF)

- Hartimi dhe miratimi i **Planit të Punës së AKF-së për vitin 2026**, si pjesë përbërëse e Planit Komunal për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve.
- Organizimi i takimeve të rregullta të AKF-së, fushatave vetëdijesuese, aktiviteteve kulturore, sportive dhe edukative.
- Shënimi i datave të rëndësishme për të drejtat e fëmijëve dhe hartimi i rekomandimeve për institucionet komunale.
- Përgatitja e raportit vjetor të punës së AKF-së.

Objektiva VI: Organizimi i zgjedhjeve të brendshme për AKF

- Mbajtja e takimeve informuese në SHFMU-të e Komunës së Pejës gjatë muajit tetor 2026.
- Informimi mbi procedurat zgjedhore, rolet dhe përgjegjësitë e akterëve përfshirës.
- Garantimi i një procesi demokratik, transparent dhe gjithëpërfshirës për zgjedhjen e anëtarëve të AKF-së.
- Monitorimi i procesit në përputhje me kornizën ligjore dhe rregulloret në fuqi.

Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë

Nita Panduri Mullarama



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E PEJËS
OPŠTINA PEĆ
MUNICIPALITY OF PEJA



DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE HIDROEKONOMISË

Plani i Punës për vitin 2026



Objektivat kryesore të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

1.Krijimi i kushteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese, menaxhim të qëndrueshëm të resurseve natyrore (tokën, kullosat dhe ujin), modernizimi i bujqësisë, tërheqja e investimeve për të krijuar një mjedis favorizues për rritjen e mirëqenies së qytetarëve në viset rurale të Komunës së Pejës.

2.Zbatimi i projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetës dhe punës përmes:

- a) Investimeve kapitale (penda dhe kanale të ujitjes)
- b) Ofrimi i shërbimeve këshillimore (ngritja e kapaciteteve të fermerëve në menaxhimin e fermave dhe aplikimin e teknologjive të avancuara në prodhimtarinë bujqësore)
- c) Mbështetje për sektorin e blegtorisë, bletarisë, perimkulturës, pemëtarisë, pemëve të imëta dhe bimëve mjekuese
- d) Hulumtimi i burimeve financiare për grante dhe subvencione në sektorin e bujqësisë
- e) Mbështetje për iniciativa e reja të fermerëve në prodhimtarinë bujqësore (ngritjen e cilësisë dhe sasisë të prodhimeve bujqësore)

3.Bashkëpunimi me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare, bizneset lokale dhe të jashtme, drejt realizimit të projekteve zhvillimore komunale për një ambient më të mirë të zhvillimit ekonomiko-bujqësore.

OBJEKTIVAT E DBPH PËR VITIN 2026	AKTIVITETET PËR ARRITJEN E KËTYRE OBJEKTIVAVE	AFATI KOHOR	REZULTATET E PRITURA
1.Mbështetja financiare e kërkesave të fermerëve	Shqyrtimi i të gjitha kërkesave në afate kohore dhe subvencionimi financiar në bazë të planifikimit buxhetor, sipas llojit të kërkesës	Varësisht nga kërkesat	Përmirësim i gjendjes ekonomike tek ekonomitë familjare të fermerëve, kompenzim i dëmeve të shkaktuara etj.
2.Subvencionet nga Drejtoria e Bujqësisë	2.1 Shpallja e Thirrjes Publike për “Furnizim me mekanizëm bujqësor – TRAKTOR , për fermerët e Komunës sonë”, në bazë të Rregullores Komunale për Ndarjen e Subvencioneve 01/2017. 2.2 Thirrja Publike për Subvencionim me mjedër në sipërfaqe 2ha.	Shkurt-Mars	Lehtësimi kushteve të punës dhe ngritja e kapaciteteve prodhuese tek fermerët.
3.Bashkëpunimet me donatorë	Shqyrtimi i mundësive për lidhjen e marrëveshjeve me bashkëfinancim me donatorë të huaj.	Shkurt - Dhjetor	Avancim i bashkëpunimit që sjell rritje të përfitimeve financiare dhe aseteve fizike për fermerët.
4.Aktivitetet e Drejtorisë për Bujqësi	4.1 Mbajtja e sesioneve informuese me fermerë rreth aplikimit për subvencione dhe grante për vitin 2026 4.2 Pranimi i aplikacioneve të fermerëve për Pagesa Direkte nga MBPZHR 4.3 Përgaditja e planit për mbjellje pranverore dhe vjeshtore si dhe përcjellja e afatit të korrje-shirjeve 4.4 Vlerësimi i dëmeve të mundshme në bujqësi nga fatkeqësit e ndryshme natyrore 4.5 Monitorimi i kontratave të inv.kapitale të cilat kanë mbetur pa përfunduar nga viti kaluar/ 4.6 Shënimi i festave dhe ditëve ndërkombëtare të Bujqësisë: Dita Botërore e Ujit, Dita e Tokës, Dita Botërore e Bletëve, Dita Botërore e	4.1 Janar-Qershor 4.2 Varësisht nga afati i shpalljes nga AZHB 4.3 Qershor-Dhjetor 4.4 Sipas kërkesave 4.5 Mars-Qershor 4.6 Sipas datave të caktuara në kalendarin e festave të Bujqësisë	4.1 Rritja e numrit të përfituesve të subvencioneve 4.2 Përfitojnë të ardhura financiare më shumë se 2000 fermerë. 4.3 Rritja e sipërfaqeve të kultivuara, minimizimi i humbjeve nga përdorimi i inputeve të duhura dhe përdorimi i makinerisë së avancuar për korrje 4.4 Kompenzim i dëmeve të shkaktuara me qëllim të zvogëlimit të humbjeve tek fermerët 4.5 Zbatimi i kontratave dhe përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes 4.6 Shënimi i këtyre ditëve ndihmon për të promovuar bashkëpunimin mes komuniteteve, shkëmbimin e përvojave dhe mbështetjen e prodhimit

	Ushqimit (një nga më kryesoret për bujqësinë).		vendor.
5. Investimet kapitale 5.1 Përpilimi i paramesave të reja për 5 LOTE dhe shpallja e tenderit dhe lidhjen e kontratave për vitin 2026-2027	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në këto fshatra: Baran I Ulët, Baran I Epërm, Çallapek, Kosuriq ,Penda e Vranocit dhe Broliq -LOT 1 Loxhë, Vragoc, Dobërdol, dhe Graboc - LOT 2 Pavlan, Gllaviqicë, Ramun, Leshan dhe Kliqinë - LOT 3 Trestenik, Nabërgjan, Llabjan, Dardania III, Ruhot dhe Nakëll-LOT 4 1. LOT 1- Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fsh.e Lugut të Baranit 2. LOT 2- Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fsh.e Podgurit 3. LOT 3- Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fsh.e Trestenikit 4. LOT 4- Ndërtimi i kanaleve në fsh.e Lugut Leshanit 5. LOT 5- Ndërtimi i kanaleve tek Fusha e Pejës	Vazhdim i monitorimit dhe mbikëqyrjes së punimeve sipas kontratave të nënshkruara Mars-Qershor	Rritja e sipërfaqeve të tokave bujqësore në ujitje, rritja e rendimenteve të prodhimeve bujqësore etj.
6. Subvencionet e MBPZHR	6.1 Afati i aplikimit për TM2 të vitit 2025 6.2 Afati i aplikimit për Pagesa Direkte 2026 6.3. Afati i aplikimit për pleh dhe sasi të dorëzuar të grurit	Varësisht nga afati i shpalljes nga AZHB	Përkrahja e financiare e me shumë se 2000 fermerëve
7. Aktivitetet e Qendrës Informuese Këshillimore (QIK)	7.1 Kontakte e vizita në ferma dhe kultivuesit e kulturave të ndryshme bujqësore 7.2 Trajnim për këshilltar 7.3 Demonstrime në fushë 7.4 Informacione të përgjithshme për zonën, burime njerëzore, klimatik-tokësore, struktura, potencialet prodhuese etj.	Gjatë gjithë vitit kalendarik	Fermerët do të kenë informata dhe këshilla të nevojshme në kohë të duhur, qoftë duke u informuar direkt në fermë apo edhe në zyret e DBPH.

10.Monitorimi i Vendgjuetive të Përbashkëta në Komunën e Pejës	Vizita të kohëpaskohshme në terren nga menaxheri i kontratës në	Gjatë sezonës së Gjuetisë	Mbrojtja, shtimi i kafshëve si dhe kultivimi i florës dhe faunës në këto dy Vendgjueti
11.Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës	Trajtimi i qenëve endacak sipas kontratës së nënshkruar dhe sipas planit operativ të Drejtorisë	Gjatë gjithë vitit kalendarik	Zvogëlimin e rrezikut nga qentë endacak në rrugë dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës”

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Plani i Punës për vitin 2026 i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa përcakton aktivitetet, përgjegjësitë dhe afatet kohore për realizimin e detyrave financiare dhe buxhetore gjatë vitit fiskal 2026. Ky plan synon sigurimin e një menaxhimi efikas të buxhetit, rritjen e transparencës, disiplinës financiare dhe forcimin e llogaridhënies institucionale.

OBJEKTIVAT KRYESORE

- Përgatitja dhe raportimi i rregullt financiar dhe buxhetor;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i të hyrave dhe shpenzimeve publike;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies financiare;
- Zbatimi korrekt i procedurave ligjore dhe standardeve financiare;
- Mbështetja e drejtorive komunale gjatë procesit të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.

PLANI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2026

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi	Periodha e implementimit	Implementuesi
1	Përgatitja e Pasqyrave Financiare	Përgatitja dhe raportimi i pasqyrave financiare sipas kërkesave ligjore dhe standardeve përkatëse	Janar	Spektori i Financave
2	Analiza financiare e vitit paraprak	Analizë financiare e komunës dhe përgatitja e raportit për vitin paraprak	Janar	DBF
3	Pyetëson i Vetëvlerësimit	Plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit institucional	Shkurt	Spektori i Financave
4	Shpërndarja e faturave të Tatimit në Pronë	Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë për periudhën përkatëse	Prill - Qershor	Tatimi në Pronë
5	Auditimi i Jashtëm	Bashkëpunimi dhe ofrimi i dokumentacionit për auditim të jashtëm	Shkurt - Mars	DBF

Nr.	Aktiviteti	Përshkrimi	Periudha e implementimit	Implementuesi
6	Regjistrimi i objekteve të reja	Regjistrimi dhe përditësimi i objekteve të reja në bazën e tatimit në pronë	Janar - Dhjetor	Tatimi në Pronë
7	Raportimi tremujor	Përgatitja dhe raportimi financiar për tremujorin	Prill	Spektori i Buxhetit
8	Përgatitja e KAB-it	Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore	Maj - Qershor	DBF
9	Raportimi gjashtëmujor	Përgatitja dhe raportimi financiar gjashtëmujor	Korrik	Spektori i Buxhetit / Spektori i Financave
10	Dëgjimet buxhetore	Organizimi dhe realizimi i dëgjimeve buxhetore me publikun	Korrik	Spektori i Buxhetit / Spektori i Financave
11	Plani i Veprimit	Përgatitja e planit të veprimit bazuar në prioritetet institucionale	Korrik	Financat në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse
12	Përpilimi dhe dorëzimi i buxhetit	Përpilimi i projektbuxhetit dhe dorëzimi për miratim	Gusht - Shtator	Spektori i Buxhetit / Spektori i Financave
13	Raportimi nëntëmujor	Përgatitja dhe raportimi financiar nëntëmujor	Tetor	Spektori i Buxhetit
14	Vlerësimi i të punësuarve	Vlerësimi i performancës së stafit	Dhjetor	Të gjithë sektorët
15	Mbyllja e vitit fiskal	Mbyllja financiare e vitit fiskal dhe përgatitja e dokumentacionit përkatës	Nëntor - Dhjetor	Spektori i Buxhetit / Spektori i Financave

Zbatimi i këtij Plani të Punës do të kontribuojë në menaxhimin efikas të financave publike, përmirësimin e disiplinës buxhetore dhe forcimin e transparencës institucionale gjatë vitit 2026.



Komuna e Pejës
Municipality of Peja
Opština Peć

Raporti Vjetor
Janar-Dhjetor 2025

Dhjetor, 2025

RAPORT 12 MUJOR I AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NGA INSTITUCIONET E DKRS NË 2025

D.K.R.S

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Shpallja e Sportistit të Vitit	Me qëllim të motivimit dhe vlerësimit të sportistëve më të suksesshëm dhe klubeve sportive që kanë shënuar rezultate të larta, është organizuar ceremonia madhështore “Sportisti i Vitit 2024”. Në këtë ngjarje u vlerësuan arritjet individuale dhe kolektive, duke theksuar rolin e sportit në promovimin e një jete aktive dhe të shëndetshme.	15 Janar
2	Mbështetja me Subvencione për Organizatat Kulturore, Rinore dhe Klubet Sportive	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shpallur thirrjen për mbështetje me subvencione me anë të projekt propozimeve për organizatat kulturore, rinore dhe klubet sportive, duke vënë në dispozicion një fond prej 350,000 euro, nga i cili kanë përfituar mbi 60 organizata kulturore, rinore dhe klube sportive të qytetit tonë.	3 Shkurt - 10 Mars
3	Aktivitetet për Ditën e Pavarësisë	Në shënim të Ditës së Pavarësisë, u organizuan ekspozita artistike, koncerte argëtuese dhe aktivitete të tjera kulturore.	17 Shkurt

4	Organizimi i Gjimnazjadës 2025	Në bashkëpunim me Sportin Shkollor, është organizuar Gjimnazjada 2025, Qyteti i Pejës hapi dyert për nxënësit e 77 shkollave nga mbarë Kosova të cilët u bënë pjesë e spektaklit sportiv. Afro 700 nxënës të ardhur nga 26 Komuna të Kosovës garuan në kategori të ndryshme sportive ku më të dalluarit u shpërblyen me çmime fituese. Futbolli, basketbolli, futsalli, shahu, volejboli dhe hendbolli ishin disa prej sporteve garuese gjatë këtij evenimenti.	21 -22 Prill
5	Aktivitetet për Ditën Botërore të Tokës	Në bashkëpunim me OJQ Gjeravica Pejë, është realizuar një aktivitet simbolik me mbjelljen e qershve japoneze nën sloganin “Peja ime – Planeti im”, si pjesë e fushatës vetëdijësuese për mbrojtjen e mjedisit.	22 Prill
6	Mbështetja për Zejtarët e Pejës	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka nënshkruar memorandumet e bashkëpunimit me Shoqatën e Zejtarëve të Pejës, për ofrimin e subvencioneve për zejtarët e Pejës. Nga kjo iniciativë që synon ruajtjen dhe zhvillimin e artizanëve të qytetit tonë, kanë përfituar 15 zejtar të Pejës.	15 Maj
7	Inaugurimi i “Sheshit Italia”	Me rastin e Ditës së Republikës së Italisë, në bashkëpunim me Ambasadën e Italisë dhe institucionet lokale, u organizua ceremonia e inaugurimit të “Sheshit Italia” në qytetin e Pejës. Ky projekt synon forcimin e marrëdhënieve kulturore dhe historike mes dy vendeve, si dhe ofrimin e një hapësire të re publike për qytetarët tanë.	30 Maj

8	Crossi 2025 – Aktivitet Sportiv për Ditën e Fëmijëve	Me rastin e 1 Qershorit, u mbajt Crossi 2025 ku morën pjesë fëmijë nga shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Pejës, duke promovuar jetesën aktive dhe sportin që në moshë të hershme.	1 Qershor
9	Aktivitetet për Ditën e Çlirimit të Pejës	Dita e Çlirimit të qytetit u shënua me një varg aktivitete. Në kuadër të këtij manifestimi, u organizua ceremonia solemne për ndarjen e çmimeve të nderit, duke vlerësuar personalitetet dhe kontribuuesit më të shquar të jetës kulturore, ekonomike dhe shoqërore të komunës së Pejës.	16 Qershor
10	Dita e Rinisë	Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, në bashkëpunim me organizatat rinore të qytetit DKRS organizoi aktivitete të dedikuara për angazhimin e të rinjve në komunitet. Aktivitetet si: panel diskutimi, marshim vetëdijësues, punëtori në robotikë, dhe turnir basketbolli për të rinjtë.	12 Gusht
11	Festivali i Letërsisë Azem Shkreli	DKRS ishte organizatore dhe mbështetëse kryesore e Festivalit Ndërkombëtar të Letërsisë “Azem Shkreli”, Edicioni XXI, i cili u zhvillua në disa hapësira kulturore të qytetit. Festivali solli në Pejë krijues, artistë dhe mysafirë nga vendi dhe bota, duke e pozicionuar qytetin në hartën kulturore ndërkombëtare. Një nga kulmet e festivalit ishte ndarja e Çmimit Laureat për Akademik Sabri Hamiti, si vlerësim për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në letërsinë shqipe. Programi u pasurua me poezi, muzikë dhe performanca artistike, duke krijuar një atmosferë të veçantë kulturore. Një ndër momentet më të veçanta ishte vizita e shkrimtares së njohur Helena Kadare në Pallatin e Kulturës në Pejë, Ky takim simbolik theksoi rëndësinë e librit, kujtesës kulturore dhe bashkëpunimit institucional në promovimin e kulturës.	9 -11 Shtator
12	Dita e Paqes dhe Dialogut Ndërfetare	Tashmë siç është bërë traditë Komuna e Pejës, si komuna e vetme në Republikën e Kosovës, organizon aktivitete që promovojnë vlerat e paqes, bashkëjetesës dhe mirëkuptimit mes komuniteteve.	16 Shtator

13	16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Pejës iu bashkua përpjekjeve globale për ndërgjegjësimin dhe parandalimin e të gjitha formave të dhunës, me theks të veçantë dhunën me bazë gjinore. Përmes aktiviteteve informuese, mesazheve sensibilizuese dhe bashkëpunimit me të rinjtë, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet lokale, DKRS kontribuoi në ngritjen e vetëdijes qytetare mbi rëndësinë e barazisë, respektit dhe sigurisë	Tetor
14	28 Nëntori – Dita e Flamurit	Dita e Flamurit, e shënuar me agjendë të larmishme kulturore, përfshirë manifestimin “Velloja e Nëntorit”, me aktivitete të shumta artistike dhe përkujtimore.	28 Nëntor

MUZEU I PEJËS

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Festojmë Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës'	Performancë artistike me vallëzim dhe recitim të nxënësve të paraleles parashkollore të SHFMU 'Rilindja' nga fshati Llutogllavë. Fëmijët erdhën në Muze të veshur me veshje kombëtare dhe të shoqëruar nga mësuesja. Përveç vizitës Muzeut, nxënësit interpretuan disa pika artistike si: vallëzim i valleve tona tradicionale dhe recituan vjersha kushtuar Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.	14 Shkurt, 2025
2	Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike	Lligjeratë vetëdijësuese dhe informative për trashëgiminë arkeologjike të Rajonit të Pejës. Lligjerata 'Trashëgimia Kulturore Arkeologjike' u mbajt në Qendrën Kreative ‘Dukagjini’ para nxënësve dhe mësimeve të shkollave fillore dhe ato të mesme të Komunës së Pejës si: SHFMU 'Asdreni'. gjimnazi 'Bedri Pejani', shkollat e Artit 'Odhise Paskali', si dhe përfaqësuesve të QRTK-IMM.	18 Prill, 2025

3	Dita Ndërkombëtare e Muzeut'	Muzeu i Pejës, tani e 15 vite shënon Ditën Ndërkombëtare të Muzeve me aktivitete të ndryshme. Këtë vit është prezentuar një frizurë e viteve të '50, e quajtur 'TOVALET', që hyn në trashëgiminë shpirtërore dhe materiale të trevës së Dukagjinit. Edhe ky prezentim u zhvillua në Qendrën Kreative 'Dukagjini', ku të pranishëm ishin, kryesisht, qytetare të nderuara të qytetit, si dhe drejtoresha e DKRS, znj.Xhenet Syka-Kelmendi. Në fund të prezentimit, të pranishmit u gostitën me një koktej të dhuruar nga humanistja nga Zvicra, znj.Behide Hasanaj.	19 Maj, 2025
4	Nata në Muze	Shfaqja e filmit 'Der Shut', film amerikan, i xhiruar në qytetin e Pejës dhe Rugovë në vitin 1964, në përmbyllje të Ditëve të Trashëgimisë Europiane, Ditë këto që promovojnë trashëgiminë e përbashkët europiane	29 Shtator, 2025
5	Dita Ndërkombëtare e Arkeologjisë	Aktivitet vetëdijësues për trashëgiminë arkeologjike të Rajonit të Pejës, u realizua simulimi i gërmimeve arkeologjike, me nxënës të SHFMU 'Dardania', ku nxënësit mësuan se si bëhen gjetjet arkeologjike, si bëhet evidentimi, restaurimi dhe konzervimi i tyre.	18 Tetor, 2025
6	Vello e Nëntorit 2025	Aktivitet i organizuar në bashkëpunim me DKRS, në kuadër të axhendës së aktiviteteve të Komunës së Pejës për shënimin e Ditës së Flamurit, 28 Nëntorit. Me këtë rast, në Muze u prezentua xhubleta para nxënësve të SHFMU 'Lidhja e Prizrenit', me mësuese Pranvera Bajri, të cilët, poashtu, paraqitën pjesë nga programi i tyre artistik, pregatitur enkas për këtë rast.	25 Nëntor, 2025

Biblioteka "Azem Shkreli" në Pejë

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
----	--------------------	---	----------------------------------

1	Qytetari Digjital (Punëtori / trajnime praktike në grup)	Aktiviteti “Qytetari Digjital” i organizuar nga Biblioteka “Azem Shkreli” synon të ofrojë hapësira edukative për anëtarët e rinj të bibliotekës, përmes punësive praktike që zhvillohen rreth përdorimit dhe programimit të pajisjeve teknologjike moderne. Fëmijët dhe të rinjtë marrin pjesë në seanca të strukturuar, ku njoftohen dhe trajnohen për përdorimin e pajisjeve si: Micro:bit DIY Electronics Kits Bosan Kits Robota edukativë 3D Printer Qëllimi i këtij aktiviteti është të: Nxisë shkathtësitë digjitale dhe të menduarit kritik që në moshë të re Edukojë gjeneratat e reja për të qenë përdorues aktivë dhe krijues të teknologjisë, jo vetëm konsumues. Fuqizojë rolin e bibliotekës si një hapësirë moderne edukimi joformal dhe inovacioni.	03.01.2025- 27.06.2025
2	Aftësimi profesional për bibliotekonomi për nxënësit e shkollave të mesme (Punëtori praktike dhe trajnim tematik)	Biblioteka “Azem Shkreli” ka realizuar një cikël punëtorish dhe trajnimesh me nxënësit të shkollave të mesme, me fokus në aftësimin profesional në fushën e bibliotekonomisë. Aktiviteti synon të ofrojë njohuri praktike dhe teorike mbi funksionimin e një biblioteke moderne, duke krijuar mundësi për zhvillim të shkathtësive dhe orientim të hershëm profesional.	21.02.2025 16.04.2025
3	Dita Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë 2 Prilli (Aktivitet informues për rëndësin e librit)	Në Ditën Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë, Shkolla Filllore “Xhemajl Kada” dhe dy klasa nga Shkolla Filllore “Asdreni” vizituan Bibliotekën “Azem Shkreli” dhe me fëmijët e këtyre shkollave organizuan aktivitete, ku fëmijët u njohën me shërbimet tona, recituan poezi dhe dhanë mesazhe për dashurinë ndaj librit.	02.04.2025
4	Dita Botërore e Librit dhe të Drejtave të Autorit (23 Prilli) (Aktivitet informues për rëndësin e librit)	Në Ditën Botërore të Librit dhe të Drejtës së Autorit, ka filluar të festohet një javë më herët, sepse ka pas të interesuar shumë shkolla dhe i kam sistemuar nga data 16.04.2025 deri me datën 23.04.2025. Shkollat e interesuara për këtë aktivitet ishin Shkolla Filllore “Xhemajl Kada”, “Asdreni”, “Lidhja e Prizrenit”, “8 Marsi”, “Ramiz Sadiku” ku e vizituan Bibliotekën “Azem Shkreli” dhe me fëmijët e këtyre shkollave organizuan aktivitete brenda sallave të Bibliotekës, ku fëmijët u njohën me shërbimet bibliotekare, recituan poezi dhe dhanë mesazhe për dashurinë ndaj librit.	16.04.2025 18.04.2025 21.04.2025 22.04.2025 23.04.2025
5	1 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve	Me rastin e 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, në bashkëpunim me organizatën “The Library Project”, dhe me fëmijët e kopshtit “Pëllumbat e Paqës”, në Bibliotekën “Azem Shkreli” u organizua aktiviteti me temën: “Zhvillimi i leximit në fëmijërinë e hershme”. Fëmijët patën mundësinë të përjetojnë magjinë e librit përmes leximit të përbashkët, tregimeve të ilustruara dhe aktiviteteve edukative që nxisin dashurinë për librin që në hapat e parë të jetës. Aktiviteti përfshiu edhe prindërit, të cilët u përfshinë në biseda rreth rëndësisë së leximit të hershëm dhe ndikimit të tij në zhvillimin e fëmijëve.	03.06.2025

6	Orë letrare kushtuar Ditës së Çlirimit të Pejës- me karakter garues dhe edukativ	Me rastin e Ditës së Çlirimit të Pejës, në ambientet e Bibliotekës “Azem Shkreli” u organizua një aktivitet kulturor-letrar me karakter solemn dhe edukativ. Aktiviteti kishte për qëllim të nderojë sakrificën e brezave që sollën lirinë dhe të kultivojë ndjenjën e përkatësisë dhe dashurisë për atdheun te brezat e rinj. Ngjarja përfshiu një Orë Letrare me karakter garues, në të cilën morën pjesë nxënës të shkollave fillore të komunës së Pejës. Nxënësit prezantuan krijimet e tyre origjinale – poezi, tregime dhe interpretime letrare – që pasqyruan ndjenja të thella patriotike dhe artistike. Pjesëmarrës ishin nxënës nga disa shkolla fillore të komunës së Pejës Poetë dhe krijues nga Shoqata e Krijuesve Letrar Stafi i bibliotekës, mësimdhënës, prindër dhe dashamirë të librit dhe letërsisë .	13.06.2025
7	Xhirimi i videos edukative “Lexojmë së bashku me Majlinda Kelmendi”	Më 26 nëntor 2025, në Departamentin e Fëmijëve të Bibliotekës “Azem Shkreli” u realizua xhirimi i një videoje edukative dhe humanitare, ku kampionia olimpike Majlinda Kelmendi lexoi një tregim për fëmijë. Aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me UNICEF Kosovë dhe The Library Project Kosova, me qëllim promovimin e leximit dhe vlerave pozitive për fëmijët shqipfolës kudo. Biblioteka “Azem Shkreli” luajti një rol kyç organizativ dhe mbështetës, duke vënë në dispozicion hapësirën e Departamentit të Fëmijëve, siguruar ambient të përshtatshëm për xhirime dhe koordinim institucional, dhe duke shërbyer si urë lidhëse mes partnerëve dhe pjesëmarrësve.	25.11.2025
8	Dita e Flamurit me Shkrimtarin – 28 Nëntor 2025	Në kuadër të Ditës së Flamurit, më 28 nëntor 2025, Biblioteka “Azem Shkreli” organizoi aktivitetin “Dita e Flamurit me Shkrimtarin” me nxënësit e Shkollës “Fan S. Noli”. Prof. Riza Dreshaj prezantoi krijimtarinë e tij, ndërsa nxënësit zhvilluan punëtori krijuese për të shprehur dashurinë për flamurin, lirinë dhe atdheun përmes poezive dhe eseve. Biblioteka organizoi dhe koordinoi ngjarjen, ofroi hapësirën dhe infrastrukturën për punëtorinë krijuese, prezantoi shkrimtarin tek nxënësit dhe promovoi kulturën, dashurinë për librin dhe vlerat kombëtare.	21.11.2025
9	Festë Edukative për Ditën e Flamurit – 28 Nëntor 2025	Në kuadër të Ditës së Flamurit, më 28 nëntor 2025, Biblioteka “Azem Shkreli” organizoi një festë edukative ku nxënësit u angazhuan në një lojë interaktive për të zbuluar figurat historike të Kosovës dhe momentet kryesore të historisë kombëtare. Aktiviteti zhvilloi njohuritë historike, kuriozitetin dhe aftësitë e të menduarit kritik tek fëmijët. Biblioteka organizoi lojën, siguroi materialet edukative dhe mbikëqyri aktivitetin, duke udhëhequr nxënësit në zbulimin e figurave historike dhe njohjen e momenteve kryesore të historisë kombëtare.	27.11.2025

10	Ekspozitë “Flamuri ynë, krenaria jonë”	Në kuadër të aktiviteteve për Ditën e Flamurit, Biblioteka “Azem Shkreli” organizoi ekspozitën “Flamuri ynë, krenaria jonë”, ku u prezantuan punimet krijuese të nxënësve dhe një përzgjedhje librash historikë nga fondi i bibliotekës. Ekspozita nxiti dashurinë për historinë dhe trashëgiminë kombëtare, duke ofruar një hapësirë vizuale dhe edukative për vizitorët. Biblioteka përgatiti dhe prezantoi ekspozitën, siguroi hapësirën dhe librat historikë, dhe promovoi punimet krijuese të nxënësve për të nxitur dashurinë për historinë dhe trashëgiminë kombëtare.	27.11.2025
11	Promovimi i librit “Një arsye më shumë për të jetuar” – 3 Dhjetor 2025	Më 3 dhjetor 2025, në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, Biblioteka “Azem Shkreli” organizoi promovimin e librit “Një arsye më shumë për të jetuar” të Realta Krasniqit. Nxënës, profesorë dhe mysafirë diskutuan për të drejtat, sfidat dhe fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara, duke promovuar shpresën dhe jetën. Biblioteka organizoi dhe koordinoi promovimin, ofroi hapësirën dhe infrastrukturën, mirëpriti pjesëmarrësit dhe krijoi një ambient mbështetës për diskutimin mbi të drejtat dhe fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara.	03.12.2025
12	Huazimi i materialeve në shfrytëzim nga lexuesit	Qëllimi kryesor i shfrytëzimit të librave në hapësirat e Bibliotekës “Azem Shkreli” është të krijojë një ambient të qetë, të organizuar dhe të përshtatshëm për lexim, studim dhe hulumtim. Përmes këtij shfrytëzimi, biblioteka synon të: 1. Nxisë kulturën e leximit duke ofruar qasje të drejtpërdrejtë në literaturë të përzgjedhur e të organizuar. 2. Lehtësojë punën studimore dhe angazhimin akademik për nxënës, studentë dhe studiues. 3. Zhvillojë aftësitë kërkimore përmes përdorimit të literaturës shkencore dhe burimeve të tjera të specializuara. 4. Fuqizojë edukimin joformal përmes leximit të lirë dhe eksplorimit të pavarur të përmbajtjes së librave. 5. Përforcojë lidhjen e komunitetit me bibliotekën si një hapësirë e hapur për dituri, frymëzim dhe bashkëpunim.	03.01.2025 -30.12.2025

13	Përdorimi i sallave të leximit dhe studimit	Qëllimi i shfrytëzimit të sallave të studimit në Bibliotekën "Azem Shkreli" është të ofrohet një ambient i qetë, i rregullt dhe i përshtatshëm për lexim, punë studimore dhe hulumtime individuale apo në grup. Sallat shërbejnë si hapësira mbështetëse për anëtarët që kanë nevojë për kushte të përqendruara dhe akses të drejtpërdrejtë në literaturë bibliotekare. Këto hapësira: 1. Nxisin përkushtimin akademik duke u krijuar studentëve dhe kërkuesve kushte të favorshme për mësim dhe analizë. 2. Përforcojnë funksionin edukativ të bibliotekës, duke e shndërruar atë në një qendër studimi dhe reflektimi. 3. Ndihmojnë në përdorimin e literaturës referuese, ku përdoruesit mund të konsultojnë libra, revista shkencore dhe materiale të tjera pa i huazuar jashtë. 4. Ofron mundësi për punë të pavarur dhe grupe, sidomos gjatë përgatitjes për provime, projekte apo seminare.	01.01.2025 -30.12.2025
----	---	---	------------------------

Qendra Multi-profesionale ne Novoselle

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Dita e botes se eger	Per nder te dites nderkombetare te botes se eger te pranishem patem fotografimin e njohur Arian Mavriqi cili permes pamjeve te shumta permes projektorit l'u spjegoi nxeneseve se si arrin te marre pamje dhe ngjarje interesante nga bota e eger si ne Kosove dhe jashte saj	03.03.2025
2	Epopeja e UCK-se,5 6 7 marsi	Per nder te ketyre datave te rendesishme per popullin tone ne organizuam nje aktivitet per te nderuar jeten dhe vepren e familjes Jasharaj te cilet sakrifkuan per kete vend	05.03.2025
3	Festa e 7 dhe 8 marsit	Festa e mesuesit dhe festa e nenes u festuan ne Qendren Multi-profesionale se bashku me nxenesit e sh.f.m.u Sami Frasheri(Ozdrim)	05.03.2025

4	Dita boterore e poezise	Ne kete date organizuam nje aktivitet me mesuesen Eva Vllasi dhe nxenesit e saj te cilet recituan poei te bukura kushtar kesaj dite,poashtu shpallem tri poezit me te bukura	21.03.2025
5	Dita e lumturise	Lumturia vjen nga brenda e sidomos veprate mira qe bejme na lumturojne edhe me shume	21.03.2025
6	Dita boterore e ujit	Pa uje nuk ka jete,keshtu u quajte aktiviteti I sotem ne Qendren Multi-profesionale,nxenesve l'u folem per rendesine e ujit dhe kursimin e tij	22.03.2025
7	Dita e Kushtetutes	Organizuam nje aktivitet me nxenes per nder te kesaj dite	09.04.2025
8	Kendi Muze	Ne kete dite patem musafir nje klase me nxenes nga sh.f.m.u Dardania (Peje)me mesuesen Marigona Myrtaj	29.04.2025
9	Dita e punes	Aktivitet I bukur me nxenes,secili prej tyre ushtroi profesionin e endrrave per pak caste	01.05.2025
11	Dita nderkombetare e familjes	Me nxenesit e nivelit parashkollor dhe mesuesen e tyre Blerina Bakraci zhvilluam kete aktivitet te bukur per rendesine e familjes ne shoqerine tone	15.05.2025
12	Dita nderkombetare e Muzeut	Aktivitet ne Qendren Multi-profesionale per nder te kesaj dite se bashku me nxenesit e klasave te para nga sh.f.m.u Lidhja e Pejes	18.05.2025
13	Dita boterore kunder pirjes se duhanit	Se bashku me femijet organizuam aktivitet rreth vetdijesimit te tyre per rreziquet qe vijne nga pirja e duhanit	31.05.2025
14	1 Qershori	Dita e bukur e femijeve	31.05.2025
15	Kendi Muze ne QMP-vizite	Vizite ne Kendin Muze nga shoqata e pensionisteve nga Istogu	10.11.2025
16	Sesion Meditimi	Aktivitet me trajneren e Meditimit Znj Lume Camaj dhe disa zonja nga komuniteti te cilat u njohen me teknika frymemarrjeje, ushtrime relaksimi dhe menyra per perballimin e stresit, atmosfera ishte qetesuese dhe shume frymezuese	26.11.2025

17	Ngjyrat e vjeshtes	Aktivitet me nxenesit te cilet ndjekin mesimin plotesues me mesuesen Hava Vllasi ne Qender,ne punuam se bashku disa punime me ngjyrat e bukura te vjeshtes,recituan poezi me tema per kete stine te bukur	09.10.2025
18	Libri-dritare e dijes	Aktivitet ne kuader te Bibliotekes me nxenesit e Sh.f.m.u Hil Mosi, nxenesit mesuan per rendesine e librit permes lojes dhe poezive te bukura per diturine qe marrim nga libri	23.10.2025
19	Nentori ne muzeun e Qendreses	Me rastin e festes se Flamurit u organizua aktivitet ne kendin muze ku nxenesit moren pjese me recitime, kenge dhe valle patriotike, duke shprehur dashurine dhe respektin per atdheun	26.11.2025
20	Ne dhe Flamuri Kuq e Zi	Se bashku me nxenesit e nivelit parashkollor te Sh.f.m.u Lidhja e Pejës oganizuan nje aktivitet ne kendin muze per ditën e Flamurit.Femijet u njoftuan per kete dite te rendesishme per kombin Shqipetar	27.11.2025
21	Gezime dhe urime per festat e fundvitit	Nxenesit moren pjese ne nje aktivitet te perbashket me rastin e festave te fundvitit, ata realizuan punime me dore me motive dimerore dhe festive, kenduan kenge te Vitit te Ri dhe zhvillun lojera argetuese	22.12.2025
22	Anetaresimi ne Biblioteke	Ne kete vit kemi pasur gjithsejt 32 anetaresime ne Biblioteken e Qendres Multi-profesionale dhe 200 huazime	03.01.2025-31.12.2025

SHTEPIA E KULTURES VITOMIRICE			
Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Literarni Cas i dodela knjiga za Najbolje citaoce	Povodom Dana Nezavisnosti Kosova,Odrzan je Literarni cas u Biblioteci 14.02.2025 Literarni Cas je Oranizovao Dom Kulture sa uenicima osnovne skole "7 Shtatori"u Vitimirici sa Albanske i Bosanske nastave ucestvovalo je 40 ucenika i Nastavnika .Proglaseni su najbolji i Dodijeljene su knjige za najbolje Citaoce u 2024 godini.	14.02.2025
2	Izložba Knjiga	Odrzana je Izlozba najnovih izdanja knjiga na Albanski i Bosanski jezik .Izlozba je odrzana u Biblioteci 15.04.2025 .Na Izlozbi su posjetili ucenici osnovne skole "7 Shtatori"u Vitimirici sa Albanske i Bosanske nastave 60 ucenika i Nastavnika je obislo Izlozbu.	15.04.2025

3	Sastanak sa Komitetom za Zajednice SO Pec	Odrzan sastanak sa Predstavnicima Komitetaza Zajednice SO Peci i NVO iz Vitimirice .Na Sastanku su izlozeni problemi u Domu Kulture u Vitimirici .Predstavnici Komiteta su obecali da ce Pomoci za Bolji rad Doma Kulture u narednom periodu	22.04.2025
4	Sportske Igre	Povodom Dana Oslobodjenja Peci a,Odrzane su Sportske Igre "Vitimirica 2025 Takmicenje je odrzano 15.06.2025 u Atletici. Ucestvovala su skole iz Vitimirice,Peci,Banje Dobruse,Zlopeka,Novog Sela i Ozdrima.Specijalni gosti su bili iz Prizrena Ucestvovalo je preko 150 Ucenika .Najbolja Ekipa je bila iz Vitimirice Druga iz Dobruse trci iz Peci .Najbolja tri učenika u svakoj Disciplini su Dodijeljene Medalje i Diplome a Pehari najboljim skolama .	15.06.2025

Galerinë e Arteve – Pejë			
Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Ekspozitë	Ekspozite Keep calm and smile nga Korab Basha	20 Janar
2	Ekspozitë	Ekspozita kolektive e artistëve nga Shkodra, “Prap do t’ia nisim prej diellit”, të cilë u bashkunan në Pejë gjatë aktiviteteve të 17 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës	17 Shkurt
3	Ekspozitë	Ekspozita 'Profile Dardane' e Prof. Isa Alimusajt	5 Prill
4	Ekspozitë	Ekspozita 'Mos më thuaj Gru...' e autores Ardita Rizvanolli	5 Maj

5	Ekspozitë	Ekspozita retrospektive e një nga grafistëve më të shquar shqiptarë Fatmir Krypës	12 Maj
6	Ekspozitë	Ekspozita Perpjekja e Arte me kurator Berat Bajrami, rrugetimi I xhudos ne lartesine e Kosoves	09 Qershor

Teatri Istref Begolli			
Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit
1	Seancë e projektit tre kufitarë.	Moderim	11.04.2025
2	Festivali ndërkombëtarë I letërsisë "Azem Shkreli" Edicioni XXI	Lexim skenik nga aktorët Mulliri "Haxhi Zeka"	12.09.2025
3	Festivali ndërkombëtarë I letërsisë "Azem Shkreli" - Edicioni XXI, TEK Mulliri "Haxhi Zeka".	Lexim skenik nga aktorët SHFMU "Halit Kasapolli"	12.09.2025
4	28 Nëntori, Dita e Flamurit.	Interpretim skenik	28.11.2025
5	Shfaqje mysafire nga Teatri "Dodona" - Prishtinë	Shfaqje teatrale për fëmijë "Përralla me lara" Kino "Jusuf Gërvalla"	04.12.2025

SHTEPIA E KULTURES VITOMIRICE			
Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit (deri 300 karaktere)	Data e realizimit të aktivitetit

1	Literarni Cas i dodela knjiga za Najbolje citaoce	Povodom Dana Nezavisnosti Kosova,Odrzan je Literarni cas u Biblioteci 14.02.2025 Literarni Cas je Oranizovao Dom Kulture sa uenicima osnovne skole "7 Shtatori"u Vitimirici sa Albanske i Bosanske nastave ucestvovalo je 40 ucenika i Nastavnika .Proglaseni su najbolji i Dodijeljene su knjige za najbolje Citaoce u 2024 godini.	14.02.2025
2	Izložba Knjiga	Odrzana je Izlozba najnovih izdanja knjiga na Albanski i Bosanski jezik .Izlozba je odrzana u Biblioteci 15.04.2025 .Na Izlozbi su posjetili ucenici osnovne skole "7 Shtatori"u Vitimirici sa Albanske i Bosanske nastave 60 ucenika i Nastavnika je obislo Izlozbu.	15.04.2025
3	Sastanak sa Komitetom za Zajednice SO Pec	Odrzan sastanak sa Predstavnicima Komitetaza Zajednice SO Pec i NVO iz Vitimirice .Na Sastanku su izlozeni problemi u Domu Kulture u Vitimirici .Predstavnici Komiteta su obekali da ce Pomoci za Bolji rad Doma Kulture u narednom periodu	22.04.2025
4	Sportske Igre	Povodom Dana Oslobodjenja Peci a,Odrzane su Sportske Igre "Vitimirica 2025 Takmicenje je odrzano 15.06.2025 u Atletici. Ucestvovale su skole iz Vitimirice,Peci,Banje Dobruse,Zlopeka,Novog Sela i Ozdrima.Specijalni gosti su bili iz Prizrena Ucestvovalo je preko 150 Ucenika .Najbolja Ekpa je bila iz Vitimirice Druga iz Dobruse trci iz Peci .Najbolja tri ucenika u svakoj Disciplini su Dodijeljene Medalje i Diplome a Pehari najboljim skolama .	15.06.2025

Shfytëzimi I hapesirave te institucioneve sportive nga klubet

Nr.	Institucioni	Klubi Shfrytëzues	Orari javor i shfrytëzimit
1	Stadiumi Vitimiricë	K.F. Behar	12 orë
2	Stadiumi Vitimiricë	K.F. Behar	2 orë
3	Stadiumi Vitimiricë	K.F. Rilindja 1974	12 orë
4	Stadiumi Vitimiricë	K.F. Istogu	2 orë

5	Stadiumi Vitomiricë	K.F.F. Behar	6 orë
6	Sta.i "Shahin Haxhiislami	K.F. Rilindja 1974	12 orë
7	Sta. "Shahin Haxhiislami"	K.A. Peja	10 orë
8	Sta. Tahir Vokshi	K.F. Besa	12 orë
9	Sta. " Shahin Haxhiislami"	k.F Peja	6 orë
10	Sta. tahir Vokshi	K.F. Arena	6 orë
11	Sta. Tahir Vokshi	K.F Shkendija	6 ore
12	Sta. Tahir Vokshi	K.F. AS Peja	4 ore
13	Sta. Novosellë	K.F. Drini I Bardhë	6 ore
14	Sta. Novosellë	K.F. AS Peja	6 ore
15	Sta. Novosellë	K.F.Shqiponja	20 ore
16	Sta. Novosellë	K.F.Arena	2 ore
17	Sta. Novosellë	K.F. Koci	2 ore
18	Palestra Karagaq	K.B. Peja	10 ore
19	Palestra Karagaq	K.H. Besa Famgas	10 ore
20	Palestra Karagaq	K.V.Peja	12 ore
21	Palestra Karagaq	K.Box Peja	10 ore
22	Palestra Karagaq	Sporti Shkollor	100 ore
23	Salla Partizani	K.K. Peja	6 ore
24	Salla Partizani	K.K. Arena	6 ore
25	Salla Partizani	K.K. Ipon	6 ore

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ		
Data / Date /Datum:	12.01.2026		
Për / To / Za:	Zyrës së Kryetarit		
Nga / From /Od:	Drejtoria për Administratë		
Lënda / Subject / Tema:	Raport i punës 03 Janar - 31 Dhjetor 2025		

R A P O R T I P U N Ë S

Në kuadër të Drejtorisë për Administratë funksionojnë gjithsej **shtatë (7) sektorë**, si në vijim:

1. Gjendja Civile
2. Qendra për Shërbim të Qytetarëve
3. Sektori Ligjor
4. Përkthim dhe Lekturim
5. Teknologji Informative
6. Logjistikë
7. Mbrojtja e Fëmijëve dhe Riintegrimit

Gjatë periudhës raportuese, **të gjitha lëndët e Drejtorisë për Administratë janë shqyrtuar dhe përfunduar brenda afateve ligjore**, pa asnjë lëndë të mbetur në proces (0 – zero). Zgjidhja e lëndëve është realizuar në kohë rekorde, me përgjigje të shpejta dhe efikase ndaj palëve.

Numri i përgjithshëm i lëndëve të trajtuara në nivel të Komunës së Pejës është **100,082**, ndërsa **67,042 lëndë** janë trajtuar nga Drejtoria për Administratë, që përbën rreth **67% të totalit të lëndëve komunale**, duke e renditur këtë drejtori si bartësen kryesore të ngarkesës administrative në nivel komunal.

Nga Drejtoria për Administratë gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto punë dhe projekte:

1. Furnizimi me pajisje të Teknologjisë Informativë
2. Furnizimi me kompjuterë
3. Mirëmbajtja e kamerave të qytetit
4. Mirëmbajtja e kamerave në objektet e Komunës
5. Furnizimi me material administrativ për nevojat e Qendrës për Shërbim të Qytetarëve (QSHQ)
6. Furnizimi me material elektrik për QSHQ
7. Furnizimi me artikuj për mirëmbajtjen e objekteve komunale
8. Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare
9. Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare
10. Furnizimi me naftë për ngrohje
11. Furnizimi me naftë për automjetet zyrtare
12. Organizimi i takimeve dhe aktiviteteve për fëmijët dhe të drejtat e tyre
13. Mbështetja e ekipeve sportive të qytetit dhe shoqërive artistike me transport, si dhe bartja e nxënësve sipas kërkesave institucionale, kryesisht në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorinë për Arsim

Vendosja e të dhënave sipas raporteve nga sektorët

Bazuar në raportet e dorëzuara nga udhëheqësit e sektorëve pranë Drejtorisë për Administratë, **raporti i punës për periudhën 03 Janar – 31 Dhjetor 2025** paraqitet si në vijim:

1. SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Ka kryer këto shërbime:

1.Vendime për regjistrim me vonesë ne RTHL	21
2.Vendime për regjistrim me vonesë në RTHV	182
3.Vendime për korrigjime të emrit/mbiemrit	240
4.Vendime për ndërrim të emrit/mbiemrit	234
5.Regjistrime në RTHL-ve	2146
6.Regjistrime në RTHV-ve	895
7.Regjistrime në RTHM-ve	886
8.Lëshuar certifikata të lindjes	20687
9.Lëshuar ekstrakte të lindjes	47751
10.Lëshuar certifikata të kurorëzimeve	11201
11.Lëshuar certifikata të vdekjes	6912
12.Lëshuar certifikata të statusit martesor	2172
13.Lëshuar certifikata të vendbanimit	5833
14.Lëshuar certifikata të shtetësisë	829
15.Lëshuar deklaratë të Bashkësisë Familjare	6578
16.Lëshuar vërtetime nga Arkiva	1717
17.Raporte për lindje statistikës DEM-1	2146
18.Raporte për vdekje statistikës DEM-2	895
19.Raporte për kurora statistikës DEM-3	886
20.Aplikime për tu liruar nga shtetësia e Kosovës	32
21.Aplikime për ta fituar shtetësinë e Kosovës	221
22.Aplikime për te rikthyer shtetësinë e Kosovës	2273
Gjithsej shërbime të kryera:	110.810

Janë realizuar taksa nga zyrtaret dhe e-kiosku:

123.726,00 Euro.

VËREJTJE: Në shumën e taksave nuk përfshihen personat e liruar nga pagesa e taksës sipas pikave 17, 18 dhe 19, si dhe raportet zyrtare përkatëse.

2. QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE

- Qendra për Shërbim të Qytetarëve, gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në kuadër të Drejtorisë për Administratë, si dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante që ndërlidhen me funksionimin e këtij sektori.
- Vizioni i Qendrës për Shërbim të Qytetarëve (QSHQ) për të ardhmen është përqendrimi në avancimin dhe ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve profesionale, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe efikase për qytetarët.
- Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, Qendra për Shërbim të Qytetarëve ka pranuar kërkesa, ankesa dhe dokumente të tjera të parashtruara nga qytetarët dhe të destinuara për drejtoritë përkatëse, sipas të dhënave të paraqitura në tabelën më poshtë.
- Në bashkëpunim me Shërbimin e Gjendjes Civile, kjo qendër ka pranuar gjithsej **100,082 kërkesa, ankesa dhe dokumente të tjera**, të destinuara për drejtoritë e ndryshme të Komunës së Pejës, siç paraqitet në tabelën përkatëse.

Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

03/01/2025 - 31/12/2025

Përshkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Përfunduar	Totali
Drejtoria për Administratë	0	0	9,730	74	1	2	0	19	57,216	67,042
Drejtoria për Arsimit	4	224	3,247	3	0	2	0	186	0	3,666
Kuvendi Komunal	0	20	40	0	0	0	0	0	0	60
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	11	587	1,522	40	0	0	0	1	0	2,161
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	0	190	21	3	0	0	0	1	0	215
Drejtoria për Mirëqenie Sociale	0	112	2	0	0	4	1	0	0	119
Drejtoria për Shëndetësi	0	236	304	58	1	1	0	1	0	601
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	1	428	1,020	195	7	131	0	7	0	1,789
Kryetari i Komunës	3	6	1,600	51	0	299	2	26	0	1,987
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	0	0	151	54	0	2	0	0	0	207
Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi	57	832	17,101	12	0	18	0	274	0	18,294
Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike	1	104	447	256	0	1	0	0	0	809
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	0	85	13	0	0	0	0	0	0	98
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi	0	12	567	522	0	1	2	5	0	1,109
Drejtoria për Punë Inspektuese	0	287	203	4	1	0	0	0	0	495
Drejtoria për çështje Pronësoro-Juridike	3	142	1,155	7	2	2	0	23	0	1,334
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Prokurimi	0	96	0	0	0	0	0	0	0	96
Total:	80	3,361	37,123	1,279	12	463	5	543	57,216	100,082

Në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve janë administruar lëndë nga të gjitha drejtoritë komunale. Lëndët që i përkasin Drejtorisë për Administratë janë shqyrtuar dhe aprovuar nga zyrtarët përgjegjës të kësaj drejtorie, në përputhje me procedurat dhe kompetencat përkatëse.

3. ZYRA LIGJORE KOMUNALE

Gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore, konkretisht nga **03 janar deri më 31 dhjetor 2025**, sektori ligjor ka kryer këto aktivitete, të cilat paraqiten si në vijim:

1. **Kryesues i Komisionit për rekrutim** – 2 raste.
2. **Anëtar i Komisionit për rekrutim** – 3 raste.
3. **Pjesëmarrje në punëtori të ndryshme** – 2 raste.
4. **Rishqyrtimi i akteve të përgjithshme/rregulloreve** sipas vërejtjeve të Ministrisë – 1 rast.
5. **Interpretime ligjore për drejtoritë** – 4 raste.

4. PËRKTHIM DHE LEKTURIM

Zyra e Përkthimeve ka kryer punën e saj në harmoni me **Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Kosovë**.

- Të gjitha dokumentet që kanë ardhur për përkthim në këtë zyrë janë përkthyer **brenda afatit**, me kohë dhe pa ndonjë vonesë (dokumente dhe materiale të ndryshme nga të gjitha drejtoritë dhe zyrat, komitetet dhe organet e tjera të komunës).
- Nga muaji **janar deri në dhjetor të vitit 2025**, janë përkthyer gjithsej **685 faqe materialesh të ndryshme**, si dhe janë realizuar **15 orë përkthime të drejtpërdrejta** në takime të ndryshme. Më poshtë paraqitet një pasqyrë e dokumenteve kryesore dhe të vazhdueshme që janë përkthyer:

1. Procesverbalet e Kuvendit të Komunës;
2. Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Procesverbalet e Komitetit për Komunitete;
4. Procesverbalet e KKS-së;
5. Vërtetime të ndryshme;
6. Vendime dhe aktvendime të ndryshme;
7. Konkurse të ndryshme, konkluzione, njoftime dhe ftesa;
8. Njoftime të ndryshme, plane dhe strategji;
9. Projekte të ndryshme.

5. TEKNOLOGJI INFORMATIVE

Janë kryer punë të përditshme dhe është raportuar çdo ditë pune. Numri i kërkesave të realizuara është **1,669 kërkesa**.

Bazuar në kërkesat e tjera për menaxhim dhe implementim, më poshtë paraqiten të dhënat:

- Planifikimi për riparimin e rrjetit, kërkesë e drejtuar drejtorisë për përfshirje në planin e prokurimit;
- Kontribut i dhënë nga Sektori për Teknologji Informative lidhur me përgatitjen për shërbimet **e-Kosova**, në pjesën që përfshin të dhënat e kërkuara nga Komuna e Pejës;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave **LAURA** nga Sektori për TI;
- Pjesëmarrja e zyrtarëve të Sektorit për TI në komisione të ndryshme, takime, punëtori dhe konsulta;
- Menaxhimi i kontratave nga zyrtarët e Sektorit;
- Përgatitja e paramasave për punë të ndryshme nga Sektori për Teknologji Informative;
- Menaxhimi i bazave të të dhënave lokale të krijuara me kosto zero;
- Menaxhimi i bazave të të dhënave nga **ASHI**;
- Menaxhimi i **e-kioskut**;
- Furnizimi dhe montimi i pajisjeve të Teknologjisë Informative – kompjuterëve;
- Mirëmbajtja dhe intervenimet në kamerat e qytetit dhe të objekteve komunale.

Për raport me te detajuar dorëzohet aneksi i veçantë te Drejtoresha e Drejtorisë

6. LOGJISTIKA

1. Hyrje

Ky raport paraqet përmbledhjen e aktiviteteve, përgjegjësi dhe realizimeve të Sektorit për Logjistikë në Komunën e Pejës gjatë periudhës raportuese 03 janar – 31 dhjetor 2025. Qëllimi i raportit është të ofrojë pasqyrë të qartë dhe transparente mbi punën e sektorit dhe kontributin e tij në funksionimin efikas të administratës komunale.

2. Aktivitetet Kryesore të Sektorit për Logjistikë

2.1 Lëshimi i raporteve të pranimit

- Gjatë vitit 2025 janë lëshuar gjithsej **514 raporte pranimi**, duke siguruar që mallrat të pranoheshin, të kontrolloheshin dhe të dokumentoheshin në mënyrë të saktë dhe brenda afateve të caktuara. Ky proces ka garantuar transparencë dhe rregull në administrimin e furnizimeve.

2.2 Menaxhimi i kontratave

Janë menaxhuar kontratat për të cilat janë caktuar zyrtarët përgjegjës, duke u siguruar:

- Zbatimi i kushteve kontraktuese;
- Respektimi i afateve kohore;
- Komunikim i rregullt me furnitorët;
- Ngritja dhe adresimi i çështjeve për zgjidhje.

Ky proces ka siguruar realizimin e obligimeve të ndërsjella në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.

2.3 Furnizimi me material zyrtar

Është koordinuar dhe realizuar furnizimi me material zyrtar për të gjitha drejtoritë dhe njësitë komunale, duke siguruar:

- Përpunim të kërkesave në kohë;
- Shpërndarje të barabartë sipas kërkesave;
- Vazhdimësi të punës administrative pa ndërprerje.

2.4 Furnizimi me material higjienik

Është bërë organizimi dhe lëshimi i kërkesave për furnizim me material higjienik për të gjitha drejtoritë, si dhe siguri i pajisjeve dhe materialeve për mirëmbajtësit (pastruesit), me qëllim të ruajtjes së pastërtisë dhe standardeve higjienike.

2.5 Shpërndarja e materialeve

Janë kryer shpërndarje të rregullta të materialeve zyrtare, duke u siguruar që çdo njësi organizative të furnizohej sipas kërkesave të paraqitura.

2.6 Sistemi elektronik për evidentimin e mallrave

Është bërë regjistrimi i mallrave në sistemin elektronik **e-Pasuria**, si dhe evidentimi i hyrjeve dhe daljeve nga depoja, duke mundur menaxhim më efikas dhe transparent të pasurisë komunale.

3. Zyra e Mjeteve Themelore

(Pasuria Komunale dhe Sistemi e-Pasuria)

Në kuadër të Sektorit për Logjistikë funksionon Zyra e Mjeteve Themelore, e cila gjatë vitit 2025 ka realizuar këto aktivitete:

3.1 Pagesa dhe obligime financiare

- Pagesa e pagave për punëtorët e mirëmbajtjes dhe sigurimit (NPL “EKO SIG”);
- Bartja e obligimeve të mbetura nga viti paraprak;
- Kryerja e obligimeve të shpenzimeve komunale pas alokimit të buxhetit;
- Pagesa për shërbime teknike, mirëmbajtje dhe sigurim fizik.

3.2 Shpenzime komunale (dhjetor 2024 – dhjetor 2025)

- Shpenzimet e rrymës;
- Shpenzimet e ujit;
- Shpenzimet e telefonisë fikse;
- Shpenzimet e mbeturinave;
- Shpenzimet postare;
- Telefonia mobile – VALA.

3.3 Shpenzime të rrymës me vendim të Kryetarit

- Pompat e ujit në Vranoc;
- Radio Peja;
- Gorazhdec;
- KK–Access Action Program (Zyra e Turizmit afër Patrikanës) – rrymë, ujë dhe mbeturina;
- Pagesa për kyçje të rrymës për Shtëpinë e Fshatit – Dubovë;
- Pagesa për kyçje të rrymës për pompat e ujit në lagjen “Asllan Qeshme”.

3.4 Menaxhimi i pasurisë dhe evidencës

- Regjistrimi i materialit shpenzues në sistemin **e-Pasuria**;
- Regjistrimi i aseteve, nxjerrja e barkodeve, ngarkimi dhe transferimi sipas kërkesave;
- Evidentimi i shpenzimeve komunale në databazën përkatëse;
- Barazimi i pagesave me kompanitë **KESCO**, **AMBIENTI** dhe **HIDRODRINI**;
- Nxjerrja e barkodeve për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Arsimit.

4. Përfundim

Sektori për Logjistikë gjatë vitit 2025 ka kontribuar në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme në përmirësimin e proceseve të brendshme, duke siguruar funksionim efikas, të organizuar dhe transparent. Bashkëpunimi i ngushtë me drejtoritë ka mundësuar realizimin me sukses të të gjitha detyrave dhe përgjegjësi të sektorit.

7. MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE RIINTEGRIM

- Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, Zyra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim në Komunën e Pejës ka ushtruar me përkushtim përgjegjësitë e saj ligjore dhe funksionale, në përputhje me legjislacionin vendor për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.
- Fokusi kryesor i punës ka qenë zhvillimi dhe forcimi i mekanizmave funksionalë për mbrojtjen e fëmijëve, koordinimi ndërinstitutional, përfshirja aktive e fëmijëve në proceset vendimmarrëse, ngritja e kapaciteteve profesionale si dhe zbatimi i programeve komunitare në nivel lokal.
- Zyra ka udhëhequr dhe monitoruar zbatimin e politikave komunale për të drejtat e fëmijëve, ka hartuar plane veprimi dhe raporte zyrtare, ka ofruar këshillim për strukturat komunale dhe ka iniciuar projekte ndërinstitutionale dhe ndërsektoriale. Një rol i rëndësishëm është luajtur edhe në përfaqësimin e Komunës së Pejës në nivel qendror, përmes koordinimit me institucionet përkatëse.
- Gjatë vitit 2025, janë organizuar takime informuese në shumicën e SHFMU-ve të Komunës së Pejës, me qëllim informimin e nxënësve mbi Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe funksionimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF). AKF ka funksionuar si mekanizëm aktiv përfaqësues, duke mbajtur seanca të rregullta, duke marrë pjesë në dëgjime buxhetore dhe duke organizuar aktivitete edukative, kulturore dhe sensibilizuese, përfshirë shënimin e ditëve ndërkombëtare dhe 20-vjetorin e themelimit të saj.
- Zyra ka realizuar dhe mbështetur aktivitete sensibilizuese për të drejtat e fëmijëve, shëndetin mendor, gjithëpërfshirjen sociale, mbrojtjen e mjedisit dhe dialogun ndërfetar. Po ashtu, stafi ka marrë pjesë në trajnime, punëtori, konferenca dhe tryeza profesionale të organizuara nga institucione dhe organizata vendore e ndërkombëtare, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale.
- Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe partnerët institutionalë ka qenë i vazhdueshëm dhe i strukturuar, duke përfshirë OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, si dhe institucionet komunale dhe qendrore. Janë zhvilluar takime të rregullta koordinuese, konsultime publike dhe dëgjime buxhetore, me theks në përfshirjen e interesave të fëmijëve dhe të rinjve në politikat publike.
- Gjatë procesit të monitorimit dhe raportimit, është evidentuar realizim pothuajse i plotë i objektivave vjetore, me theks të veçantë në parandalimin, identifikimin e hershëm të rasteve dhe ndërgjegjësimin e komunitetit.
- Në përfundim, viti 2025 u karakterizua nga forcimi i mekanizmave komunalë për mbrojtjen e fëmijëve, rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional, përfshirja aktive dhe e strukturuar e fëmijëve në vendimmarrje, zhvillimi i fushatave sensibilizuese dhe realizimi i suksesshëm i objektivave strategjike të Zyrës.

Për detale i bashkëngjitur është aneksi dhe i dorëzuar te Drejtoresha e drejtorisë.

Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë

Nita Panduri Mullarama



**RAPORTI VJETOR I PUNËVE TË
KRYERA DHE AKTIVITETEVE NGA
DREJTORIA E
BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE
HIDROEKONOMISË**

JANAR-DHJETOR, 2025

Përmbajtja:

1.LLOJI DHE NUMRI I KËRKESAVE

- 1.1. Tabela e kërkesave të ndara sipas numrit dhe statusit
- 1.2. Tabela e kërkesave sipas kategorive
 - 1.2.1. Inksasimet e të hyrave nga vendimet për ndërrim të destinacionit të tokës
- 1.3. Rritja në përqindje e kërkesave të parashtruara në DBPH për vitin 2025
- 1.4. Kërkesat e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe vërshimet

2.SUBVENCIONET NGA DREJTORIA E BUJQËSISË

- 2.1 Përkrahja e fermerëve me mekanizëm bujqësor

3.INVESTIMET KAPITALE

- 3.1 Planifikimi i inv.kapitale (kanaleve të ujitjes) për vitin 2025-2026

4.AKTIVITET E DREJTORISË PËR BUJQËSI

- 4.1 Monitorimi i Vendgjuetive
- 4.2 Takim me fermerë për mbështetjen e politikave mbështetëse për fermerë
- 4.3 Vazhdimi i implementimit të bashkëpunimit me Organizatën “Islamic Relief Kosova”
- 4.4 Promovimi i projektit “Trajtimi i qenëve dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës”.
- 4.5 Inspektimi i punëve tek kanalet e ujitjes sipas kontratave të nënshkruara
- 4.6 Konsultimi Publik për Draft Rregulloren për Taksa dhe Tarifa Komunale
- 4.7 Përmbyllja e projektit “Furnizim me sera dhe mekanizëm bujqësor”, bashkëpunim me IRK
- 4.8 Takim me gratë bletare organizuar nga EcoKosWomen (EKW)
- 4.9 Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me KRU “Drini i Bardhë”
- 4.10 Inspektimi i punimeve të kanalit të ujitjes
- 4.11 Shënimi i Ditës së Mjedrës
- 4.12. Bashkëpunimi me D&D Business Support Center
- 4.13 Vizita në terren nga ekipet e Drejtorisë së Bujqësisë
- 4.14 Vizita në terren tek fermerët e ndryshëm gjatë procesit të korrje-shirrjeve.
- 4.15 Trajnim profesional në bashkëpunim me ambasadën franceze
- 4.16 Hapja e ambulantes për trajtimin e qenëve endacak në Komunën e Pejës

5.SUBVENCIONET E MBPZHR

- 5.1 Afati i aplikimit për TM2 i vitit 2024
- 5.2 Afati i aplikimit në Programin e Pagesave Direkte për sipërfaqet e mbjellura me kultura bujqësore të përcaktuara në PPD 2025
- 5.3 Afati i aplikimit për TM1 2025 si dhe për kilogram të dorëzuar të sasisë së grurit.

Gjatë vitit raportues, Drejtoria e Bujqësisë në Komunën e Pejës ka zhvilluar aktivitetet e saj në përputhje me kompetencat ligjore dhe strategjitë komunale për zhvillimin e bujqësisë, me qëllim të mbështetjes së fermerëve dhe rritjes së prodhimit bujqësor në territorin e Komunës.

Drejtoria ka hartuar dhe zbatuar planin vjetor të punës, ka bashkëpunuar me institucionet qendrore dhe lokale duke siguruar kështu zbatimin e politikave bujqësore në nivel komunal.

Drejtoria e Bujqësisë vlerëson se aktivitetet e realizuara gjatë vitit kanë kontribuar në zhvillimin e sektorit të bujqësor në Komunën e Pejës. Për vitin e ardhshëm rekomandohet vazhdimi i mbështetjes për fermerët, rritja e investimeve në infrastrukturën bujqësore dhe forcimi i bashkëpunimit institucional.

1.LLOJI DHE NUMRI I KËRKESAVE

Drejtoria e Bujqësisë gjatë këtij viti ka pranuar dhe trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash nga fermerët dhe palët e interesuara, të cilat kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarive bujqësore në territorin e Komunës, si psh:

Llojet e kërkesave të parashtruara	
1.	Kërkesa për përfitim nga skemat e subvencionimit dhe grantet bujqësore
2	Kërkesa për regjistrim dhe verifikim të fermave dhe parcelave bujqësore
3.	Kërkesa për këshillim teknik dhe profesional në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë
4.	Kërkesa për përdorimin, shfrytëzimin dhe ndrrimin e destinimit të tokës bujqësore
5.	Kërkesa për ndrrim të kulturës
6.	Kërkesa për marrje me qera të tokës bujqësore komunale

1.1 Në tabelën e posht-shënuar janë të paraqitura kërkesat e ndara sipas numrit dhe statusit të shqyrtimit të lëndëve:

	Të pranuar	Në proces	Të miratuara	Të refuzuara	Të pezulluara	Të anuluar
	1,109 kërkesa	22 kërkesa	560 kërkesa	520 kërkesa	2 kërkesa	4 kërkesa

- **1.1.1 Kërkesa për marrje me qira të tokës bujqësore komunale:** 7 aplikues si person fizik. Aplikues si person juridik nuk kemi pasur.
-` Kjo taksë është vendosur në Rregulloren Nr. 02-2025 Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02-2023 (KPE) për Taksa Komunale dhe konfirmimin e ligjeshmerise, të Seancës së rregulltë të dt. 29.05.2025.

Totali/ ha i spërfaqes së leshuar të tokës komunale me qera për këtë vit : **14.16 ha**

- **1.1.2 Ndririmi i destinacionit të tokës:** 4 aplikues si person juridik dhe 23 aplikues si persona fizik.

Totali i të hyrave – 58,674.04 €

Poashtu këtë vit kemi pasur interesim dhe paraqitje të kërkesave për ndrim të destinimit të tokës, për shfrytëzim energjetik, me qëllim instalimin e paneleve fotovoltaike (solare) për prodhim të energjisë së rinovueshme
Të gjitha kërkesat janë paraqitur nga persona juridik/biznese.

Të hyrat nga ndrrimi i destinimit të këtyre kërkesave: 241,244.53 €

Sipërfaqja totale: 286 ha,86 ari e 07m2.

Të gjitha kërkesat e pranuar janë evidentuar, regjistruar dhe shqyrtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e brendshme të Drejtorisë. Procesi i shqyrtimit ka përfshirë verifikimin e dokumentacionit përkatës, vlerësimin në terren si dhe bashkëpunimin me institucionet kompetente kur ka qenë e nevojshme.

Në përfundim të shqyrtimit, kërkesat janë aprovuar, refuzuar ose kthyer për plotësim të dokumentacionit ,duke respektuar afatet ligjore dhe duke garantuar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjitha palët,

Një numër i konsiderueshëm i kërkesave në sistem kanë qenë edhe aplikuesit të cilët kanë aplikuar në Thirrjet Publike të shpallura nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

- ✚ Nga Komisioni Komunal i Vlerësimit të Dëmeve janë pranuar dhe janë në shqyrtim kërkesa të dëmeve të shkaktuara nga fatkqesitë e ndryshme natyrore,si dhe dëme të shkaktuara ne sektorin e blegtorisë nga sëmundje të ndryshme.

2. SUBVENCIONET E D.B.P.H

2.1 Në bazë të planifikimit buxhetor dhe planit të prokurimit, Drejtoria për Bujqësi me dt.04.02.2025 ka shpallur Thirrje Publike për aplikim të projektit **“Përkrahja e fermerëve-bujqëve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor”**, me vlerë totale **166,950.00 Euro**, projekt ky ku Komuna ka participuar me 70% kurse fermerët 30 % të vlerës financiare.

Për këtë projekt kanë aplikuar **657 fermerë**, përfitues janë shpallur **172** prej tyre.

Mekanizmat e shpërndarë janë:

1. Freza 1.8m (60 copë)
2. Freza 2.0m (20 copë)
3. Spërkatëse 400 L (25 copë)
4. Mikser për përgaditjen e ushqimit të kafshëve (5 copë)
5. Mbjellëse e grurit 16 rendëshe (10 copë)
6. Rotokosa 135 (10 copë)
7. Rotokosa 165 me kardan (10 copë)
8. Mbjellëse dy rendore e patates (4 copë)
9. Mbjellëse 5 rendëshe e qepujkave (4 copë)
10. Nxjerrëse e patates/qepës një rendore (4 copë)
11. Grabuja me traka me kardan (20 copë)

Poashtu në muajn korrik, nga lista e pritjes nga aplikacionet e mbetura është shpallur edhe grupi i dytë përfitues i projektit **“Përkrahja e fermerëve-bujqëve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor”**, me vlerë totale **79,810.00 Euro** , ku u përkrahen gjithsej **77 fermerë**.

Edhe në këtë pjesë të dytë participimi ka qenë : 70% Komuna e Pejës dhe 30% fermeri përfitues.

Janë shpërndarë këto paisje:

- **Freza 1.8 (30 copë)**
- **Freza 2.0 (15 copë)**
- **Spërkatëse (8 copë)**
- **Rotokosa 135 (12 copë)**
- **Rotokosa 165 me kardan (12 copë).**

3.INVESTIMET KAPITALE

Sipas planifikimit buxhetor dhe planit të Prokurimit janë kontraktuar gjithsej **5 LOTE** për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në fshatrat e Komunës së Pejës, duke u bazuar në kërkesat e fermerëve si dhe kryetarëve të Bashkësive Lokale.

Kanalet e planifikuara janë në këto fshatra: Vragoc, Pavlan, Qyshk, Gllaviqicë, Ramun, Trestenik, Nabërgjan, Loxhë, Çallapek, Baran, Raushiq, Dobërdol, Kosuriq, Broliq, Graboc, Llabjan, Ruhot, Nakëll, Ozdrim, Dubovë, Leshan, Kliqinë, si dhe në fshatrat e Podgurit.

Sipas raporteve të mbikëqyrësve të kontratave për kanale, dhe pagesave të realizuara nga DBPH më poshtë gjeni tabelarin e punëve të kryera:

3.1 NË TABELËN MË POSHTË JANË TË PARAQITURA PROJEKTET E KONTRAKTUARA TË INVESTIMEVE KAPITALE 2024-2026:

Nr.	Projekti	Shuma e kontratës	Të paguara	Përfunduar/ Në proces	Pagesat në % të punëve të realizuara
1.	Ndërt.i kanaleve të ujitjes në fshatrat: Baran i Ulët, Baran i Epërm, Çallapek, Kosuriq, Penda e Vranocit dhe Broliq LOT 1	198,979.50 €	105,801.19 €	Në proces	53.17 %
2.	Ndërt.i kanaleve në fshatrat: Loxhë, Vragoc, Dobërdol dhe Graboc LOT 2	131,225.50 €	72,459.80 €	Në proces	55.22 %
3.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat: Pavlan, Gllaviqicë, Ramun, Leshan dhe Kliqinë LOT 3	128,994.50 €	41,000.00 €	Janë ndërprerë punimet	31.8 %
4.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat: Trestenik, Nabërgjan, Llabjan, Dardania III, Ruhot dhe Nakëll LOT 4	188,264.00 €	173,045.25 €	Në proces	91.92 %
5.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat: Ozdrim, Dubovë, fshatrat e Podgurit dhe ndërtimi i mureve të Pendës së Vranocit LOT 5	164,444.44 €	164,444.44 €	Përfunduar	100 %

Realizimi i këtyre investimeve ka kontribuar në sigurimin e ujit për sipërfaqe të konsiderueshme bujqësore, rritjen e produktivitetit të kultivimeve ,zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe përmirësimin e qendrueshmërisë së bujqësisë në zonat rurale.

Punët që nuk janë përfunduar gjatë vitit do të vazhdojnë sipas planit të implementimit në vitin pasues.

3.2 Gjatë vitit raportues, Drejtoria e Bujqësisë ka kryer pagesa financiare në kuadër të investimeve kapitale dhe mbështetjes së fermerëve përmes subvencioneve, në përputhje me planin vjetor të buxhetit dhe prioritetet strategjike të sektori.

Investime kapitale –423,982.78 Euro (Të planifikuara 550,000.00 €) – Realizimi 77.1 % i buxhetit.

Subvencione – 268,684.63 Euro (Të planifikuara 270,000.00 €)- Realizimi 96.59 % i buxhetit.

4. AKTIVITET E D.B.P.H-së

4.1 Monitorim i vazhdueshëm i Vendjguetive. Shoqata e Gjuetarëve “Reqebulli” në periudhën dimërore ka ndihmuar kafshët e egra malore duke u përkujdesur për ushqyeshmërinë e tyre.

4.2 Me dt.14 Janar Komuna e Pejës përmes Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, ka mbajtur takim me fermerë për të diskutuar nga afër nevojat dhe kërkesat e tyre, në mënyrë që DBPH t’i hartojë politikat e mbështetjes së fermerëve, investime këto të cilat ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjes së prodhimeve bujqësore.

4.3 Gjatë muajit shkurt ka vazhduar implementimi i projektit “Përkrahja e fermerëve në ngritjen e serave”, (vazhdimi i montimit të serave të fermerëve përfitues) sipas marrëveshjes në mes të Komunës së Pejës dhe IRK – Zyra në Kosovë.

4.4 Me dt.27 shkurt Komuna e Pejës ka bërë promovimin e projektit “Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës”, kontratë kjo e lidhur me operatorin ekonomik “KUQI FARMS” SH.P.K me seli në fsh.Lutogllavë ,KK Pejë. Ky projekt ka për qëllim trajtimin e qenëve endacak si dhe rritjen e sigurisë për qytetarët e Komunës së Pejës.

4.5 Gjatë muajit mars dhe prill ka vazhduar inspektimi i punëve tek kanalet e ujitjes në fshatrat e Komunës së Pejës,në fshatin Çallapek si dhe përmirësimi i punëve të kryera tek kanali i ujitjes në fshatin Llugaxhi si dhe në fshatin Dubovë dhe Trestenik, dhe tek penda e Vranocit projekte këto me rëndësi të veçantë për komunitetin lokal.

4.6 Me dt.07 prill Drejtoria e Bujqësisë dhe Zyra për Informim Publik kanë organizuar Konsultimin Publik për Draft- Rregulloren për Taksa Komunale Nr.02-2025 për marrjen me qera të tokës komunale për kultura një vjeçare, për Plotësim Ndryshimin e Rregullores nr.02-2023 KPE për Taksa Komunale.

4.7 Shpërndarja e fundit e përfituesve të mekanizmit bujqësor nga bashkëpunimi mes KK Pejë dhe IRK ,u realizua me dt.08 prill, ku u shperndan edhe 5 makina mbjellëse të misrit,duke mbyllur kështu me sukses edhe këtë bashkëpunim.

4.8 Me dt.18 qershor u mbajt një takim i veçantë i organizuar nga EcoKosWomen (EKW) me gratë bletare, në prani të Drejtorisë për Bujqësi, Zyrës për Barazi Gjinore si dhe përfaqësuesve nga organizata partnere We Effect.

Qëllimi i takimit ishte fuqizimi i grave bletare në fushën e bletarisë përmes dialogut, bashkëpunimit dhe identifikimit të nevojave konkrete për mbështetje.

4.9 Është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me KRU “Drini i Bardhë” për ndihmë të fermerëve në hapjen dhe pastrimin e kanaleve të ujitjes në vlerë totale 10,000.00 Euro.

4.10 Inspektimi i punimeve të kanalit të ujitjes në fshatin Dobërdol dhe Radavc, projekt ky me rendësi të veçantë për komunitetin lokal.

4.11 Në bashkëpunim me shoqatën nacionale të pemëve të imëta “Mjedra e Kosovës” kemi organizuar aktivitet për të shënuar Ditën e Mjadrës, në fshatin Radavc, ku kemi diskutuar për sfidat dhe potencialin e mjadrës si dhe për të fuqizuar bashkëpunimin mes fermerëve dhe institucioneve.

4.12. Përmes Drejtorisë për Bujqësi, në bashkëpunim me D&D Business Support Center është zhvilluar sesion informues për Skemen e Granteve për Zhvillim Rural, duke mbledhur fermerë, biznese rurale dhe individë të interesuar për të përfituar nga kjo mundësi.

4.13 Vizita në terren nga ekipet e Drejtorisë së Bujqësisë në parcela për verifikimin e mbjelljes së fidaneve të mjadrës nga fermerët përfitues të mbështetjes komunale.

4.14 Vizita në terren tek fermerët e ndryshëm gjatë procesit të korrje-shirrjeve.

4.15 Kemi mbajtur trajnim profesional për blegtorë , i organizuar nga bashkëpunimi në mes të Komunës së Pejës dhe ambasadës franceze, me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive në fushën e blegtorisë.

4.16. Hapja e ambulantes per trajtimin e qeneve endacak të Komunes se Pejës.

FOTO NGA AKTIVITETET E LARTËPERMENDURA:










5. SUBVENCIONET E MBPZHR-së (PROGRAMI I PAGESAVE DIREKTE)

5.1 Nga dt.**15.01-13.02.2025**, MBPZHR-ja ka shpallur thirrje për aplikim për TM2(subvencionim për qumësht sipas cilësisë,viça për majmëri, therrje dhe akuakulturë) për vitin 2024.




5.2 Programi për Pagesa Direkte për vitin 2025, nga MBPZHR është shpallur nga dt.03.04.2025 deri me 02.05.2025.

Kanë aplikuar gjithsej **1877** fermerë nga Komuna e Pejës, me të mbjellura në sipërfaqe totale prej **9000ha**, ku më së shumti dominon misri dhe gruri:

1. Misri 5143.6ha
2. Gruri 2856.1ha

5.3 Me dt. 01.08.2025 deri me 01.09.2025 nga MBPZHR është shpallur afati i aplikimit për TM1 2025 (subvencionim për qumësht sipas cilësisë,viça për majmëri, therrije , akuakulturë dhe sasi të dorëzuar të grurit).



Qëllimi kryesor i këtij subvencionimi nga ana e MBPZHR-së ka për synim sigurimin e stabilitetit të të ardhurave për fermerët dhe bizneset bujqësore, rritjen e prodhimit dhe sigurisë ushqimore në vend, zbutjen e riskut ekonomik nga ndryshimet e çmimeve të tregut etj.

PËRMBLEDHJE:

✚ Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Bujqësisë përmes subvencioneve ka ndihmuar **249** fermerë me paisje të ndryshme bujqësore, në menyre që të krijohen kushte me të mira të punës:

1. Freza 1.8m (**90 copë**)
2. Freza 2.0m (**35 copë**)
3. Spërkatëse 400 L (**33 copë**)
4. Mikser për përgaditjen e ushqimit të kafshëve (**5 copë**)
5. Mbjellëse e grurit 16 rendëshe (**10 copë**)
6. Rotokosa 135 (**22 copë**)
7. Rotokosa 165 me kardan (**22 copë**)
8. Mbjellëse dy rendore e patates (**4 copë**)
9. Mbjellëse 5 rendëshe e qepujkave (**4 copë**)
10. Nxjerrëse e patates/qepës një rendore (**4 copë**)
11. Grabuja me traka me kardan (**20 copë**)

✚ Nga Drejtoria janë ndihmuar **1877** fermerë për përgaditjen e dokumentacionit dhe aplikim në sistemin elektorinik eFR gjatë afateve të subvencioneve të shpallura nga MBPZHR, me gjithsej **9000ha** të mbjellura nga kultura të ndryshme bujqësore.

✚ Totali i mjeteve financiare, subvencione nga Drejtoria e DBPH-së: **255,050.00** Euro.

✚ Vlera totale e kontratave të nënshkruara për investime kapitale për vitin 2024/2026 : **811,907.94 € , 10 mijë metra kanal te ujitjes.**

Si përfundim ,nga rezultati i këtyre angazhimeve, objektivat e planifikuara për vitin raportues janë arritur në masë të kënaqshme, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve për fermerët, zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe forcimin e rolit të Drejtorisë së Bujqësisë në nivel lokal.

AKTIVITETET nga Qendra Këshilluse Komunale (QKK) për Bujqësi e Zhvillim Rural – Pejë

1. Diskutim për forcimin e shërbimeve këshillimore në interes të prodhuesve bujqësor dhe mundësia e shitjes së orgaizuar të perimeve.
2. Në bashkpunim me kooperativën AGROCELINA – Rahovec është prezentuar programi i mundësive për shitjen e ferimeve përmes kontratës njëvjeqare dhe kushteve të mbështetjes së kultivuesve të perimeve përmes kësaj kompanie.
3. Në kuadër të projektit "zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore" implimentuar nga KDC, janë organizuar këshillime me fermerë me temat:
 - a) Këshillim; Te ushqyerit e vijaqave për majmeri ku kanë marrë pjesë 19 fermer,
 - b) Këshillim; krasitja dimrore e arrës, 11 pjesëmarrës,
 - c) Këshillim Mbjelljet pranverore-hibridet e misrit, pjesëmarrës 11 fermer.
 - ç) Këshillim: Higjiena në fermat blegtorale, pjesëmarrës 14 blegtor,
 - d) Këshillim: Kultivimi i perimeve në sera dhe fushë të hapur, në këshillim mure në pjesë 12 perimtar,
 - e) Këshillim; kultivimi i pemëve të imta (mjedrë, dredhza, boronica, manaferra, etj), pjesëmarrës 13 fermer
 - f) Këshillim; përgaditja e sillazhës së misrit, pjesëmarrës 7 blegtorë
 - Këshillim; Mbrojtja e perimeve nga smundjet dhe dëmëtuësit në sera dhe fushë të hapur, pjesëmarrës 9 kultivues të perimeve,
 - Këshillim ; Kontabiliteti në fermë, pjesëmarrës 10 fermer.
 - Këshillim; mbarshtimi i pulave vojse dhe brojlerve, pjesëmarrës 7 fermer,
 - Këshillim;Përgaditja e tokës për ngritjen e pemishteve të reja, pjesëmarrës 9 pemtar,
 - Këshillim; përkujdesi ndaj bletëve, pjesëmarrës 11 bletarë,
 - Këshillim në bashkpunim me KDC –ën është përpiluar lista e pjesëmarrësve në trajnimin mbi ujëgjennë e kulturave bujqësore dhe menaxhimin e ujit. Në këtë trajnim tre ditë nga K. Pejë kanë marrë pjesë 11 fermer.
4. -Konferenca kombëtare-pozitive e fermerëve në zingjirin e vlerës bujqësore, Organizuar nga Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural të Kosovës, në kuadër të projektit rajonal " Farm to Fark" i zbatuar nga rrjeti i Organizatave për Zhvillim rural të Shqipërisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DREJTORATI PËR BUXHET E FINANCA

RAPORTI

**I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE TË REALIZUARA BUXHETORE PËR PERIUDHËN
JANAR – DHJETOR TË VITIT 2025**

PEJË , JANAR 2026

PËRMBAJTJA :

Përshkrimi	Faqja
Përmbajtja	1
Buxheti i realizuar komunal për periudhën janar -dhjetor 2025	2
Të dhënat e punësimit	3
Të hyrat vetanake të realizuara gjatë periudhës janar - dhjetor 2025	4 - 6
Shpenzimet e realizuara buxhetore për periudhën janar - dhjetor 2025	7-23
Zyra e Kryetarit	24
Administrata dhe personeli	25
Çështjet gjinore	26
Integrimet Europiane	26
Inspekcioni	27
Prokurimi	28
Asambleja Komunale	28
Buxhet e financa	29
Punë komunale , shërbime publike	30
Emergjenca - zjarrfikësat	31
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	32
Bujqësi , pylltari , zhvillim rural	33
Zhvillimi ekonomik	34
Gjeodezi dhe kadastër	35
Çështje pronësoro - juridike	36
Planifikimi urban dhe mjedisi	37
Shëndetësia - Administrata	38
Shëndetësia - Kujdesi primar shëndetsor	38-39
Shëndetësia - Shërbime sociale - Sh. Rezedencijale Pejë	40
Shërbimet kulturore	41
Teatri	42
Arsimi - Administrata	43
Arsimi - Arsimi parashkollor - Çerdhet	44
Arsimi - Arsimi fillor	45
Arsimi - Arsimi i mesëm	46

BUXHETI I REALIZUAR KOMUNAL PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR TË VITIT 2025

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (Nr. 03/L-048) i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-221 , Ligjin Nr.04/L-116 , Ligjin Nr.04/L-194 , Ligjin Nr.05/L-063 dhe me Ligjin Nr.05/L-007 Drejtorati për buxhet e financa është i obliguar t'i dorëzoj raportet dymbëdhjet mujore dhe raportin vjetor të buxhetit për vitin fiskal .

Raporti ka për qëllim informimin sa më objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përbushjes së planit dhe grumbullimit të mjeteve sipas burimeve,përbushjes së obligimeve të planifikuara sipas planprogrameve,dinamikën dhe strukturën mjeteve të planifikuara si dhe realizimin e tyre sipas kategorive të përcaktuara buxhetore,angazhimet kadrovike si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë .

Ecuria e të hyrave të arketuara dhe shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës JANAR-DHJETOR të vitit 2025 është e prezentuar tek të gjitha programet në raport me planin vjetor dhe realizimin gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak .

TË DHËNAT E PUNËSIMIT

Sipas Ligjit Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Republikën e Kosovës për vitin 2025 Komuna e Pejës ka planifikuar të punësojë 2208 puntorë . Ky plan gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit raportues është realizuar 98.78 % , ndërsa dinamika e të punësuarve në raport me periudhën krahasuese është më lart për 1.12 % . Në fund të periudhës raportuese numri i të punësuarve është 2181

Kodi i programit	Emërtimi i kodit	Numri aktual I - XII - 2024	Planifikimi I - XII - 2025	Numri aktual I - XII - 2025	Progresi :		%
					5 / 3	5 / 4	
1	2	20	4	5	6	7	8
16019	Zyra e Kryetarit	20	20	19	95.00%	95.00%	0.87%
163	(I+II+III) Administrata dhe personeli	58	61	57	98.28%	93.44%	2.61%
16319	I. Administrata	56	59	55	98.21%	93.22%	96.49%
16519	II. Çështjet gjinore	1	1	1	100.00%	100.00%	1.75%
16559	III. Integrimet europiane	1	1	1	100.00%	100.00%	1.75%
16637	Inspeksioni	24	27	24	100.00%	88.89%	1.10%
16795	Prokurimi	4	4	4	100.00%	100.00%	0.18%
16919	Asambleja komunale	66	35	35	53.03%	100.00%	1.60%
17519	Buxhet e financa	32	33	30	93.75%	90.91%	1.38%
180	(I+II) Punë komunale,shërbime publike	53	54	52	98.11%	96.30%	2.38%
18019	I. Infrastruktura rrugore	13	14	13	100.00%	92.86%	25.00%
18295	II. Emergjencia - zjarrëfikësat	40	40	39	97.50%	97.50%	75.00%
19595	Zyra lokale e komuniteteve	8	8	7	87.50%	87.50%	0.32%
47019	Bujqësi , pylltari , zhvillim rural	20	23	21	105.00%	91.30%	0.96%
48019	Zhvillim ekonomik	6	6	6	100.00%	100.00%	0.28%
650	(I+II) Gjeodezi dhe kadastër	22	23	22	100.00%	95.65%	1.01%
65095	I. Shërbime kadastrale	18	18	18	100.00%	100.00%	81.82%
65495	II. Çështje pronësore - juridike	4	5	4	100.00%	80.00%	18.18%
66100	Planifikimi urban dhe mjedisi	11	12	10	90.91%	83.33%	0.46%
730	Shëndetësia	338	358	348	102.96%	97.21%	15.96%
73028	- Administrata	4	4	4	100.00%	100.00%	1.15%
74100	- Kujdesi primar shëndetsor	334	354	344	102.99%	97.18%	98.85%
75590	Shërbimet Sociale	18	30	18	100.00%	60.00%	0.83%
75591	Shërbimet Sociale - Pejë	18	20	18	100.00%	90.00%	0.83%
75592	Shërbimet Rezedenciale - Pejë	0	10		#DIV/0!	0.00%	0.00%
850	Kulturë , rini , sport	42	57	49	116.67%	85.96%	2.25%
85019	Shërbimet kulturore	28	35	34	121.43%	97.14%	69.39%
85184	Teatri	14	22	15	107.14%	68.18%	30.61%
920	Arsimi	1485	1457	1479	99.60%	101.51%	67.81%
92095	- Administrata	14	15	14	100.00%	93.33%	0.95%
92570	- Arsimi parashkollor - Çerdhet	91	99	99	108.79%	100.00%	6.69%
93540	- Arsimi fillor	998	969	990	99.20%	102.17%	66.94%
94740	- Arsimi i mesëm	382	374	376	98.43%	100.53%	25.42%
	Gjithsej :	2207	2208	2181	98.82%	98.78%	100.00%

Nga tabela e mësipërme mund të përcjellët dinamika e të punësuarve nëpër drejtori,si në raport me periudhën krahasuese poashtu edhe në raport me numrin e planifikuar për vitin 2025

TË HYRAT VETANAKE TË REALIZUARA GJATË PERIUDHËS JANAR - DHJETOR TË VITIT 2025

Gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2025 dinamika dhe struktura e të hyrave të realizuara vetanake shënon ecuri të ndryshme , si në raport me planifikimin për vitin 2025, poashtu edhe në raport me realizimin gjatë periudhës krahasuese.

(në euro)

Kodi ekonomik	Emërtimi i kodit	Realizimi I - XII- 2024	Planifikimi I - XII - 2025	Realizimi I - XII - 2025	Progresi :		%
					5 / 3	5 / 4	
1	2	3	4	5	6	7	8
16019	Zyra e Kryetarit	0.00	2.00	0.00	#DIV/0!	0.00%	0.00%
163	(I+II+III) Administrata dhe personeli	145,055.65	171,000.00	135,113.00	93.15%	79.01%	2.06%
16319	Administrata	145,055.65	171,000.00	135,113.00	93.15%	79.01%	2.06%
50013	Taksa për certifikata të lindjes	14,674.00	20,000.00	7,140.00	48.66%	35.70%	5.28%
50014	Taksa për certifikata të kurorëzimit	8,491.00	10,000.00	8,835.00	104.05%	88.35%	6.54%
50015	Taksa për certifikata të vdekjes	4,843.00	5,000.00	5,377.00	111.03%	107.54%	3.98%
50016	Taksa për certifikata të ofiqarisë	102,803.00	120,000.00	99,126.00	96.42%	82.61%	73.37%
50017	Taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme	5,502.00	3,500.00	9,145.00	166.21%	261.29%	6.77%
50018	Taksa për fotokopjim të dokumenteve	5,162.50	7,000.00	5,284.50	102.36%	96.08%	3.91%
50019	Taksa tjera administrative	580.15	5,500.00	30.00	5.17%	948.03%	0.02%
50025	Taksa për shtetësi	0.00		0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50109	Kompensimi I demeve nga kompensimi I sigurimit	3,000.00	0.00	0.00	0.00%	#DIV/0!	0.00%
50408	Qiraja nga objektet publike	0.00	0.00	175.50	#DIV/0!	#DIV/0!	0.13%
	Të hyrat vetanake	145,055.65	171,000.00	135,113.00	93.15%	79.01%	100.00%
16637	Inspekcioni	110,406.70	42,000.00	83,435.00	75.57%	198.65%	1.28%
50104	Gjobat nga inspektorati - denimet mandatore	12,866.70	18,000.00	4,400.00	34.20%	24.44%	25.69%
50205	Licencat për pranim teknik të lokalit	21,235.00	18,000.00	12,730.00	59.95%	70.72%	74.31%
50501	Inspektimi i artikujve ushqimor	0.00	1,000.00	0.00	#DIV/0!	0.00%	0.00%
50505	Inspektimi veterinar brenda vendit	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50507	Inspektimi higjienik sanitar	0.00	5,000.00	0.00	#DIV/0!	0.00%	0.00%
	Të hyrat vetanake	34,101.70	42,000.00	17,130.00	50.23%	40.79%	20.53%
50102	Gjobat nga gjykatat	76,305.00	0.00	66,305.00	86.89%	#DIV/0!	79.47%
17519	Buxhet e financa	4,453,780.47	3,232,177.00	3,392,076.19	76.16%	104.95%	51.84%
40110	Tatimi në pronë	2,213,583.47	2,401,980.00	2,202,580.88	99.50%	91.70%	87.58%
	Tatimi në tokë	0.00	570,197.00	0.00	#DIV/0!	0.00%	0.00%
50001	Taksa e regjistrimit të automjeteve	285,967.00	260,000.00	312,475.00	109.27%	120.18%	12.42%
50017	Taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50019	Taksat tjera administrative	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50290	Licenca të tjera në afarizëm	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
	Të hyrat vetanake	2,499,550.47	3,232,177.00	2,515,055.88	100.62%	77.81%	74.15%
50101	Gjobat në trafik	1,044,141.50	0.00	877,020.31	83.99%	#DIV/0!	25.85%
	Donacionet e jashtme	910,088.50	0.00	0.00	0.00%	#DIV/0!	0.00%
	Qeveria Zvicrane	910,088.50	0.00	0.00	0.00%	#DIV/0!	#DIV/0!
	Helvetas&Demos						#DIV/0!
180	(I+II) Punë komunale , shërbime publike	63,581.21	70,000.00	59,947.52	94.28%	85.64%	0.92%
18019	I. Infrastruktura rrugore	63,581.21	70,000.00	59,947.52	94.28%	85.64%	100.00%
50008	Taksa për parkim publik ,kampim,rekreacion	24,155.00	30,000.00	19,370.00	80.19%	64.57%	32.31%
50212	Licenca për rekl dhe publik në prona publike	39,426.21	40,000.00	38,052.74	96.52%	95.13%	63.48%
61000	Të hyrata nga viti I kaluar	0.00	0.00	2,524.78	#DIV/0!	#DIV/0!	4.21%
	Të hyrat vetanake	63,581.21	70,000.00	59,947.52	94.28%	85.64%	100.00%
18295	II. Emergjencia - zjarrëfikësat	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
47019	Bujqësi , pylltari , zhvillim rural	61,488.51	11,897.60	572,752.39	931.48%	4814.02%	8.75%
50012	Taksa për ndrrimin e destinimit të tokës	18,919.70	10,816.00	496,564.39	2624.59%	4591.02%	99.57%
50103	Gjobat nga pyjet	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%

500121	Taksat për zhavor	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
500122	Pëlqimi për eksplotimin e resurseve natyrore	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%

500123	Çertifikata për transportin e kafshëve	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50020	Taksa për pjesëmarrje në tender	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50203	Licenca për gurthyes dhe miniera	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50403	Të hyrat nga shitja e mallrave	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50405	Shfrytëzimi i pronës publike	2,160.00	1,081.60	2,160.00	100.00%	199.70%	0.43%
	Të hyrat vetanake	21,079.70	11,897.60	498,724.39	2365.90%	4191.81%	87.08%
56000	Donacionet e brendshme	40,408.81	0.00	74,028.00	183.20%	#DIV/0!	12.92%
	Participim i qytetarëve	40,408.81	0.00	74,028.00	183.20%	#DIV/0!	
48019	Zhvillim ekonomik	252,915.29	40,000.00	31,159.15	12.32%	77.90%	0.48%
50017	Taksa për verifikim të dokum.të ndryshme	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50019	Taksat tjera administrative	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50206	Licencat për marka tregtare dhe patentim	3,350.00	0.00	2,350.00	70.15%	#DIV/0!	16.47%
50208	Licencat për transport të mallrave	19,985.00	10,000.00	5,396.00	27.00%	53.96%	37.81%
50208-1	Vërtetime të ndryshme dhe leje për itinerar	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50211	Licenca për shërbim të pijeve alkoolike	10,050.00	30,000.00	6,525.00	64.93%	21.75%	45.72%
	Të hyrat vetanake	33,385.00	40,000.00	14,271.00	42.75%	35.68%	45.80%
	Donacionet e jashtme -	219,530.29	0.00	16,888.15	7.69%	#DIV/0!	54.20%
	Eu-Unioni European	219,530.29	0.00	16,888.15	7.69%	#DIV/0!	
650	(I+II) Gjeodezi dhe kadastrë	862,180.64	868,000.00	1,186,028.85	137.56%	136.64%	18.13%
65095	I. Shërbime kadastrale	335,897.00	410,000.00	231,747.00	68.99%	56.52%	19.54%
50011	Taksa për regjistrimin e trashigimisë	132,612.00	145,000.00	97,451.00	73.49%	67.21%	42.05%
50019	Taksa tjera administrative	13,885.00	0.00	7,369.00	53.07%	#DIV/0!	3.18%
50032	Taksa për certifikata të pronësisë dhe kopje plani	102,300.00	140,000.00	66,585.00	65.09%	47.56%	28.73%
50409	Participimet	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50460	Regjistrimi i pengut	19,535.00	15,000.00	7,095.00	36.32%	47.30%	3.06%
50504	Taksa për matjen e tokës në teren	67,565.00	110,000.00	53,247.00	78.81%	48.41%	22.98%
	Të hyrat vetanake	335,897.00	410,000.00	231,747.00	68.99%	56.52%	100.00%
65495	II. Çështjet pronësore - juridike	526,283.64	458,000.00	954,281.85	181.32%	208.36%	80.46%
50008	Taksa për pakim publik, kampim dhe rekreacion	0.00	115,000.00	0.00	#DIV/0!	0.00%	0.00%
50212	Licenca për reklama dhe publikime në prona publike	51,375.25	89,000.00	122,195.00	237.85%	137.30%	12.80%
50405	Shfrytëzimi i pronës publike	5,853.00	154,000.00	167,757.40	2866.18%	108.93%	17.58%
50408	Qiraja nga objektet publike	323,736.39	100,000.00	9,530.95	2.94%	9.53%	1.00%
50413	Të hyrat nga shitja e pasurisë	145,319.00	0.00	654,798.50	450.59%	#DIV/0!	68.62%
	Të hyrat vetanake	526,283.64	458,000.00	954,281.85	181.32%	208.36%	100.00%
66100	Planifikimi urban dhe mjedisi	1,231,217.40	908,931.40	1,754,075.95	142.47%	192.98%	26.81%
50009	Taksa komunale për leje ndërtimi	1,199,880.62	798,931.40	1,702,416.23	141.88%	213.09%	97.05%
50026	Taksa për legalizimin e objekteve	31,336.78	110,000.00	51,659.72	164.85%	46.96%	2.95%
	Të hyrat vetanake	1,231,217.40	908,931.40	1,754,075.95	142.47%	192.98%	100.00%
	Shëndetësia	112,347.50	109,000.00	132,523.00	117.96%	121.58%	2.03%
74100	Kujdesi primar shëndetsor - Participim	112,347.50	109,000.00	132,523.00	117.96%	121.58%	100.00%
	Të hyrat vetanake	112,347.50	109,000.00	132,523.00	117.96%	121.58%	100.00%
85019	Kulturë , rini , sport	1,389.00	500.00	146,017.80	10512.44%	29203.56%	1.89%
50008-1	Taksa për parkim , kampim dhe rekreacion	0.00	500.00	0.00	#DIV/0!	0.00%	0.00%
50408	Qiraja nga objektet publike	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
50409	Participim - Biblioteka	1,389.00	0.00	1,882.80	135.55%	#DIV/0!	100.00%
	Të hyrat vetanake	1,389.00	500.00	1,882.80	135.55%	376.56%	1.29%
	Donacionet e jashtme-	0.00	0.00	144,135.00	#DIV/0!	#DIV/0!	98.71%
	Qeveria Italiane	0.00		0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
	EU - Unioni european	0.00	0.00	144,135.00	#DIV/0!	#DIV/0!	100.00%

	Arsimi	230,637.33	140,002.00	232,171.09	100.67%	165.83%	3.01%
	Të hyrat vetanake	193,431.20	140,002.00	228,437.00	118.10%	100.00%	98.39%
	Donacionet e jashtme	37,206.13	0.00	3,734.09	10.04%	0.00%	1.61%
92570	Arsimi parashkollor - Çerdhet	144,381.00	90,000.00	174,147.00	120.62%	64.28%	100.00%
50409	Participim	144,381.00	90,000.00	174,147.00	120.62%	193.50%	76.23%
	Donacionet e jashtme	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	0.00%	0.00%
	Grande te jashtme	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!

93540	Arsimi fillor	12,128.13	0.00	3,734.09	30.79%	0.00%	1.61%
	Participim	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00%
	Donacionet e jashtme	12,128.13	0.00	3,734.09	30.79%	#DIV/0!	100.00%
	Grande tjera te jashtme - Save the children	12,128.13	0.00	3,734.09	30.79%	#DIV/0!	100.00%
94740	Arsimi i mesëm	74,128.20	50,002.00	54,290.00	73.24%	108.58%	23.38%
50409	Participim	49,050.20	50,002.00	54,290.00	110.68%	108.58%	100.00%
	Donacionet e jashtme - EU - Unioni europian	25,078.00	0.00	0.00	0.00%	#DIV/0!	0.00%
	I . TË HYRAT VETANAKE	5,197,319.47	5,593,510.00	6,543,189.39	125.90%	116.98%	84.70%
	II . GJOBAT NGA GJYKATAT	76,305.00	0.00	66,305.00	86.89%	#DIV/0!	0.86%
	III . GJOBAT NË TRAFIK	1,044,141.50	0.00	877,020.31	83.99%	#DIV/0!	11.35%
	IV . DONACIONET	1,207,233.73	0.00	238,785.24	19.78%	#DIV/0!	3.09%
	Donacionet e jashtme	1,166,824.92	0.00	164,757.24	14.12%	#DIV/0!	69.00%
	Donacionet e brendshme	40,408.81	0.00	74,028.00	183.20%	#DIV/0!	31.00%
	T O T A L I (I + II + III + IV) :	7,524,999.70	5,593,510.00	7,725,299.94	102.66%	138.11%	100.00%

Komuna e Pejës sipas planit për vitin fiskal 2025 ka planifikuar të hyra vetanake në shumë prej 5,593,510.00 € .

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2025 janë realizuar të hyra vetanake në shumë 6,543,189.39 € respektivisht 25.90 % më shumë se gjatë periudhës janar - dhjetor të vitit 2024 ndërsa plani për vitin 2025 është realizuar 116.98 % .

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar gjoba nga gjykatat në lartësi prej 66,305.00 € të cilat në të hyra të gjithmbarshme marrin pjesë me 0.86 % dhe gjobat në trafik në shumë prej 877,020.31 ose 11.35 % nga shuma e gjithmbarshme e të hyrave .

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar donacionet e jashtme në shumë 164,757.24 €, të cilat në të hyra të gjithmbarshme marrin pjesë me 2.13 % .

Donacionet e realizuara gjatë periudhës raportuese janë në Drejtorat Zvillim ekonomik me shumen 16,888.15 € nga EU-Unioni Europian, në Sherbimet kulturore me 144,135.00 € si dhe në Arsim fillor 3,734.09 € nga Save dhe Children,

Në raport me periudhën krahasuese donacionet e realizuara janë më të ulta për 85.88 % .

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar donacione të brendshme në drejtorat e Bujqësi me shumen prej 74,028.00 €

Të hyrat e gjithmbarshme , në fund të periudhës raportuese , arrijnë shumën 7,725,299.94 € dhe në raport me periudhën krahasuese janë më të larta për 2.66 % .

Dinamika dhe struktura e të hyrave të grumbulluara mund të përcjellët nga pasqyra tabelare por vlen të ceket se të hyrat nga taksa komunale për leje të ndërtimit , në shumë prej 1,702,416.23 € paraqesin 26.03 % të shumës së gjithmbarshme të të hyrave vetanake të grumbulluara gjatë periudhës raportuese .

Sipas lartësisë së pjesëmarrjes pasojnë të hyrat nga tatimi në pronë me 33.68 % , respektivisht 2,202,580.88 € , taksa e regjistrimit të automjeteve me 4.80 % respektivisht 312,475.00 €, të hyrat nga taksa për ndërrim të destinimit të pronës me 7.60 % respektivisht 496,564.39 € , etj.

SHPENZIMET E REALIZUARA BUXHETORE GJATË PERIUDHËS JANAR-DHJETOR TË VITIT 2025

Në pajtim me Ligjin Nr.07 /L- 001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025,buxheti komunal për vitin 2025 duket si vijon :

(në euro)

Fondi burimor	Emërtimi i fondit	Buxheti fillestar I - XII - 2025	Buxheti total I - XII - 2025	Diferenca	%	%
1	2	3	4	5	6	7
10	Granti Qeveritar	34,248,872.00	35,616,124.80	1,367,252.80	85.96%	82.63%
21	Të hyrat vetanake	5,593,510.00	5,593,509.54	(0.46)	14.04%	12.98%
22	Të hyrat e bartura nga viti paraprak	0.00	1,420,327.71	1,420,327.71	0.00%	3.30%
10. Heqja e të drejtës prindërore: Në këtë periudhë kohore nuk kemi asnjë kërkesë nga Gjykata për heqjen e të drejtës prindërore.

11. Heqja e zotësisë së veprimit: 7 Lëndë në procedurë për heqje të zotësisë së veprimit.

14. Konstatim të gjendjes faktike: Gjatë kësaj periudhe kohore, kemi 21 kërkesa për konstatim të gjendjes faktike, të 21 rasteve iu është ofruar shërbimi.

15. Pëlqim për martesë para moshës madhore: Në këtë periudhë kohore kemi pasur 1 kërkesë për dhënie të mendimit për martesë para moshës madhore.

16. Vendosje në strehim familjar tek të afërmit: Në këtë periudhë kohore kemi pasur 2 kërkesa, të 2 kërkesat janë proceduar me vendime dhe kontrata për pagesa mujore.

18. Fëmijët me aftësi të kufizuar: Për këtë kategori në këtë periudhë kohore i kemi të regjistruara 43 kërkesa (aplikacione). Nga këto kërkesa 43 i janë nënshtruar komisionit

mjekësor 37 aprovime, 3 refuzime, 3 plotësime. Lëndë aktive me pagesë në bazë janë gjithsejtë 188.

17. Aktvendime, Njoftime, Kërkesa, Ankesa, Fletë lëshime nga Qendrat Korrektuese:

Në këtë periudhë kohore kemi pranuar gjithsej 25 kërkesa

Aktvendime nga Gjykata: 50

Njoftime nga Gjykata / Prokurori: 50

Kërkesa nga Institucione të ndryshme: 10

Ankesa për shkallë të dytë për A.K: 3

Proces verbal A.K: 3

Fletë Lëshime nga Qendrat Korrektuese: 10

Në data bazën e përgjithshme gjithsejtë janë të bartura 5996 lëndë.

Sherbimi i Ndhimave Sociale

Shërbimi i SNS-së në kohën raportuese Janar- Dhjetor /2025 ka pasur një rënje në kërkesa për ndihmë sociale krahasuar me periudhen e njëjtë të vitit të kaluar.

Në periudhën Janar- Dhjetor 2025 janë regjistruar 886 familje në Skemën e Ndhmës Sociale.

Në këtë periudhë kohore nga Janar - Dhjetor janë gjetur gjithësejtë 47 familje që kanë realizuar NS në mënyrë të jashtëligjshme (krahasim i të dhënave me ATK-në e të cilat familje menjëherë largohen nga ndihma sociale) prej të cilave 10 janë riaktivizuar.

Kërkesat e reja: Prej datës 03/01/2025 deri me datë 19/12/2025 janë parashtruar 169 kërkesa për Ndhmë Sociale prej të cilave për kategorinë e I-rë 103 e për kategorinë e II-të 50 familje.

Riaplikimet:Në periudhën kohore prej datës 03/01/2025 deri me datë 19/12/2025 kanë dalë në riaplikim 849 familje:

Verifikimi dhe Riverifikimi i familjeve:Familjet të cilat realizojnë Ndhmën Sociale si dhe familjet që paraqesin kërkesë për ndihmë sociale verifikohen në afatin kohor prej 45 ditësh.Familjet aktive të kategorisë së I-rë riverifikohen një herë në vit kur e bëjnë riaplikimin,ndërsa familjet e kategorisë së II-të riverifikohen çdo 6 muaj kur e bëjnë riaplikimin.Janë verifikuar për herë të parë 169 familje si dhe janë riverifikuar të gjitha familjet që kanë riaplikuar në periudhen nga Janari/2025 deri Dhjetor/2025.

Aprovimet: Deri me datë 19/12/2025 janë aprovuar 87 familje në Ndhmë Sociale.

Refuzimet:Nga kërkesat e reja për NS janë refuzuar 72 familje.

Rishqyrtim:Në rishqyrtim janë 10 kërkesa të cilat ende nuk ju kanë nënshtruar komisionit mjekësor regional ose nuk kanë dal ende në teren për verifikim.

Ndërprerje e Ndhimave Sociale:Ndihma Sociale ju ka ndërprerë 78 familjeve për këtë periudhë për shkak që nuk i plotësojnë njërin prej kriterëve të Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale ose punësim i ndonjë anëtarit të familjes,përmirësim i gjendjes ekonomike të familjes,shkuarje në botën e jashtme si dhe mbushin moshën 65 vjeqare dhe kalojnë në PB etj.

Komisioni mjekësor:Në këtë periudhë kohore janë mbajtur 12 seanca të komisionit mjekësor në nivelin regional janë shqyrtuar 2084 aplikacione të komisionit mjekësor dhe prej tyre në Rajonin e Pejës janë shqyrtuar 682 Lëndë.

Kërkesa për rishqyrtim:Në këtë periudhë kohore janë paraqitur 23 kërkesa për rishqyrtim e prej tyre 20 kërkesë është aprovuar.

Shkalla e II-të e ankesave DPSF:Në këtë periudhë nuk kemi ankesa prej tyre.

Ankesa për Gjykatën Themelore:Kemi 1 ankesë.

Ndihma e njëhershme (Emergjente):Në këtë periudhë kohore prej 03/01/2025 deri me datë 19/12/2025 nuk kemi pasë kërkesa për ndihmë të njëhershme.

Çertifikata për student: 13

Çertifikata:Nga ky shërbim janë lëshuar 378 çertifikata për shfrytëzuesit e NS si dhe për ata që nuk realizojnë NS, për marrjen e Shtetësisë në Republikën e Kosovës etj.

Bashkëpunime me Donacione

1.Zyrtarët e Shërbimit të Asistencës Sociale gjatë vitit 2025 kanë përpiluar listën për 150 familje për pakë ushqimore për muajin e Ramazanit nga Organizata Charity, ku në këtë rast 10 nga këto familje kanë qenë përfitues për 3 muaj me pakë ushqimore.

2.Zyrtarët e Shërbimit të Asistencës Sociale në muajin Ramazanit kanë përpiluar listat për 70 familje të cilat janë shfrytëzuese të ndihmës sociale nga donatorët individual me pakë ushqimore.

3. Donatori : Humanity First Kosova – 51 familje janë bërë përfitues të pakëve ushqimore.

4. Donatori : Islamic Relief – 163 familje kanë përfituar pakë ushqimore.

5. Donatori : Bashkësia Islame –Pejë – 20 familje kanë përfituar si prind vërtetues.

6. Donatori : Mane Lajqi – 9 familje kanë përfituar shumën 100 euro.

7. Projekti i SAVE DHE CHILDREN dhe Ministrisë së Arsimit – Janë shqyrtuar 245 kërkesa ose raste për fëmijë të familjeve përfitues të SAS-it, nga të cilët 29 fëmijë janë përzgjedhur si përfitues të projektit për vijim në arsimim të hershëm - parashkollorë.
8. Projekti Renovim të shtëpive për familjet e cenueshme “GREEN EFICENCE” Ambasada Holandeze dhe Ministria e Mireqenies Sociale - janë shqyrtuar 16 familje përfituese të SAS-it, ku 14 prej tyre janë përfituese të këtij projekti.
9. Projekti “ Bursa për fëmijë të Komunitetit Rom Ashkali Egjiptian” – SAVE THE CHILDREN, Ministria e Arsimit, OJQ – Syri Vizion- DMS – Janë shqyrtuar 100 fëmijë të familjeve të këtij komuniteti, përfitues të SAS-it.

SAS-PILOT PROJEKTI - Shërbimi i asistencës sociale është i kyqur edhe në punën e SAS- Pilot Projektit program nga niveli qendror dhe bazuar në aplikimet online nëpërmes platformës E-kosova, janë vizituar për herë të parë 422 raste ku është bërë vlerësimi i kushteve ekonomiko-sociale. Shërbimi i Asistencës vazhdon të ofrojë shërbim për këto familje lidhur me kërkesat e tyre, si ndërprerje, vërtetime, aktivizime e kështu me radhë.

E-KOSOVA - Shërbimi i asistencës sociale ka ofruar këshillime dhe asistencë në projektet qeveritare për qytetarët, nëpërmjet platformës E-Kosova, si : Aplikimi të lehonave, shtesave për fëmijë, librave për fëmijë, aplikimet për subvencionim të rrymës.

Albulena Mujaj-Bajraktaraj
Drejtorja për Mirëqenie Sociale



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

**RAPORTI VJETOR I DREJTORISË PËR PUNË INSPEKTUESE PËR
VITIN 2025**

2025

Raporti i hartuar është bazuar dhe mbështetur në kompetencat ligjore dhe përshkrimin e punës si dhe në zbatimin e Planit të Veprimit për Vitin 2025.

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE (DPI)

Objektivat

- **Angazhimi maksimal për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të cilat i kemi si Drejtori brenda kuadrit të kompetencave ligjore .**
- **Kryerja e punëve inspektuese konform ligjeve në fuqi.**
- **Bashkëpunimi me organet e rendit dhe sigurisë në rastet kur duhet të intervenojmë dhe paraqitet rrezikshmëria.**
- **Rritja e transparencës.**

DPI është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve komunale në lëmin e:

- a) Inspektoratit Komunal të Tregut dhe Komunikacionit; b) Inspektoriatit Komunal; c) Inspektoratit Komunal të Ndërtimit; dhe d) Inspektoratit Komunal të Mbrojtjes së Mjedisit.

ORGANIZIMI I DREJTORISË PËR PUNË INSPEKTUESE

1. Sektori i Tregut dhe Komunikacionit në kuadër të së cilit veprojnë Inspektorët Komunal të Tregut dhe Komunikacionit.
2. Sektori Komunal në kuadër të së cilit veprojnë Inspektorët Komunal.
3. Sektori i Ndërtimit në kuadër të së cilit ka vepruar Inspektori Komunal i Ndërtimit.
4. Sektori i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Mjedisit në kuadër të së cilit veprojnë Inspektorët Komunal të Mbrojtjes së Mjedisit.

Planet e Veprimit planifikohen në fillim të vitit kalendarik për secilin Sektor përkatës dhe organizohen aktivitete (plane operative) në bazë të periudhave sezonale, ankesave dhe kërkesave të qytetarëve gjithmonë me të vetmin qëllim që të zgjedhim problemet e qytetarëve, të jemi pranë tyre dhe të evitojmë pengesat ligjore duke ndërmarrur masat e nevojshme në kuadër të kompetencave Ligjore.

1. Sektori i Tregut dhe Komunikacionit

Udhëheqës i Sektorit të Tregut dhe Komunikacionit:

Haxhi Gashi

Inspektorët Komunal të Tregut: Agim Nikqi, Berat Smajli, Duresa Bytyqi, Dorentina Berisha, Elinda Pilingjurka, Xhevahire Kelmendi, Sali Kelmendi.

Gjatë periudhës një vjeçare Inspektorët e Tregut kanë realizuar disa nga objektivat nga Plani i Veprimit për vitin 2025 bazuar në kompetencat të cilat ju takojnë në kuadër të ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative, si dhe punë të tjera të cilat janë caktuar nga shefi i Sektorit dhe Drejtoresha e Drejtorisë për Punë Inspektuese.

Bazuar në përshkrim të detyave të punës dhe kompetencave që u ngarkohen këto janë ligjet dhe aktet nënligjore me të cilat operojnë Inspektorët Komunal të Tregut të cilat janë të kufizuara në disa raste të caktuara.

1. Ligji mbi Mbrojtjen e Konsumatorit me Nr/ 06L-034
2. Ligji për Tregtinë e Brendshme Nr/ 2004/18 Ndryshim plotësimi Nr/ 04L-0053
3. Ligji për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut 03L-181 Ndryshim plotësimi 04L-186
4. Ligji për Turizmin Nr. 08L-074, sa i përketë këtij ligji kemi dal për kategorizimin e Hoteleve dhe Moteleve në bazë të urdhëresave nga MINT- (Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë).
5. Ligji për punimet nga metalet e çmuara Nr/ 04L-154 në këtë ligj kemi marur pjesë si ekip plotësuese (asistim) me Inspektorët e Tregut të nivelit qendror.
6. Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr/ 03/2022 për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës dhe karburantve të ripërtëritshme dhe masat e tjera mbrojtëse.
7. Ligji Nr.08/L-172 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
8. Ligji Nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësim të Konformitetit, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
9. Ligji Nr.2004/44 për Zejtari.
10. Ligji Nr.08/L-205 për Të drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
11. Ligji Nr.08/L-075 për Markat Tregtare, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
12. Ligji Nr.05/L-075 për Shërbime, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
13. Ligji Nr.04/041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit, si dhe aktet nën ligjore nga ky ligj.
14. Ligji Nr.04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, si dhe aktet nënligjore nga ky ligj.
15. Udhëzim Administrativ (QRK) NR. 07/2023 Për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit.
16. Ligji Nr. 05/L-087 Për Kundërvajtje.

Në nivel lokal (Komuna e Pejës) operojmë me Rregulloret Komunale si vijon:

- Rregullore për Plotësimin e Kushteve Minimale Teknike me Nr. 03/2023
- Rregullore për taksa Komunale Nr.02/2023
- Rregullore për Licensimin e Bizneseve për Shërbimet Alkoholike Nr. 06/2019
- Rregullore mbi Orarin e Punës për Lokalet Afariste Nr. 2000/45

Në raste të ndryshme, Inspektoriati Komunal i Tregut i përgjigjet çdoherë (MINT) sipas Ligjeve të aplikueshme duke ndërmarrur aksione të ndryshme inspektimi në kontrollet e operatorëve ekonomik në Regjionin e Pejës, gjithashtu shqyrton të gjitha kërkesat dhe ankesat që vijnë nga MINT.

AKTIVITETE INSPEKTUESE	ZBATIMI
VLERËSIME SIPAS RREGULLORES KOMUNALE (QRK) Nr.03/2023 PËR PLOTËSIMIN E KUSHTEVE MINIMALO-TEKNIKE NË LOKALET AFARISTE TË KOMUNËS SË PEJËS	Janë pranuar zyrtarisht 120 (njëqind e njëzet) kërkesa të palëve për tu pajisur me Pëlqime për Kushtet Minimalo- Teknike. Nga 120 kërkesa, të gjitha janë shqyrtuar dhe Komisionet vlerësuese pas vlerësimit në terren kanë konstatuar se këto subjekte afariste me veprimtari të ndryshme i plotësojnë kushtet e kërkuara sipas dispozitave ligjore të Rregullores. Të hyrat nga kërkesat e subjekteve afariste për Pëlqime të KMT arrijnë afro <u>12.250 Euro</u>. Tarifat përcaktohen me nenin 19.7. të RREGULLORE Nr. 01/2023 PËR TAKSAT KOMUNALE/
Kontrolla të përgjithshme në subjekte afariste të veprimtari të ndryshme si: (gastronomi, markete, barnatore, sallone të ondulimit, butiqe dhe agjencione të udhëtimit si dhe tregti të tjera). Kontrollat e përgjithshme përfshijnë inspektimet si: prezantimi i dokumentacionit, licenca të alkoolit, çmimet, çmimore, orari, emri tregtar, deklaracionet, etj;	196- Subjekte afariste janë inspektuar me procesverbale për kontrolla të përgjithshme. 75– Subjekte afariste janë pajisur me Aktvendim për Licencë të pijeve alkoolike për vitin 2025 nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

KONTROLLA TË NDRYSHME NË BAZË TË ANKESAVE TË KONSUMATORIT (të cilat janë shqyrtuar në bazë të LIGJIT Nr. 06/L-034 PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT)	Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore janë pranuar 11 (njëmbëdhjetë) ankesa të ndryshme të konsumatorëve nga subjekte të ndryshme afariste dhe 8 (tetë) prej tyre janë shqyrtuar duke ndërmarrur masa ndëshkimore sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-034 PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT). Ndërsa 3 (tre) ankesa janë ende në proces të shqyrtimit.
PROCESVERBAL PËR MBYLLJE/RI-HAPJE TË SUBJEKTIT AFARIST (AKSIONE TË PËRBASHKËTA ME POLICINË)	Është bërë mbyllja e 5 (pesë) subjekteve afariste (gjatë aksioneve të përbashkët me Policinë) tre prej tyre për ushtrim të veprimtarive të paligjshme dhe dy prej tyre për mungesë të dokumentacioneve për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Pasiqë, dy nga subjektet ka bërë evitimin e parregullësive të evidentuara për ushtrimin e veprimtarive të pa dokumentacion nga ana e Inspektoriatit Komunal të Tregut me kërkesa zyrtare është bërë ri-hapja e saj.
GJOBA TË SHQIPTUARA	6 (Gjashtë) subjekte afariste janë ndëshkuar varësisht nga shkeljet e evidentuara dhe ndërmarrja e këtyre masave ndëshkimore është bazuar konform dispozitave ligjore të ligjeve dhe akteve nënligjore.
ASGJËSIM	Janë realizuar 3 (tre) asgjësime të mallit në bazë të kërkesës së dy subjekteve afariste.

SEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Inspektorët e Komunikacionit:

Pajazit Shala.

Kompetencat e Inspektorëve të Komunikacionit

Mbikëqyrja dhe zbatimi i dispozitave ligjore nga lëmi i komunikacionit rrugor siç janë;

- Ligji Nr. 04/L-179 Mbi Transportin Rrugor;
- Ligji Nr.2003/11- Ligji për Rrugët;
- Ligji Nr.05//L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor;
- Ligji Nr.02/L-70 Siguria në Komunikacionin Rrugor;
- Rregullorja Komunale Nr.02/2019 për Transportin Rrugor
- Rregullorja Komunale Nr.03/2019 për Transportin Rrugor.

Ndër të tjera kompetenca që ushtrohen janë inspektimi i qarkullimit publik rrugor, inspektimi dhe kontrollimi i automjeteve që ushtrojnë veprimtari shërbyese (taksi), stacionin e autobusëve, lejet e punës, kontratat, dokumentet e transportit dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me punën dhe veprimtarinë e ndërmarrjeve; Kujdeset për organizimin dhe mbarëvajtjen e rregullt të transportit rrugor brenda territorit të komunës si dhe punë të tjera.

GJOBA MANDATORE	11
KONTROLLA TË RREGULLTA	65
Kontrollat e rregullta përfshijnë inspektime të transportit publik për auto-taxi dhe transportit publik me autobus)	
PROCESVERBALE	37

2. Sektori i Inspeksionit Komunal

Udhëheqës i Sektorit të Inspeksionit Komunal:

Vëllaznim Përgjegjaj

Inspektorët Komunal: Ali Kurtaj, Arbenitë Zeneli, Blerta Kasapolli –Lajqi, Gentiana Zallqi, Miranda Luta, Veton Dervishaj.

Sipas përshkrimit të vendit të punës kompetencat e Inspeksionit Komunal janë:

- Parandalimi i rrehimjës së sipërfaqes publike pa leje nga organi kompetentë.
- Parandalimi i derdhjes së ujit pa arsye nëpër rrugë dhe trotuare.
- Parandalimi i vendosjes së reklamave pa leje nga organi kompetentë.
- Parandalimi i vendosjes së tavolinave para kafiterive pa leje nga organet kompetente.
- Largimi i shitësve ambulant nga sipërfaqja publike.
- Parandalimi i vendosjes së materialit ndërtimor në sipërfaqe publike.
- Mbikëqyrja e pastërtisë para hapësirave afariste.

Nr.	Prosesverbalet e lëshuara për:	Janë lëshuar/ Procesverbale	Gjoha mandatore
1	Reklama në sipërfaqe publike	353	8
2	Tavolina në sipërfaqe publike	40	1
3	Pengesa në sipërfaqe publike-larguar / +parking	11	1
4	Rrëmihje në sipërfaqe publike	1	1
5	Gjenerator në sipërfaqe publike	2	
6	Aparate - Frigorifer, tezga , Box etj.	/	/
7	Mall në sipërfaqe publike- ose (pemë perime)	5	4
8	Kërkesa/ankesa të palëve	20	/
TOTAL		432	15

3. Sektori i Inspeksionit për Mbrojtjen e Mjedisit

Udhëheqës i Sektorit të Inspeksionit për Mbrojtjen e Mjedisit: **Galdim Krasniqi**

Inspektorët e Sektorit Komunal për Mbrojtjen e Mjedisit: Besfort Mema, Miftar Shala dhe Xhevat Nikqi.

Gjatë kësaj periudhe është punuar sipas Planit të Veprimit që është paraparë sipas detyrave dhe përgjegjësi mbështetur në Ligjet dhe Rregulloret për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe në bashkëpunim me Drejtoreshën e Inspeksionit. Inspeksioni Komunal i Mjedisit në bazë të organogramit (përshkrimi të detyrave të punës) merret me: Mbrojtja e mjedisit nga huthja e mbeturinave në sipërfaqe publike dhe private, mbrojtja e mjedisit nga degradimet dhe nga ndotja e ajrit, mbrojtja e mjedisit nga shfrytëzimi i resurseve natyrore (rërës dhe zhavorrit) në menyrë ilegale, mbrojtja e mjedisit nga shkarkimi i ujrave të zeza në ambiente të hapura, Mbrojtja e mjedisit nga ndotja akustike (zhurma).

Inspeksioni Komunal i Mbrojtjes së Mjedisit bazohet dhe vepron sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve që janë në fuqi.

Ligjet të cilat implementohen nga Inspektorët Komunal për Mbrojtjen e Mjedisit janë:

- LIGJI Nr.04/L-060 PËR MBETURINA
- LIGJI Nr.08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJI Nr.04/L-060 PËR MBETURINA
- LIGJI Nr. 03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT.
- LIGJI Nr. 08/L-025 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA.
- LIGJI Nr. 02/L-102 PËR MBROJTJEN NGA ZHURMA
- RREGULLORE KOMUNALE Nr. 11/2015 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT.
- RREGULLORE KOMUNELE Nr. 01/2023 PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE.
- RREGULLORE KOMUNALE Nr. 02/2023 (KPE) PËR TAKSAT KOMUNALE.

KONTROLLA TË RREGULLTA	101
KONTROLLA ME PROCESVERBAL	68
KËRKESA TË PALËVE	31
KËRKESA TË PËRFUNDUARA	28
KËRKESA NË PROCEDURË	03
GJYKATA KOMERCIALE	00
NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	14
NUMRI I GJOBAVE TË PAGUARA	08
NUMRI I GJOBAVE TË PAPAGUARA	06

MENAXHIMI I MBETURINAVE		
KËRKESA TË PALËVE 16	KONTROLLA ME PROCEVERBAL 41	GJOBA 10

MENAXHIMI I MJEDISIT (MBROTJA E RESURSEVE NATYRORE)		
KËRKESA TË PALËVE 1	KONTROLLA ME PROCESVERBAL 7	GJOBA 03

NDOTJE AKUSTIKE, FEKALE, NDOTJE E AMBIENTIT(DJEGIE)		
KËRKESA TË PALËVE 14	KONTROLLA ME PROCESVERBAL 20	GJOBA 01

4. Sektori i Ndërtimit

Gjatë kësaj periudhe ka qenë i angazhuar në punët e Sektorit të Ndërtimit Inspektori i Ndërtimit **Burim Kelmendi** i cili ka vepruar në kuadër të kompetencave ligjore sipas detyrave dhe përgjegjësi për mbikëqyrjen inspektuese në fushën e ndërtimeve, ndalimin e punimeve ilegale dhe rrënimin e tyre, si dhe punë të tjera të përcaktuara me ligje dhe akte tjera nënligjore në fuqi.

Inspeksioni i Ndërtimeve në kufijtë e mundësive dhe autorizimeve të veta dhe duke u bazuar në ligjin e ndërtimit Nr.04/L-110 Ligjin e Inspektoratit Nr.04/L-175 si dhe në bazë Udhëzimeve Administrative pandërprerë ndërmerrë masa për evitimin e ndërtimeve pa leje të ndërtimit .

Për objekte që posedojnë lejen e ndërtimit është bërë inspektim i vazhdueshëm gjatë ndërtimit se nëse bëhet ndërtimi në pajtim me kushtet urbanistike dhe dokumentacionin teknik në bazë të cilit është dhënë leja e ndërtimit .

Për objektet ilegale është bërë përgaditja dhe shpërndarja e aktvendimeve me të cilët urdhërohen palët për ndërprerjen e punëve dhe njëkohesisht njoftohen për procedurën e rregullt lidhur me parashtrimin e kërkeses si dhe për marrjen e lejes së ndërtimit nga organi kompetent.

Për ata pronar të objekteve, që nuk i kanë respektuar vendimet për ndërprerjen e punëve, Inspeksioni i Ndërtimit në bashkëpunim me asistimin e organeve Policore ka bërë ndërprerjen e punëve pa leje dhe mbylljen e punishteve të ndërtimit (objekteve), është bërë kërkesë për hapjen e procedurës për kundërvajtje si dhe ka bërë kallëzime penale.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar kërkesa e ankesa të natyrave të ndryshme , ku të gjitha janë shqyrtuar dhe janë ndërhkuar sipas ligjeve të ndërtimit në fuqi.

Inspektori i Ndërtimit ka bërë inspektimin e të gjitha bashkësive territoriale duke u angazhuar në inspektimin edhe gjatë ditëve të vikendit për evitimin e ndërtimeve pa leje ndërtimore.

OBJEKTE TË INSPEKTUARA	TOTAL 224 OBJEKTE
Objekte të inspektuara të kategorisë së I-rë (Objekte individuale)	180 Objekte
Objekte të inspektuara të kategorisë II-të (Objekte kolektive)	22 Objekte
Inspektim final Kategoria e II-të	7 Objekte
Në 10 objekte ka qenë e nevojshme intervenimi dhe marrja e masave	15 Objekte
– Kërkesa për inspektim të fazave	Te gjitha objektet kolektive
- Ankesa të ndryshme të qytetarëve	Ankesa- dhe të gjitha janë të shqyrtuara.

Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike	 KOMUNA E PEJËS OPŠTINA PEÇ MUNICIPALITY OF PEJA	
Agron Nikçi		Janar-Dhjetor 2025
Agron.nikci@rks-gov.net 044-774-111		DATA: 19.12.2025

Nr.	Projektet kapitale të realizuara dhe në realizim gjatë vitit 2025
1	Mirëmbajtja e rrugëve në qytet dhe fshatra
2	Mirëmbajtja dhe shenjëzimi i komunikacionit në rrugët lokale
3	Mirëmbajtja e ndriçimit publik
4	Ndërtimi i urës së automjeteve KAPESHNICË – QENDËR
5	Ndërtimi i urës së automjeteve Kombinati Lëkurë – Këpucë – Zona Industriale
6	Ndërtimi i sheshit Hotel Korzë – Ura e Zallit
7	Rindërtimi i murit të lumit dhe veshja e tij me gurë
8	Asfaltimi i rrugës Sejnove – Gjore
9	Ndërtimi i kanalit në lagjen Asllan Çeshme
10	Ndërtimi i rrethojave të varrezave në fshatrat: Broliq, Lutogllavë, Dardani 3, Zillopek, Maja e Zezë, Jabllanicë e Madhe, Çallapek
11	Ndërtimi i kanalizimit Raushiq – Loxhë – Impiant
12	Ndërtimi i rrugëve në: Novosell, Jabllanicë e Madhe, Jabllanicë e Vogël, Dubovë dhe Radac
13	Ndërtimi i rrugëve në: Kosuriq, Rashiq, Baran, Baran i Epërm, Kotradiq, Turjak, Llugagji dhe Glllogjan
14	Ndërtimi i rrugëve në: Nabërgjan, Terstenik, Ruhot, Zahaq, Llabjan, Katund i Ri dhe Qyshk
15	Ndërtimi i rrugëve në: Raushiq, Loxhë, Graboc dhe Llozhan
16	Ndërtimi i rrugëve në fshatrat: Kamenicë, Çallapek, Zllapek, Kryshec dhe Turjakë

17	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Varri i Sykut – Bellopaq"	
18	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shtypeq i Madh: "Qafa e Broqit", "Panorama"	
19	. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Rekë e Allagës – Pecaj	
20	Ndërtimi i rrugës Peklenë – Shtupeq i Vogël – Varri i Sykut (Faza 2)	
21	Ndërtimi i rrugës Drelaj – Leqinat	
22	Rekonstruktimi i rrjetit në fshatrat e Rugovës	
23	Ndërtimi i ujësjellësit në Lugun e Baranit (ritender)	
24	Ndërtimi i ambulancës veterinarë për trajtimin e qenve endacak (ritender)	.
24	Ndërtimi i shtëpisë së fshatit në Kosuriq	
25	Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në fshatin Raushiq	
26	Vazhdimi i ndërtimit të trotuarit dhe ndriçimit në fshatrat Ruhot – Trestenik dhe ndriçimi në fshatin Llabjan (Rr. Sterio Spase)	
27	Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në rrugën Isa Haxhijaj në fshatin Dubovë	
28	Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në fshatin Baran deri në hyrje të fshatit Vranoc dhe Kotradiq	.
29	Ndërtimi i ndriçimit publik Shkrel – Bogë	
30	Ndërtimi i ndriçimit publik nga rrethi i Vitomiricës deri te shkolla (Rr. Hasan Muratagiq) dhe në fshatrat Kotradiq, Kristal (Lagja e Bujupt), Radac (Rr. Shaqir Demaj)	
31	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike tek "Uji i Zi", ndërtimi i murit dhe ndriçimit në Zikliq	
32	Ndërtimi i hapësirës përreth stadiumit në fshatin Brestovik	

33	Vazhdimi i ndërtimit të trotuarit dhe ndriçimit nga fshati Vitomiricë deri në fshatin Novosell (Rr. R106)	
34	Ndërtimi i trotuarit pranë stacionit të autobusëve	
35	Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në lagjen Asllan Qeshme, rregullimi i hapësirës publike në Qendrën Zejtare dhe te Ura e Gurit	
36	Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në fshatin Loxhë (Rr. Deme Isufi) dhe rrugën Hida Halimi në lagjen Dardania	
37	Kubëzimi i hapësirave publike në lagjen Fidanishte	
38	Ndërtimi i tualeteve publike në fshatin Radac, rregullimi i hapësirave publike tek Hasan Beqti në Qyshk, renovimi i shtëpisë në fshatin Kliçinë dhe rregullimi i hapësirave në lagjen Karagaq (Rr. Sali Bajraktari)	
39	Turizmi kulturor – Diversifikimi i ofertës turistike përmes trashëgimisë kulturore dhe promovimi i traditave	
40	Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në fshatin Llozhan deri te Shkolla	
41	Ndërtimi i hapësirës publike në fshatin Koshutan – Rugovë	
42	Ndriçimi i hapësirave publike në lagjen Fidanishte	
43	Ndërtimi i shtëpisë së fshatit për nevoja të banorëve në fshatin Ozdrim	
44	Ndërtimi dhe rregullimi i shtigjeve në parkun Karagaq	
45	Ndërtimi i ambulancës në fshatin Trestenik	
46	Ndërtimi i trotuareve dhe rregullimi i hapësirave publike në fshatrat: Leshanë, Kliçinë, Gllaviçicë dhe Jabllanicë	.
47	Ndërtimi dhe rregullimi i trotuarit në të dy anët nga Qendra deri te Gjykata	
48	Rindërtimi dhe sanimi i rrugës në fshatin Bogë dhe Shtypeq i Madh	
49	Rekonstruktimi dhe ndërtimi i rrugëve të qytetit 5500m’	
50	Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Kryshec	
51	Ndërtimi i ndriçimit publik në fshatin Nakell dhe Gorazhdec	
52	Asfaltimi i rrugëve në Treboviq, Nakull dhe Bllagaj	
53	Asfaltimi i rrugës tek Qerdhja e Qytetit “Pëllumbat e Pages”	

54	Ndërtimi i trotuarit dhe murit pranë Lumbardhit, nga ura e gjelbertë deri te ura e re në zonën industriale.	
55	Ndërtimi i rrugës që lidh lagjen Dardania (rruga 'Hysni Rama') me magjistralen Pejë–Prishtinë (rruga 'Zahir Pajaziti')	
56	Asfaltimi i rrugës KFOR – AKI – Zahaq, Pejë	
57	Rehabilitimi i rrugës Tranzit – Qyshk – Pavlan	
58	Rregullimi i infrastrukturës publike përreth bizneseve	
59	Asfaltimi i rrugës në Qendrën Industriale Zahaq	
60	Mbulimi me dhe i deponisë sanitare në fshatin Sferkë	
61	Punimi i linjës TM 10(20) kV Vitomericë – Pejë	
62	Ndërtimi i trafave në fshatin Vitomericë, në Karagaq, dhe punë ndërtimore në Pejë	

Komente shtesë:

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike është angazhuar edhe në shumë aktivitete të tjera, përfshirë:

- Pranimin dhe trajtimin e kërkesave të qytetarëve në terren;
- Planifikimin dhe monitorimin e punëve të mirëmbajtjes së hapësirave publike si: rrugë, trotuare, sheshe, hapësira të gjelbra dhe kanale të hapura.

Sfida dhe probleme të hasura

Një ndër sfidat kryesore gjatë këtij viti ka qenë **mungesa e mjeteve financiare**, e shkaktuar nga **marrja e fondeve për kontestet gjyqësore dhe përmbarimet**, të cilat rezultuan si pasojë e **moszbatimit të kontratës kolektive** për punëtorët e arsimit nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Agron Nikçi

Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Drejtoria e Shëndetësisë - Pejë

Referencë:	
Për/Za/To:	Ing.Gazmend Muhaxheri-Kryetar I Komunes
Data/Datum/Date:	12.12.2025
Nga/Od/From:	Dr.Petrit Loci- Drejtor i Shëndetësisë
Tema/Subjekat/Subject	Raport vjetor janar - dhjetor 2025

Raporti i punes per vitin 2025 ka të beje me punën e Drejtorise se Shëndetesisë dhe nënprogramit të saj QKMF-së




Roport pune

Drejtoria e Shëndetësisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe mbështetur në udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës, në kuadër të fushë veprimtarisë së saj ushtron dhe është përgjegjëse për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve specifike për të arritur objektivat e si Drejtori i QKMF-së

Drejtori ka udhëhequr proceset menaxheriale dhe ka mbikëqyrur funksionimin e përgjithshëm të institucionit. Gjatë njembdhjetemujorit, ka zhvilluar takime të rregullta me njësitë përkatëse, ka ndjekur zbatimin e planeve të punës, si dhe ka përfaqësuar institucionin në takime me autoritete komunale dhe partnerë të tjerë të fushës së shëndetësisë.

RRJETI I KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR

Funksionon përmes 1 Qendre Kryesore të Mjekësisë Familjare, Poliklinikës së stomatologjisë dhe 10 Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe 10 Am bulanteve Shëndetësore



5. OBJEKTIVAT TË KPSH

Bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe misionin që ka QKMF si objektivin startegjik për vitin 2025 e ka përkufizuar si:

Sigurimi i shërbimeve shëndetësore themelore dhe cilësore të ofrohen në kuadër të KPSH dhe duke u bazuar në konceptin e Mjekësisë Familjare.

Objektivat specifike:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore
- Forcimi i kapaciteteve profesionale, të menaxhimit dhe llogaridhënjës
- Zhvillimi i resurseve humane
- Promovimi shëndetësore dhe pjesëmarrja e komunitetit në shërbimet e ofruara
- Përmirësimi i komunikimit ndërsektorial dhe ndërinstitutional
- Fuqizimi i punës ekipore
- Evalumimi dhe monitorimi

Objektivat janë zbatuar duke u udhëhequr nga parimet :

- Barazia
- Cilësia
- Ndershmëria dhe përgjegjësia
- Gjithëpërfshirja dhe jo diskriminimi
- Financimi i qëndrueshëm
- Financimi kosto-efektiv
- Bashkëfinancimi



International Network of
Health Promoting Hospitals
& Health Services

HPH Membership Certificate 2025 to 2028

Main Family Medicine Center
Peja
Kosovo

Member no. 383-004

Date: 19.06.2025

Prof. Dr. Oliver Groene

CEO of International HPH Secretariat

QKMF -së Pejë i'u bë dhënia e certifikatës së anëtarësimit në Rrjetin Internacional te Spitaleve Promovuese të Shëndetit (HPH) .

Knaqësi që së bashku me QKMF Lipjan dhe QKMF Gjakovë të jemi pjesë përbërëse e këtij rrjeti Internacional.

Raporti mbi vizitat sipas departamenteve-sherbimeve				JANAR-DHJETO 2022								Institucioni Shendetesor:				QKMF					
Nr. Rendor	Departamenti (SHERBIMI)	Vizitat																Vendi:			
		Ne ordinancë																Vizita Shërpiake			
		Mjeku														Sherbimet tjera shendetesore (infermieri),		Mjeku		Punëtor et tjere shendet	
		Gjithsej	Vizitat e para sipas moshës														Panjohur				
			Gjithsej	< 1 vjet	1 - 5	6 - 9	10 - 14	15 - 19	20 - 24	25 - 34	35 - 44	45 - 54	55 - 64	65+ vjet							
1	Mjekësia Familjare	0	148397	316	2380	3161	5690	9589	11557	16522	18099	21717	24217	35149	0		114757	0	3356		
2	Pediatria	0	15644	3614	5420	3242	2856	237	68	49	48	29	37	44	0		0	0	0		
3	Gjinekologji	0	822	0	1	3	2	16	42	111	156	290	109	92	0		0	0	0		
4	Vaksinimi + Covid 19	0	12128	3079	1458	1378	1179	1302	147	224	235	311	745	2070	0		0	0	0		
5	Laboratori (DSM+ Rt Pcr)	0	15195	121	911	685	796	816	733	1290	1462	2244	2550	3587	0		0	0	0		
6	Radiologji - Rtg	0	1204	0	4	25	41	121	267	225	246	159	77	39	0		0	0	0		
7	Emergjenca	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	5785	0		
8	Fiziatr-Vizitat	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
9	Fiziatr-Terapia	0	1557	0	0	23	5	20	44	52	68	296	368	681	0		0	0	0		
10	Internisti	0	1301	0	0	0	3	40	42	37	122	178	317	562	0		0	0	0		
11	EKG	0	720	0	0	0	1	13	19	26	57	105	160	339	0		0	0	0		
12	Echo Kabineti (Mamografia)	0	877	0	0	0	12	43	73	153	240	210	111	35	0		0	0	0		
13	Sherbimi Paliativ	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
14	Pulmologu	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
15	Oftalmologu	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
16	Dermatologu	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
17	Epidemiologjia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
18	Sherbimi Specialistik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
19	Mjekësia e Punës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
20		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
21		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
22		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
23		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
24		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
25		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0	0		
Totali:		0	197845	7130	10174	8517	10585	12197	12992	18689	20733	25539	28691	42598	0		114757	5785	3356		

Raporti mbi vizitat te stomatologu					JANAR - DHJETOR 2021				Institucioni Shendetesor:				QKMF				
									Vendi:								
Nr. Rendor	Komuna	VIZITAT			Punët e kryera				PUNËT E KRYERA								
		Gjithsej	Prej tyre te para	Vizita serike					Punët protetike				Ortodoncia				Mjekimi I indeve te buta te zgavrës se gojës
					Dhembe te bllobtuar		Intervenime		Proteza lëvizëse		Proteza fikse		Vizita e para	Intervenimet terapeutike-ortodontike	Aparatet lëvizëse	Aparatet fikse	
					Pa mjekim	Me mjekim	Dhëmbë të nxjerrë	Intervenime tjera	Totale	Parciale	Kurora	Proteza fikse-seanca					
1	QKMF-Stomatologji	18484	11310	4101	2703	2431	2761	6243	251	43	72	0	583	884	156	0	0
2		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	
13																	
14																	
15																	
16																	
17																	
Totali:		18484	11310	4101	2703	2431	2761	6243	251	43	72	0	583	884	156	0	

QKMF-Pejë jan-nentor 2025 Vizitat mjeksore dhe shërbimet													
	Vizita e parë	Vizita e dytë	gjitheja : vizitat	referime	vizita në shtëpi	shërbime stomatologjike	infuzione	injeksione	inhalim	Ekz	imazheri	laborator	plagë, pastrim dhe qepje
	A	B	A+B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L
1 QKMF	92364	2027	94391	4551	8548	5901	12602	43760	1709	552	2080	182582	27545
2 Poliklinika e Stomatologjisë	7192	2587	9779			22618		1472			884		
3 Qmf V	14051	2306	16357	5188		2762	4832	12146	598			15794	1810
4 Qmf IV	14461	1227	15788	2665		472	3415	7258	338	43	71	1742	2410
5 Qmf III	8444	2175	10619	1682		1994	1813	5475	298		1058	6730	753
6 Qmf II	7355	522	7877	1478		454	1201	3960	321	29			139
7 Qmf Baranë	2671	191	2862	191		0	545	4048	69				556
8 Qmf Vitomerice	16947	2994	19941	3048		2671	4987	11251	388			3415	1494
9 Qmf Kadaveç	872	75	947	106			113	465	18				10
10 Qmf Zahaç	3359	126	3485	900			432	1490	40				408
11 Qmf Tërstenik													
12 Amf Gillogjan													
13 Amf Lushan	1900	15	1915	430			608	755	4				133
14 Amf Dobërdol	35	15	50	24									
15 Amf Rautshiq	9738	636	10374	1508		1431	1156	3400	249			1749	413
16 Amf Krysheç	1146	130	1276	481			369	985	16				150
17 Amf Novosellë	2422	168	2790	593			154	788	26				15
18 Amf Kristal	3551	422	3973	909			349	1518	47				284
19 Amf Poqest	714	46	760				39	260	11				39
20 Amf Qadrim													
21 Amf Logje	1506	296	1802	812			113	774	31				
22 Amf Trebovçiq/Nabërgjan	1120	105	1225	523			81	263	11				224
23 Amf Drelaj													
24 Amf Haxhaj													
25 Amf Gorazhdëvç													
gjithejt:	190048	16163	206211	25080		38523	32614	100072	4174		4093	212012	36478

Pejë me, 09.12.2025

Burimi i të dhënave: Raporti i punës për muajin nëntor, 2025

RAPORT PËRMBLEDHËS I PROJEKTIT

"Shëndeti dhe Mirëqenia e Nxënësve të Komunës së Pejës"

Periudha raportuese: Shkurt – Nentor 2025

Projekti "Shëndeti dhe Mirëqenia e Nxënësve të Komunës së Pejës", qëllim kryesor ka identifikimin e hershëm dhe trajtimin profesional dhe në kohë të problemeve shëndetësore të nxënësve të shkollave fillore të komunës së Pejës. Gjatë periudhës kohore shkurt-nentor 2025, ky aktivitet përfshiu ekzaminime sistematike shëndetësore, vlerësim funksional, trajtime fizioterapeutike, monitorim të gjendjes shëndetësore orale dhe vizuale, shërbime stomatologjike si dhe analiza laboratorike për nxënësit me nevoja specifike.

Rëndësia e këtij projekti qëndron në parandalimin e përkeqësimit të çrregullimeve shëndetësore që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve, duke siguruar ndërhyrje të hershme dhe trajtime adekuate.

Objektivat e projektit

- Realizimi i ekzaminimeve fizike dhe funksionale për identifikimin e çrregullimeve ortopedike, posturale dhe neurologjike muskuloskeletore.
- Trajtimi i nxënësve me nevoja fizioterapeutike përmes planprogrameve të përshtatura.
- Monitorimi i shëndetit oral dhe ofrimi i shërbimeve stomatologjike.
- Vlerësimi i shikimit dhe ndihma për nxënësit me probleme okulare, përfshirë edhe ndihmën me subvencione për syze për familjet në nevojë.
- Realizimi i analizave laboratorike për nxënës me indikacione të caktuara.
- Vlerësimi i përgjithshëm shëndetësor i nxënësve (përfshirë dhe matjen e indeksit trupor) dhe referimi tek specialistët adekuat për ekzaminime specialiste
- Përfshirja e nxënësve nga komunitete etnike dhe sociale në nevojë për trajtime dhe mbështetje.

Metodologjia

Në kuadër të projektit janë realizuar ekzaminimet për nxënësit e 16 shkollave fillore të komunës, me një total prej 1933 nxënësve nga data 01.03.2025 (dhe 60 të tjerë janë riekzaminuar gjatë muajit shkurt 2025 nga faza e parë e pilotprojektit të vitit 2024). Ekzaminimet janë realizuar në QKMF sipas planprogramit të caktuar, duke filluar nga ora 8:00. Deri në qendrën ekzaminuese nxënësit janë sjellë me transportin e organizuar, si dhe pas përfundimit të ekzaminimeve janë kthyer prap me transportin e organizuar deri në shkollën përkatëse.

Ekzaminimet kanë përfshirë:

- Ekzaminimin fizikal: Vlerësimin e gjendjes së përgjithshme fizike dhe posturale, si dhe diagnostikimin e çrregullimeve ortopedike dhe muskulore.
- Ekzaminimin oral: Vlerësimin e shëndetit oral dhe referimin për trajtime stomatologjike.
- Ekzaminimin e syve: Kontrollin e shikimit dhe identifikimin e nevojës për syze.
- Ekzaminimet mjekësore/pediatrike si dhe kryerjen e analizave laboratorike bazë (pasqyrë e gjakut, glikemia) për rastet me indikacione.
- Informimin dhe koordinimin me prindërit dhe institucionet shëndetësore lokale për trajtime të mëtejshme. (Pas përfundimit të ekzaminimeve, secili prind është kontaktuar dhe i janë dhënë rezultatet e ekzaminimeve, si dhe për rastet specifike janë udhëzuar tek specialistët përkatës për ekzaminime të specializuara).

Rezultatet e përgjithshme

Gjatë periudhës mars – nentor 2025 janë ekzaminuar 1933 nxënës të 16 shkollave në komunën e Pejës. Numri i nxënësve sipas shkollave ishte si vijon:

Shkolla Nxënës të ekzaminuar

Vaso Pashë Shkodrani 100

Hil Mosi 54

Rilindja 78

Smajl Hajdaraj 74

7 Shtatori 137

Skënderbeu 67

Ramiz Sadiku 170

28 Nëntori 71

Lidhja e Pejës 97

Zef Serembe 23

Asdreni 241

Lidhja e Prizrenit 233

Xhemajl Kada 241

Skënder Çeku 49

Dardania 235

Pjetër Budi 63

Nga totali i nxënësve: 625 nxënës (32.3%) u gjetën pa veçori patologjike dhe konsiderohen me gjendje të mirë shëndetësore në aspektin fizikal.

- 168 nxënës u identifikuan me nevojë për trajtim fizioterapeutik sa më të shpejtë (rasteve tjera u janë dhënë informacionet dhe këshillat e nevojshme për monitorimin dhe kontrollat e vazhdueshme, si dhe planprogramet e personalizuara për ushtrime në shtëpi dhe aktivitete fizike).

- 63 nxënës filluan trajtimin fizioterapeutik gjatë periudhës së raportimit (prej tyre 20 nxënës vazhduan trajtimin nga projekti pilot i vitit 2024)

- Janë referuar për konsulta të specializuara 34 raste ortopedike dhe 7 raste neurologjike.
- Janë realizuar 146 analiza laboratorike për pasqyrën e gjakut dhe glikeminë.
- Për shëndetin oral janë dhënë 359 shërbime stomatologjike në QKMF për nxënësit (statistikat e tjera janë në përpunim që përfshijnë edhe institucionet tjera të shëndetit primar që kanë ofruar shërbime për trajtimin e këtyre nxënësve).
- Disa raste me probleme vizuale dhe kushte socio-ekonomike të vështira janë ndihmuar për të marrë subvencione për syze (deri me tani janë parashtruar 12 kërkesa për subvencionim në Komunë, si dhe janë paraqitur edhe raste të tjera që jemi në pritje të sjelljes së dokumentacionit për parashtrimin e kërkesës).

Problematikat më të shpeshta të identifikuara

Çrregullimet ortopedike dhe posturale:

- Kifoza torakale
- Skolioza posturale dhe idiopatike
- Kifoskolioza
- Aplanim i lordozës lumbale
- Hiperlordozë cervikale
- Deformitete të shputave dhe gjunjëve
- Rrafshim i harqeve plantare
- Dobësi muskulare
- Çrregullime neurologjike të patrajuara dhe referim për konsultë specialistike.

Shëndeti oral:

- Prania e sëmundjeve/defekteve të indeve të forta/dhëmbëve
- Prania e sëmundjeve/defekteve të indeve të buta të gojës
- Prania e anomalive të nofuallave ose dhëmbëve

Probleme vizuale: Identifikimi i nxënësve me probleme shikimi dhe mbështetja për blerjen e syzeve.

Probleme të tjera shëndetësore:

- Sëmundje që lidhen me higjienën personale (*Pediculus capitis*)
- Sëmundje të lëkurës (u janë dhënë udhëzimet për konsulta me dermatologun)

Përfshirja e komuniteteve në nevojë sociale dhe etnike

Projekti përfshiu nxënës nga komunitete të ndryshme etnike dhe sociale për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore:

- Komuniteti RAE: 69 nxënës
- Komuniteti boshnjak: 62 nxënës
- Komuniteti goran: 3 nxënës

Kjo përfshirje garanton që edhe grupet më të marginalizuara të marrin shërbimet e nevojshme.

Rekomandimet

Bazuar në rezultatet dhe përvojën e fituar gjatë implementimit të projektit brenda kësaj periudhe kohore, rekomandohet:

- Vazhdueshmëria e projektit me mbulueshmëri më të gjerë
- Krijimi i një baze të dhënash digjitale për monitorimin dhe ndjekjen sistematike të rasteve shëndetësore.
- Rritja e kapaciteteve për trajtime fizioterapeutike
- Përmirësimi i bashkëpunimit me prindërit dhe institucionet lokale për edukim dhe ndërgjegjësim mbi shëndetin e fëmijëve (me theks të veçantë për shëndetin postural, shëndetin oral, si dhe mirëmbajtjen e higjienës personale)
- Fokusi i veçantë në komunitetet etnike dhe sociale për të siguruar përfshirje dhe barazi në shërbime.

Përfundime

Projekti “Shëndeti dhe Mirëqenia e Nxënësve të Komunës së Pejës” është një hap tejte i rëndësishëm në përmirësimin e shëndetit të fëmijëve. Identifikimi i hershëm i problemeve shëndetësore dhe ndërhyrja e shpejtë kanë ndihmuar në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të nxënësve dhe kanë krijuar bazën për një mirëqenie më të madhe në komunitet.

Përmbushja e objektivave të projektit tregon nevojën dhe rëndësinë e vazhdimin të këtij programi me mbështetje të përhershme nga institucionet komunale dhe ato shëndetësore.

3355 vizita Jane kryer gjate periudhes Janar-Nentor 2025 nga ekipa mobile

Kryesishte ajane afruar sherbime te semureve nestadin terminal te semureve me kancer dhe te semureve me moshe te shtyer ,shtatezanave dhe atyre qe l eshte pamundesuar qasja ne sherbime shendetesore.

Barnatorja Qendrore

Barnatorja Qendore Gjatë periudhes Janar-Nentor 2025 ka qenë një nga sektorët

kyq në trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të cilët kanë kërkuar shërbime. Furnizimi kontinuel

me medikamente dhe material shpenzues, distribuimi dhe disperzimi i tyre në rrjetin

Institucioneve të QKMF kanë qenë disa nga prioritetet në këtë digaster. Planifikimi i furnizimit

dhe realizimi i kërkesave Gjatë periudhes Janar-Nentor 2025 ka shkuar përmes Sistemit të Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF), ku për çdo artikull është futur në këtë sistem gjë që ka mundësuar qasjen

dhe kontrollin më të mirë të stokut dhe distribuimit të medikamenteve. Prioritet në furnizim ka

pas Sektori i Urgjencës ku asnjëherë nuk kanë munguar medikamentet ampulare për

trajtimin e rasteve me prioritet. Furnizimi nga Divizioni Farmaceutik ka qenë më i mirë si në

aspektin kualitativ por edhe kuantitativ dhe kërkesat janë realizuar rreth 50%.

Furnizimi me Insulina ka qenë në nivel, nuk ka pasë vështërsi të theksuara ne furnizim përveç

vonesave ne realizimin e kërkesave. Përveç furnizimt nga MSh përmes operatorit "Madekos" jemi furnizuar me medikamenteve të cilat nuk janë ofruar nga DF/Msh.

RAPORTI VJETOR I BARNAVE NGA LISTA ESENCIALE

Ky raport paraqet furnizimin e barnatores me barna nga lista esenciale , blerje vetanake si dhe shperndarja e tyre .

JANAR-DHJETOR
2025

Tabelari me poshtë tregon në detaje furnizimin dhe shpenzimin e tyre:

NR.	ARTIKULLI		MBETJ A VITI KALUA R	S. HYRJE	S.DALJ E	MBETJ E	ÇMIMI	TOTALI
1	TRAMADOL	sir	240	600	840	0	0.108	90.72
2	TRAMADOL	sir	0	600	600	0	0.18	108.00
3	PARACETAMOL	sir	0	180	180	0	0.61	109.80
4	PARACETAMOL	sir	0	380	380	0	0.54	205.20
5	SHIRINGA 10 G	cop	1300	69600	70800	100	0.029	2053.20
6	SHIRINGA 5 G	cop	2500	122400	121300	3600	0.018	2183.40
7	SHIRINGA 2 G	cop	4200	24000	25600	2600	0.016	409.60
8	BABY-SISTEME 21 G	cop	270		270	0	0.034	9.18
9	BABY-SISTEME 21 G	cop	0	4100	3750	350	0.035	131.25
10	SHPATULLA TE DRURIT	cop	59400		59250	150	0.006	355.50
11	ERITHROMICIN	sir	0	240	240	0	2.17	520.80
12	AQUA DESTILATA	amp	850	300	1150	0	0.15	172.50
13	LORATIDINE	sir	20		20	0	1.17	23.40
14	LORATIDINE	sir	0	360	360	0	0.95	342.00
15	CARBAMAZEPINE	tab	0	12000	12000	0	0.124	1488.00
16	CARBAMAZEPINE	tab	0	36000	9780	26220	0.123	1202.94
17	DIKLOFEN	amp	0	5000	2500	2500	0.079	197.50
18	AMPICILIN	flacon	50		50	0	1	50.00
19	GLYKOZA 5%	infuzion	0	1000	1000	0	0.41	410.00
20	ADRENALIN	amp	250		250	0	0.16	40.00
21	ADRENALIN	amp	0	1100	940	160	0.157	147.58
22	METOCLOPRAMID	amp	1940	5500	5770	1670	0.07	403.90
23	NIFUROXAZIDE	sir	0	70	70	0	1.04	72.80
24	NIFUROXAZIDE	sir	80	60	140	0	1.12	156.80
25	DEXAMETHASONE	amp	0	15000	6760	8240	0.065	439.40
26	GENTAMICIN 80mg	amp	2280	39000	30880	10400	0.108	3335.04
27	NYSTATIN	pika	0	270	248	22	0.95	235.60

28	DIAZEPAM	amp	1520	36000	23610	13910	0.09	2124.90
29	CHLOROPYRAMINE	amp	250	2900	3150	0	2.16	6804.00
30	METOCLOPRAMID	tab	0	4200	4200	0	0.04	168.00
31	RINGER	infuzion	1420	8200	8700	920	0.7	6090.00
32	SALBUTAMOL	punp	0	1200	1200	0	1.21	1452.00
GJITHSEJË								31533.01

NR.	ARTIKULLI		MBETJA A VITI KALUAR	S. HYRJE	S.DALJE	MBETJE	ÇMIMI	TOTALI
33	CO-TRIMOXAZOLE	sir	0	360	350	10	0.69	241.50
34	ASPIRIN	tab	0	90000	90000	0	0.013	1170.00
35	PARACETAMOL	tab	0	120000	110050	9950	0.007	770.35
36	LEVODOPA-CARBIDOPA	tab	0	1800	1800	0	0.08	144.00
37	TERMOMETER	cop	0	20	20	0	4.99	99.80
38	CAZBAMAZEPINE	tab	0	24000	24000	0	0.027	648.00
39	LORATIDINE	tab	0	3000	3000	0	0.06	180.00
40	OMEPRAZOL	caps	0	30000	30000	0	0.027	810.00
41	OMEPRAZOL	caps	0	60000	60000	0	0.026	1560.00
42	METFORMIN 850mg	tab	0	100000	100000	0	0.016	1600.00
43	METFORMIN 1000mg	tab	0	35000	35000	0	0.031	1085.00
44	METFORMIN 500mg	tab	0	30000	30000	0	0.022	660.00
45	DIAZEPAM	tab	0	18000	18000	0	0.02	360.00
46	OMEPRAZOL	amp	0	10500	10500	0	0.29	3045.00
47	POVIDON JOD	sol	0	170	166	4	2.7	448.20
48	BISOPROLOL	tab	0	13500	13500	0	0.026	351.00
49	PARACETAMOL 150mg	supp	0	500	500	0	0.17	85.00
50	FLLASTERA 5X5	cop	68	3730	3788	10	0.2	757.60
51	DORZA JOSTERILE	cop	0	36000	33700	2300	0.02	674.00
52	DORZA JOSTERILE	cop	0	92000	92000	0	0.059	5428.00
53	SILVER SULFADIAZIN	ung	0	360	360	0	0.63	226.80
54	VATE 500gr	cop	61	180	241	0	1.47	354.27
55	VATE 500gr	cop	0	400	307	93	2.4	736.80
56	NACL 0.9%	cop	240		240	0	0.36	86.40
57	NACL 0.9%	cop	0	10104	9128	976	0.45	4107.60
58	SKALPERA KIRURGJIK	cop	45	2400	2445	0	0.04	97.80

59	SISTEME PER INFUZION	cop	3300	30200	33500	0	0.095	3182.50
60	FASHA 10X4	cop	0	3000	3000	0	0.29	870.00
61	FASHA 10X4	cop	0	3000	3000	0	0.155	465.00
62	GAUSE STERILE 90X100	cop	49	150	199	0	7.98	1588.02
63	GAUSE STERILE 90X100	cop	0	300	168	132	17.5	2940.00
64	KANILLA 20 G	cop	80		80	0	0.08	6.40
65	KANILLA 22 G	cop	2040	12000	10840	3200	0.08	867.20
66	KANILLA 24 G	cop	1000	18000	19000	0	0.08	1520.00
67	DORZA STERILE	cop	0	10400	10100	300	0.198	1999.80
GJITHSEJË								39166.04

NR.	ARTIKULLI		MBETJ A VITI KALUA R	S. HYRJE	S.DALJ E	MBETJ E	ÇMIMI	TOTALI
68	DORZA STERILE	cop	100	4800	4900	0	0.14	686.00
69	DORZA STERILE	cop	0			0	0.15	0.00
70	GJILPERA 19 G	cop	200	66000	66200	0	0.009	595.80
71	GJILPERA 21 G	cop	26700	105000	131500	200	0.009	1183.50
72	GJILPERA 23 G	cop	19300	12000	30000	1300	0.009	270.00
73	DIAZEPAM	klizm a	0	600	600	0	1.8	1080.00
74	DIAZEPAM	klizm a	0	1800	1400	400	1.6	2240.00
75	CLOPIDOGREL	tab	0	12000	12000	0	0.086	1032.00
76	GAUSE 10X10	cop	0	2700	2700	0	0.626	1690.20
77	AMLODIPINE	tab	0	24000	24000	0	0.018	432.00
78	LOSARTAN	tab	0	48000	48000	0	0.028	1344.00
79	ATORVASTATIN	tab	0	98000	98000	0	0.022	2156.00
80	ATORVASTATIN 10mg	tab	0	23000	23000	0	0.018	414.00
81	BRUFEN 400mg	tab	0	96000	96000	0	0.02	1920.00
82	AMOXICILIN	sir	50	1200	1010	240	1.07	1080.70
83	VITAMIN C	amp	0	5200	5200	0	0.11	572.00
84	CIPROFLOXACINE	tab	0	9000	9000	0	0.078	702.00
85	RABIES HUMAN	seru m	0	1	1	0	20	20.00
86	LIDHESE TOURNIQUET	cop	23	240	263	0	0.68	178.84
87	USHQIM ENTERAL	sol	648	4780	5428	0	2.09	11344.52
88	CEFUROXIME	amp	330		330	0	0.85	280.50

89	FUROSEMIDE	amp	950	12000	10500	2450	0.07	735.00
Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes	0	1	2	0	5	12	14	47	36	40	45		202
Numri i shtatzënave që janë vizituar për herë të parë	0	2	0	0	0	6	0	4	4	2	5		23
Numri i shtatzënave që kanë pranuar vizitën e dytë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0
Numri i fëmijëve 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0		2
Numri i grave shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0
Numri i fëmijëve të referuar tek specialistët mjekësor nga ekipi i mjekësisë familjare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0
Numri i vizitave shpesh për fëmijë dhe shtatzëna (jashtë standardit të programit të vizitave në shtëpi)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0
Numri i baballarëve të përfshirë gjatë vizitave në shtëpi	0	0	0	0	0	5	3	5	7	10	15		45
Numri i rasteve sociale të identifikuar dhe të referuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0
Numri i rasteve të dhunës të identifikuar (nga observimi gjatë vizitës në shtëpi)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0
Numri i fëmijëve të identifikuar me ngecje në zhvillim dhe të referuar (nga observimi gjatë vizitës në shtëpi)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0
Numri i infermierëve që janë angazhuar në zbatimin e vizitave në shtëpi	14	14	14	14	14	22	22	22	22	22	33		213

Të dhënat që duhet të mblidhen: Numri i vizitave në Këshillimore														QKMF Peje
Periodha e raportit Janar- Dhjetor 2025														
Nr. i vizitave në Këshillimore														
Grupmosha	Gjinia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej Janar-Dhjetor
0-4	Meshkuj													0
	Femra													0
5-9	Meshkuj						1							1
	Femra													0
10-14	Meshkuj										1			1
	Femra			1										1
15-19	Meshkuj										1			1
	Femra		1								1			2
20-24	Meshkuj			1						1				2
	Femra			1				2		1				4
25-29	Meshkuj	1			1									2
	Femra		1											1
30-34	Meshkuj	2	1	2	3	1	1	2			2			14
	Femra				1									1
35-39	Meshkuj	1	1	2	1			1	1					7
	Femra						2		1	2				5
40-44	Meshkuj	2	4	2	3			2		1		1		15
	Femra			1		1		1						3
45-49	Meshkuj	5	3		3	3	1	2		1	1	3		22
	Femra			2	4	3	2	1	2	2	4	3		23
50-54	Meshkuj	3	1	4	2	2	2	6	2	1	3	1		27
	Femra	3	3	2	2	1	1	4	1		2	7		26
55-59	Meshkuj	20	13	17	10	5	7	9	5	10	12	2		110
	Femra	17	11	10	17	6	8	13	10	14	17	12		135
60-64	Meshkuj	9	6	13	6	4	7	9	9	5	8	3		79
	Femra	11	20	10	16	9	9	6	9	14	9	9		122
65-69	Meshkuj	11	9	9	11	8	6	10	9	11	8	10		102
	Femra	9	4	3	12	5	8	15	8	13	10	8		95
70-74	Meshkuj	13	7	7	8	6	3	12	10	5	17	14		102
	Femra	3	8	8	6	9	3	14	6	11	13	6		87
75-79	Meshkuj	3	4	8	6	5	4	3	3	6	5	1		48
	Femra	2	1	2	4	1	2	9	2	4	6	5		38
80+	Meshkuj	6	10	6	5	3	2	8	3	6	4	3		56
	Femra		1	3	2	2	1	2	1	2	1			15
Gjithsej		121	109	114	123	74	70	131	82	110	125	88	0	1147

Periodha e raportimit: Janar - Dhejtor 2025

Nr. i Librezave të lëshuara për Astma

Grupmoshë	Gjinia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej Janar-Dhjetor
0-4	Meshkuj													0
	Femra													0
5-9	Meshkuj													0
	Femra													0
10-14	Meshkuj													0
	Femra													0
15-19	Meshkuj													0
	Femra													0
20-24	Meshkuj													0
	Femra													0
25-29	Meshkuj													0
	Femra													0
30-34	Meshkuj													0
	Femra													0
35-39	Meshkuj													0
	Femra									1				1
40-44	Meshkuj			1										1
	Femra													0
45-49	Meshkuj													0
	Femra													0
50-54	Meshkuj													0
	Femra						1							1
55-59	Meshkuj													0
	Femra						1			1				2
60-64	Meshkuj						2							2
	Femra			1		1	1							3
65-69	Meshkuj													0
	Femra									1				1
70-74	Meshkuj													0
	Femra						1	1						2
75-79	Meshkuj								1					1
	Femra										1			1
80+	Meshkuj		1	1										2
	Femra					1								1
Gjithsej		0	1	3	0	2	6	1	1	3	1	0	0	18

Periudha e raportimit: Janar - Dhjetor 2025

Nr. i Librezave të lëshuara për Diabet

Grupmoshë	Gjinia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej Janar-Dhjetor
0-4	Meshkuj													0
	Femra													0
5-9	Meshkuj						1							1
	Femra													0
10-14	Meshkuj										1			1
	Femra													0
15-19	Meshkuj										1			1
	Femra		1								1			2
20-24	Meshkuj			1						1				2
	Femra							1						1
25-29	Meshkuj	1												1
	Femra													0
30-34	Meshkuj		1		1		1							3
	Femra				1									1
35-39	Meshkuj									1				1
	Femra						2							2
40-44	Meshkuj				1							1		2
	Femra													0
45-49	Meshkuj	3			1	1					1			6
	Femra		1		2	1	1			1	1			7
50-54	Meshkuj	1			1	2	1		1	1	1			8
	Femra	1		2		2	2					2		9
55-59	Meshkuj	1	2	3	1		2	3			1	1		14
	Femra	3	1	1	2		2	1		2	2	2		16
60-64	Meshkuj		2	3			4	2	2	1	2			16
	Femra		5	2	4	3	3	1	1	2	1	1		23
65-69	Meshkuj		2	2	1		1	1	1	2	1			11
	Femra	2			4	1	1	2	3	3	1	2		19
70-74	Meshkuj	1	3		2	1	2	1	3	1	1	1		16
	Femra			1	1	1	2	1	2	2	1	1		12
75-79	Meshkuj						1	1		1	2			5
	Femra			1				1		1	2			5
80+	Meshkuj	2		1				1		1				5
	Femra		1			1								2
Gjithsej		15	19	17	22	13	26	16	13	20	20	11	0	161

Periodha e raportimit: Janar - Dhjetor 2025

Nr. i Librezave të lëshuara për Hipertension														
Grupmoshë	Gjinia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej Janar-Dhjetor
0-4	Meshkuj													0
	Femra													0
5-9	Meshkuj													0
	Femra													0
10-14	Meshkuj													0
	Femra													0
15-19	Meshkuj													0
	Femra										1			1
20-24	Meshkuj													0
	Femra													0
25-29	Meshkuj													0
	Femra		1											1
30-34	Meshkuj													0
	Femra													0
35-39	Meshkuj													0
	Femra													0
40-44	Meshkuj			1	1							1		3
	Femra					1								1
45-49	Meshkuj		1			1					1			3
	Femra					1				1				2
50-54	Meshkuj	1			1	2				1				5
	Femra	1		1		1	1					2		6
55-59	Meshkuj	2	2	4	1		2	2			1	1		15
	Femra	3	1	1	1		2	2		1	1	2		14
60-64	Meshkuj		3	2			3	2	2	1	1			14
	Femra	1	5	2	4	3	4	2	1	1	1	1		25
65-69	Meshkuj		3	2			1	1	1	1		1		10
	Femra	2	1		5	1	1	3	3	4		2		22
70-74	Meshkuj	1	3		1	1	4	1	2		1	1		15
	Femra		1	1	1	1	1	2	1	4	1	1		14
75-79	Meshkuj					1	1		1		1			4
	Femra			1				1		1				4
80+	Meshkuj	2	1	1	1			1						6
	Femra		1			1								2
Gjithsej		13	23	16	16	14	20	17	11	15	10	12	0	167

QKMF- PEJË, SEKTORI I SHENDETIT PUBLIK
QENDRA E VAKSINIMIT- PEJË

Përqindja – 11 Mujor - 2025

	Mosha	Nr.vj.i fëmijëve të planifikuar	Nr. I fëmijëve të vaksinuar	Përqindja e Fëmijëve të vaksionuar
BCG	0-11muj	935	828	88.55 %
HBV 1- ne lindje	0-11muaj	935	828	88.55 %
HBV 2	0-11 muaj	935	834	89.19 %
HBV 3	0-11 muaj	935	790	84.49 %
Dtap-Ipv- Hib 1	0-11 muaj	935	843	90.16 %
Dtap-Ipv-Hib 2	0-11 muaj	935	835	89.30 %
Dtap-Ipv-Hib 3	0-11 muaj	935	785	83.35 %
Rota 1	0-11 muaj	935	805	86.09 %
Rota 2	0-11 muaj	935	786	84.06 %
Pcv 1	0-11 muaj	935	843	90.16 %
Pcv 2	0-11 muaj	935	835	89.30 %
MMR 1	12-23 muaj	935	691	73.90 %
Pcv 3	12-23 muaj	935	693	74.12 %
Dtap-Ipv-Hib 12-18	12-23 muaj	935	631	67.49 %
Bopv R2	6vjeç	1072	1068	99.63 %
DT R2	6vjeç	1072	1068	99.63 %
MMR R2	6 vjeç	1072	1068	99.63 %
Bopv R3	12 vjeç	1192	1116	93.62 %
Td R 3	12 vjeç	1192	1116	93.62 %
HPV R3	12 vjeç	1192	1050	88.09 %
Td R4	17 vjeç	1196	1122	93.81 %

**Formulari për Raportimin e Përfshirjes me Vaksinim Qendra Kryesore e Mjeksis
Pejë Periudha –11 mujore- 2025**

Grup-mosha		Fëmijet e planifikuar përvit	Fëmijet e planifikuar përmuaj
0-11 muaj (BCG, HepB, DTaP, IPV, Hib, PCV, Rota)		935	78
12- 23 muaj (MMR, PCV, DTaP, IPV, Hib)		935	78
24-59 muaj (Fëmijët e mbeturë)	IPV/bOPV, DTP, Hib, HepB	201	
	IPV/bOPV, DPT, PCV	201	
	MMR	201	
Fëmijët e klasës së I-rë (DT, bOPV, MMR)		1072	90
Te mbetur nga kl I-rë (DT, bOPV, MMR)		140	
Fëmijët e klasës së VI-të (dT, bOPV, HPV) /		M 600 F 592	100
Te mbetur nga kl VI-të (dT, bOPV, HPV)		154	
Fëmijët e shkollës mesme (dT)		1196	100

Vaksinat	0-11 muaj (2024-2025)	12-23 muaj (2023-2024)	24-59 muaj	Kl.I-rë	Të mbetur	Kl VI-të	Të mbetur	Kl XII-të	Mbi 59 muaj	TOTALI
BCG në lindje	Pej 828 Kt 629									1457
Hep.B 1 në lindje	Pej 828 K.t 629								18	1475
HepB 2	834	15	17						13	879
HepB 3	790	39	16						5	850
DTaP-IPV-Hib 1	843	23	13						3	882
DTaP-IPV-Hib 2	835	25	13						4	877
DTaP-IPV-Hib 3	785		21						1	807
Rota 1	805									805
Rota 2	786									786
PCV 1	843	163	76						9	1091
PVC 2	835	67	34						3	939
MMR 1		691	178						5	874

Raporti i aktiviteteve të Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional për Mjeke dhe infermieri Janar –Dhjetor 2025

- Vazhdimi i aktiviteteve në QTMF në ESP nga MF, ku tranjerët e QTMF kanë plotësuar angazhimet në kuadër të ESP në MF si dhe objektivat e zhvillimit të konceptit të MF.
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore si dhe matja e performancës së Institucioneve shëndetësore është realizuar përmes Komunitetit për Ngritje të Cilësisë së Shërbimeve
- Aktivitetet në Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional i kuadrove ekzistuese, mjek dhe infermier, i cili realizohet në bazë të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, dhe Odave të profesionistëve shëndetësor të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, mbështetur në arritjet bashkëkohore të Mjekësisë Familjare. Ky segment është ndikuar shumë Gjatë periudhes Janar-Qershor 2025 është realizuar rreth 50% prej planit si për mjek poashtu edhe për infermier.
- Vazhdimi i aktiviteteve në QTMF në SHSP nga MF, ku tranjerët e QTMF kanë plotësuar angazhimet në kuadër të SHSP në MF si dhe objektivat e zhvillimit të konceptit të MF.
- Aktivitetet në promovimin shëndetësorë dhe pjesëmarrje në komunitet përmes edukimit dhe shënimit të ditëve të shënuara si ditës së zemrës, tymosjes së duhanit AIDS, Kancerit të gjirit, përmes aktiviteteve në komunitet si dhe ngritjes së vëtedijes për parandalimin kundër këtyre patologjive.
- Realizimi i “Programt të Vizitave për Nëna dhe Fëmijë” në kuadër të programit
- Vazhdimi i projektit për skreningun e Qafës së Mitrës, projekt i cili realizohet në partneritet me AMC, dhe Spitalin Regjional.
- Gjatë periudhes Janar- Qershor 2025 janë realizuar vizita në teren kryesisht për rastet me sëmundje kronike, pacientët e palëvizshëm dhe ata me sëmundje terminale, si dhe rasteve të hendikepuara dhe me nevoja të veçanta.

Raport përfundimtar i aktiviteteve të ZHVP-së për periudhën janar-dhjetor 2025, në QTMF -Pejë

Ligjeratat e akredituara nga Oda e Mjekëve me numër reference 1625/2024 janë mbajtur në QTMF-Pejë sipas planit të zhvilluar më datën 04.11.2024

1. Pamjaftushmëritë e zemrës-rishtë

Ligjerues dr.Elfezin Muhaxheri, Internistë-Kardiolog prezantoi me datën 21.02.2025 në QTMF-Pejë.Morën pjesë 29 pjesëmarës, mjekë të Mjekësisë Primare, ku u vlersua me 2 pikë akredituese.

2. Markeret diagnostik dhe prediktiv të Kanceri i mushkërive,

Ligjerues prof.dr.Rina Imani -Patologe në Institutin e Patologjisë prezantoi me datën 17.03.2025 në QTMF-Pejë.Morën pjesë 27 pjesëmarës,mjekë të mjekësisë primare, ku ligjerata është vlersu me 3 pikë akredituese.

3. Kokëdhimbjet primare në raport me moshën dhe gjininë.

Ligjeruesë: dr.Shemsije Dukaj – pediatër në QKMF- Pejë, prezantoi me datën 11.04.2025 në QTMF -Pejë.Morën pjesë 30 pjesëmarës, mjekë të mjekësisë primare ku ligjerata është akreditu me 2 pikë.

4. Trajtimi bashkëkohor i Diabetit me GLP1 dhe DPP4 antagonistë.

Ligjerues dr.Agim Koci- Internist-Endokrinolog në Spitalin Regjional Pejë, prezantoi me datën 16.05.2025 në QTMF_Pejë. Morën pjesë 22 pjesëmarës, mjekë të mjekësisë primare, ligjerata është akreditu me 2 pike.

5. Përdorimi i antibiotikëve të ITU sipas udhërrëfyesit në KPSH.

Ligjerues dr.Arijeta Musliqi, specialist e Mjekësisë Familjare në QKMF-Pejë,prezantoi me datën 25.09.2025 në QTMF- Pejë.Morën pjesë 23 pjesëmarës,mjekë të mjekësisë primare,ligjerata është akreditu me 2 pikë.

6. Egzaminimi periodik i shëndetit për pacientet asimptomatik

Ligjeruesë dr.Bujar Gashi, specialist i Mjekësisë Familjare në QMF-Vitomeriçë,prezantoi me datën 07.10.2025 në QTMF-Pejë.Morën pjesë 17 pjesëmarës,mjekë të mjekësisë primare,ligjerata është akreditu me 2 pikë.

7. Stigma/HIV

Ligjerues dr.Islam Husaj, specialist i Mjekësisë Familjare, prezantoi me datën 01.12.2025 në QTMF-Pejë.Morën pjesë 24 pjesëmarës, mjekë të mjekësisë primare,ligjerata është akreditu me 2 pikë.

8. Auditi- Trajnimi i ITU me antibiotikë sipas udhëyesit per perdorimin e antibiotikëve në QMF 3, për periudhën 03.01.2025 deri 30.06.2025

Ligjeratën e mbajti dr.Besarta Krasniqi speciaizante e mjekësisë primare, prezantoi me datën 01.12.2025 morën pjesë 21 pjesëmarës, mjekë të mjekësisë primare.Kjo ishte ligjrate shitesë, nuk ishte akredituar me pikë.

9.HIV/AIDS -statistikat për Kosovë

Ligjeraten e mbajti dr.Lendita Krasniqi, specialiste e mjekësisë sociale në IKSH Pejë, prezantoi me datën 01.12.2025 ku moren pjesë 21 pjesëmarës. Kjo ligjeratë ishte shitesë dhe nuk ishte e akredituar me pikë.

10. Sesionet informuese për planprogramin e vaksinimit 2026. Ndryshimet që do të pëson kalendari i vaksinimit.

Ligjearten e mbajti dr.Shqipe Krasniqi-Kola epidemiologe ne ISHP -Pejë dhe Dukagjin Sahatqiu, specialistë i Mjekësisë Familjare. Morën pjesë 25 pjesëmarës mjekë dhe infermier që punoin ne mjekësin primare dhe janë pjesë të ekipeve të vaksinimit.Kjo ligjeratë ishte shitesë dhe nuk ishte e akredituar me pikë.

11. Antibiotikët makrolid

Ligjerues dr.Myrvete Shala,specialist mjeke familjare në QKMF. Prezantoi me datën 12.12.2025 ku morën pjesë 25 mjekë të mjekësisë primare.Ligjerata është e akredituar me 2 pikë.

12. Punëtorja një ditore mbi shëndetin mendor -nga Qendra për Informim dhe Përmirësim Social. Prezantoi Qëndresa Hyseni, sociologe. Morën pjesë pjesëmarës nga stafi i mjekësisë primare(mjekë,infermier,administrator).Kjo punëtori u mbajtë me 27.10.2025 në Sallën e QTMF-Pejë. Kjo punëtori ishte shitesë dhe nuk është me pikë akredituese.

Trajnime te organizuara nga Ministria e Shëndetësisë ishinë me pjesëmarës nga regjioni dhe u mbajten në sallën e QTMF-Pejë.

- **GMCD** - Përdorimi i Instrumentit për Monitorimin dhe Mbështetjen e Zhvillimit të Fëmijëve, trajnim tre ditorë, me 2 grupe të ndara, një në muajin shtator dhe tjetri grup në muajin tetor. (mjekë dhe Infermier) nga Regjioni i Pejës-Decan,Klinë,Istog.

- Kujdesi prindëror, me 2 ditë trajnim

- Programi i trajnimit për vizitat në shtëpi për fëmijë, me 2 ditë trajnim

- Marja e PAP- testet vazhdon të realizohet në QKMF, QMF 3 dhe në muajin dhjetor filloi në QMF 4. Gjatë këtijë viti janë trajnuar mjekët e mjekësisë familjare për marjen e PAP testeve nga dr.Servete Buqani,Gjinekologe në QMF 3.Prej mjekëve të trajnuar gjatë vitit 2025 janë:

Dr.Vlora Pavataj, specialiste e mjekësisë familjare

Dr.Myrvete Salihu, specialiste e mjekësisë familjare

Dr.Besarta Krasniqi, specializante e mjekësisë familjare.

Në dhjetor të 2025 fillon trajnimin dr. Florentina Lluka,specialist e mjekësisë familjare, me mentor dr.Servete Buqani gjinekologe në QMF3, ku planifikohet që pas përfundimit të trajnimit, në prill të 2026, të filloi marjen e PAP testeve në QMF-Vitomericë.Per arsy objektive dhe subjektive mjekja ne fjale nuk vazhdon trajnimin, gjate kesaj periudhe do te planifikoim qe te shkon nje mjeke tjeter. Raportin e numrit të marjes së PAP test, do ta punon infermiera Violeta Gorani- kordinatore për Programin e PAP testeve.

- **Gjatë muajit tetor**, në muajin e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, mjekët Dr.Arijeta Musliqi dhe Dr. Tringë Prenkaj morën pjesë në aktivitetet e planifikuara nga Zhvp me ligjerata në komunitet, në shkollë, në polici në bashkpunim me ISHP Pejë, Spitalin Regjional- Pejë dhe Komunën e Pejës.

- **Trajnimi i THTP** për pjesëmarrësit e QKMF-Pejë për grupin e formuar në vitin 2024 me dy modulet; II - Dhuna në baza gjinore dhe dhuna seksuale, si dhe moduli III -Vetëkujdesi **Trajnimi i THTP** - Qasja sensitive ndaj stresit dhe traumës për profesionistët shëndetësor , moduli i dytë “ Dhuna në baza gjinore dhe dhuna seksuale” u mbajt me 04.05.06. Mars 2025, si dhe moduli i tretë Vetëkujdesi u mbajt në Pejë më 29, 30 dhe 31 tetor 2025, për profesionistët shëndetësor të mjekësisë primare. Morën pjesë 25 pjesëmarrës, të njejtite pjesëmarrës që kanë përfundu modulin e parë gjatë vitit 2024, mjekë dhe infermierë, të përzgjedhur nga trajnerët e QKMF-së Pejë, të cilët ishin trajnuar nga trajnerët e projektit THTP nga Medica Gjakova gjatë periudhës prill 2023 – maj 2024.

Realizimi i trajnimit: Trajnimi u lehtësua nga katër trajnerë nga Peja (Melos Haxhiu, Hatixhe Krasniqi, Islam Husaj dhe Tringë Prenkaj). Moduli zhvillohej nga ora 9:30 deri në 14:30 gjatë tre ditëve, me aktivitete të ndryshme si prezantime Poëer Point, luajtje role, lojëra energjizuese, përdorim të flip-chart dhe diskutime mbi përvojat personale të pjesëmarrësve.

Post testi dhe diskutime: Në ditën e tretë për modulin e tretë , u realizua një post test i dizajnuar nga stafi i projektit THTP.

Monitorimi i trajnimit: Moduli ishte i monitoruar nga trajnerët e Medica Gjakova, të cilët kanë ndihmuar në ecurinë e trajnimit dhe kanë siguruar materialet e punës, ushqimin, pijet freskuese dhe kafën për pjesëmarrësit.

Vlerësimi i moduli dhe ambienti i trajnimit: Trajnimi u zhvillua në sallën e Qendrës për Moshën e Tretë në Pejë, afër Pallatit të Kulturës, që krijoi një ambient më të përshtatshëm dhe të rehatshëm për pjesëmarrësit, duke i larguar ata nga përgjegjësit e punës ditore.

Evaluimi i trajnimit: Në ditën e tretë për të dy modulet, pjesëmarrësit realizuan një evaluim të moduli dhe shprehën vlerësime pozitive për përmbajtjen dhe zhvillimin e trajnimit. Pjesëmarrësve iu dha manuale trajnimi dhe materiale të tjera mbështetëse.

Çertifikatat u shpërndan nga organizatorët dhe janë me pikë akredituese.

- **Trajnimi një ditorë i THTP** - Definimi i Seksit dhe gjinisë, dhuna në baza gjinore dhe seksuale u akreditua nga Oda e Mjekëve me datën 24.04.2025 me NR.REF;533/2025 me 8 pikë akredituese, kurse nga Oda e Infermierëve me 6 pikë akredituese.

Ky trajnim u realizua në sallën e ligjeratave të QTMF-Pejë dhe filloi në muajin shtator deri në dhjetor 2025. Gjithësej u mbajtën 7 grupe të përbër nga mjekë dhe infermier, një grupë ishte e përbër nga 5 mjekë dhe 10 infermierë, ku gjithësej 27 mjekë dhe 70 infermier të mjekësisë primare participuan në këtë trajnim të ndarë në këto grupe. Trajnimi kishte për bazë reference manualin e THTP, trajner ishin Dr. Tringe Prenkaj dhe inf. Hatixhe Krasniqi. Trajnimi ishte një ditorë dhe agjenda ishte prej orës 9:30 deri në ora 15:30. Në fund të ditës ishte rikapitulimi dhe evaluimi i trajnimit.

Grupi i parë u mbajt me datën 10.09.2025 me 15 pjesëmarës gjithësej

Grupi i dytë u mbajt me datën 24.09.2025 me 15 pjesëmarës gjithësej

Grupi i tretë u mbajt me datën 6.10.2025 me 15 pjesëmarës gjithësej

Grupi i katërtë u mbajt me datën 20.10.2025 me 15 pjesëmarës gjithësej

Grupi i pestë u mbajt me datën 10.11.2025 me 15 pjesëmarës gjithësej

Grupi i gjashtë u mbajt me datën 24.11.2025 me 10 pjesëmarës gjithësej

Grupi i shtatë u mbajt me datën 10.12.2025 me 12 pjesëmarës gjithësej

Çertifikatat do të mirren nga pjesëmarrësit pas procedurave të nënshkrimit nga Oda e Mjekëve me 8 pikë akredituese për mjekë kurse për infermier me 6 pikë

Trajnimi : Plani për EVP në kujdesin primar per infermier

GRUPET	DATA Fillimi i grupeve gjatë trajnimit tre ditorë	Numëri i pjesëmarësve	VENDI
--------	--	-----------------------	-------

GRUPI 1	28.01.2025- 30.01.2025	12	QTMF PEJË
GRUPI 2	11.02.2025- 13.02.2025	12	QTMF PEJË
GRUPI 3	25.02.2025- 27.02.2025	12	QTMF PEJË
GRUPI 4	11.03.2025- 13.03.2025	12	QTMF PEJË
GRUPI 5	25.03.2025 - 27.03.2025	10	QTMF PEJË
GRUPI 6	08.04.2025- 11.04.2025	12	QTMF PEJË
GRUPI 7	22.04.2025- 24.04.2025	12	QTMF PEJË
GRUPI 8	06.05.2025- 08.05.2025	9	QTMF PEJË
GRUPI 9	20.05.2025- 22.05,2025	10	QTMF PEJË
GRUPI 10	02.09.2025- 04.09.2025	10	QTMF PEJË
GRUPI 11	16.09.2025- 18.09.2025	10	QTMF PEJË
GRUPI 12	07.10.2025- 09.10.2025	11	QTMF PEJË
GRUPI 13	21.10.2025- 23.10.2025	12	QTMF PEJË
GRUPI 14	04.11.2025- 06.11.2025	10	QTMF PEJË
GRUPI 15	18.11.2025- 20.11.2025	10	QTMF PEJË

Gjatë trajnimit – Procesi për EVP në KPSH

Gjatë kësaj periudhe janë trajnuar 15 grupe 164 pjesëmarrës ,infermiere dhe profesionistë tjerë shëndetësorë që janë të punësuar në kujdesin parësor në QKMF-QMF-AMF- Abullanca të Stomatologjisë në Pejë dhe janë pajisur me 14 pikë akredituese gjatë këtijë viti

Gjatë këtijë viti kemi filluar me aktivitetet e EVP-së të organizuara nga QKMF në Pejë në kuadër të planit vjetor të ZHVP-së për periudhën Janar-dhjetor 2025 me përshkrimin e aktivitetit 05/1-VA2OM të akredituar nga OIK-u KEVP

Kemi filluar me aktivitet sipasë Agjendave të planifikuara gjatë aplikimit të aktivitetit të ZHVP-së prejë dates 28.01.2025 deri 18.11.2025 për çdo ndryshim për shkak festeve ju kemi njoftuarë me kohë.

Listat e pjesëmarrëseve janë të dëshmuara me të dhënatë personale dhe të nënshkruara per vijueshmërin gjatë ligjeratave të organizuara të EVP-së

Raportimi me kohe pasë çdo trajnimi për procesin e zhvillimit të aktivitetit për temat dhe programin e realizuare

Pjesemaresit ishn puntoret nga QKMF si dhe ata qe punojne vullnetare ne kuader te QKMF-se si dhe OJQ- Duarte plote meshire

Qellimi i ketije trajnimi ishte te fuqizohen njohurit dhe afetesite praktike te profesionisteve shendetesore te kujdesit paresor ne fusha te ndrysheme

Temat e trajtuara kishin per qellim zhvillimin e afetesive praktike,vleresimin klinik dhe nderhyrjen profesionale te infermierise ne situata te ndrysheme

1. Burnout-Menagjimi i stresit të akumuluar apo djegja profesionale-Menaxhimin e stresit ne vendin e punes- Diskutimet mbi stresoret ne vendet e punes,oraret e zegjatura,situatat emergjente dhe mungesa e mbeshtetjese psikologjike

Trajtuam qeshtjen e meditimit,frymarjen e thelle,,komunikimin efektive si dhe rendesin e mbeshtetjese nga koleget dhe stafit managjuese

2.Abuzimi i femijeve dhe dhuna - ligjeruam mbi llojete e abuzimeve te femijet ate fizike,emocionale,seksuale si dhe neglizhencen ndaje femijeve

Infermieret jane shpeshe te paret qe identifikojne shenjat e abuzimit dhe kane detyrim ligjor dhe etike per te raportuar rastete e dyshuara me kujdes dhe bashkepunim me stafin me pergjegjese.

Vleresim i kujdeseshem,dokumentim i sakte,bashkepunimi me institucionet mbrojetese dhe ruajtja e konfidencialitetit

3.Depresioni postpartal qe ndodhe te grate pase lindjese ,zakonishte mbrenda javeve te para ,gruaja ndijne lodhje,,mungese interesi per foshnjen,pagjumesi ,ndjenje faji ose paafetesi per perkujdesje ndaje foshnjes

Rendesia dhe roli i nje inferemieri ne keto raste ti monitoroje nenat pase lindjese per shenjate e depresionit te oferoje mbeshtetje emocionale dhe ti referoje nese eshte e nevojeshme te profesionistet adekuate me kohe.

4.Oksigjenoterapia dhe kujdesi infermierore teke pacientet me veshteresi ne frymarje apo pneumoni ne pergjithesi nese eshte e nevojeshme dhenja e oksigjenit te pacienti

Ilojet e administrimit dhe menytrat si dhe dozimet per raste te ndryshme kujdesi infermieror qe te monitoroje saturimin e oksigjenit,vleresimin e frymarejese,mbikeqyrjen per efekte anesore

5. Lendimet e kokes-Ilojet e lendimeve ,lendime te lehte(tronditje cerebrale),lendime te renda (hemoragji intrakraniale,fraktura te kafekes)

Duhet te kemi kujdes te humbja e vedijes,konfuzion,nauze ,dhimbje koke etje

Veprimet infermierore: vleresimi neurologjike (Glasgow Coma Scale)

monitorimi dhe bashkepunimi me ekipen shendetesore adekuata

laporti Vjetor I Vërtetimeve për praktiken e kryer profesionale pranë QKMF-Pejë													
Nga data 01.01.2025 deri më 30.11.2025													
Kërkesa për lejimin e praktikës Profesionale gjatë Muajve													
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
	35	22	12	12	3	24	41	7	34	22	12		224
Vërtetimet që lëshohen për marrjen e licencës													
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
	35	22	12	12	7	14	9	12	12	24	5		164
Shkolla e Mesme e Mjeksisë janë duke kryer praktiken Profesionale 2025 Laboranta 13,Teknik Farmacisë 1													
Shkolla e Mesme e Mjeksisë Euro school 20 janë duke kryer praktiken Profesionale 2025													
Shkenca Shëndetësore për profile Diagnostike dhe Infermieri, janë duke e kryer praktiken profesionale 2025,Teknik Laborant BSc 3 ,Infermieri BSc													
BURIMI:													
Këto shënime janë marrë nga arkiva e Qkmf-Pejë ,prandaj edhe janë të sakta dhe të protokoluara													

Raporti i komisionit për ankimimin e anakesave nga ana e pacientëve për shqyrtimin e ankesave të pacientve

Gajtë periudhës së parë për muajit Janar –Qershor 2025

Në shumicën e kutive të lavdatave dhe ankesave nëpër Qmf-ë dhe Amf-ë ishin të zbraza.

Të gjitha ankesat e drejtuara direct ne zyre dhe arkiv të cilat ishin me emra, numrat e telefonit dhe të letërnjoftiminim i kemi

Kontaktuar ,i kemi ftuar dhe jemi takuar me ankuesit dhe me puntorët shëndetsorë ndaj të cilve

është paraqitur ankesa .

Ankesat ishin të shkruara dhe kryesisht ishin rreth:

- Mosrespektimi i orarit,
- Sjelljet jo të mira të mjekve dhe infermiereve ndaj pacientve ,
- Komunikim jo i mirë mjek pacient, dhe
- Ankesat lidhur me bashkpagesat bazuar ne qarkoren informative 03/2024

Faza perfundimtare e Qendres Trajnuese multifunkionale per Komunen e QKMF-Pejë



Investimet Kapitale

Faza perfundimtare e ndertimit AMF Boge



Konkluzionet/ Rekomandimet

- Përdorimi i mjeteve për mbrojtje personale dhe dezinfektuesve ka qenë një nga përparsitë
- Duhet të punohet në përkufizimin dhe implemetin e Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë aq sa lejonjnë kushtet. Për këtë është formuar edhe grupi punues.
- Duhet të ndërtohet sistemi i vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut.
- Implementimi i Sistemit Mbikqyrës Mbështetëse. Edhe këtu është i formuar grupi për implementim.
- Fuqizimi i Komitetit për Ngritjen e Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore si dhe emerimi i Koordinatorit të Cilësisë.
- Ngritja e vetiniciativës dhe motivimit të personelit në përbushjen e detyrave punuese.
- Mbikqyrja e respektimit të orarit përmes instalimit të aparturaës për hyrje –dalje në të gjitha Ish.
- Aplikimi i Udhërrëfyesve dhe Protokoleve Klinike të miratura në menaxhimin e pacientëve. Posaqerishte te atij per pershkrimin e antibiotikeve si dhe te manulait te praktikës infermiore
- Zvogëlimi i përshkërimit të terapisë parenterale.
- Implementim i UA dhe akteve tjera nënligjore të miratuara.
- Miratimi i Statutit të QKMF në Asamblen Komunale.
- Vazhdimi i bashkëpunimit me agjencionet nacionale dhe ndërkombëtare si dhe Institucione të nivelit qendror dhe lokal duke u fokusuar në prioritetet dhe planin për vitin 2023.
- Renovimi dhe mirëmbajtja e objektit të QKMF-së si dhe objekteve tjera.
- Identifikimi i palëve të interesit si dhe mbajtja e komunikimit me qëllim të realizimit të objektivave me theks në ndërtimin e objektit të QKMF-se si dhe intervenimeve në infrastrukturë .
- Duhet punuar në fuqizimin e zoonimit si një nga principet kryesore të konceptit të M.F si ofrimin e shërbimeve sa më afër vendëbanimeve të tyre dhe shkarkimin e fluksit dhe presionit në QKMF si dhe do të ritej efektiviteti dhe cilësia e shërbimeve.
- Fuqizimi i rolit të ekipit të mjekësisë familjare (mjek familjar/infermier/e familjare).
- Mbulueshmëria e fëmijëve në kalendarin e vaksinimit me theks në komunitetet minoritare (Rom).
- Implementimi i rrjetit të SISH BHIS në të gjitha Institucionet e KPSH, si dhe ngritjen e cilësisë së futjes së dhënave në databazë.
- Punësimi i IT për mirëmbajtjen e paisjeve hardverike, softverike si dhe rrjetit të internetit.
- Mbikqyrja e disperzimit të medikamenteve nga LEB planifikimit dhe rrealizimit të planifikimit si dhe regjistrimi në SMSF.
- Racionalizimi i analizave laboratorike bazuar në diagnozë, aplikimi i termineve dhe funksionalizimi i labaratoreve në QMF.
- Aplikimi i i trendeve e reja në menaxhimin e aktiviteteve dhe personelit si implementimi i shpërblimeve por edhe dënimeve sipas legjisllaciniot.



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEĆ
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT
DEPARTAMENT FOR URBANISM AND ENVIORNMENT PROTECTION
ODELENJE ZA URBANIZAM I ZAŠTITU ZIVOTNE SREDINE

Datë/Datum/Date	03.12.2025
PËR/ZA/TO	Z.Gazmend Muhaxheri / Kryetar i Komunës së Pejës
NGA/OD/FROM	Arta Nallbani – Drejtoreshë e DUMM
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Raport i punës 2025

Gjatë kësaj periudhe kohore DUMM ka realizuar në tërësi planin e punës sipas projekteve të planifikuara dhe të listuara me poshtë sipas prioriteteve:

1. Harta Zonale e Komunës së Pejës

- HZK (Harta Zonale e Komunale) – Ka të miratuar dhe në fuqi Harten Zonale Komunale 2023-2031


2.PROCESI I LEGALIZIMIT TE NDËRTIMEVE PA LEJE

Më datë 01.09.2023 ka filluar afati i ri për aplikimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje pas ndryshim/plotësimit të Ligjit për trajtimin e objekteve pa leje, Ligji me nr 08/L-184. Afati për aplikim është deri me datën 31 Dhjetor 2025.

KERKESAT E PARAQITURA NË DUUM SIPAS KATEGORISË

Lloji i Kërkesës :	Numri i kërkesave:
Leje të lëshuara të Ndërtimit	230
Kërkesa të ndryshme	1225
Leje Komunale Mjedisore	27
Legalizime	219 kërkesa 129 të përfunduara me certifikatë

TE HYRAT NGA LEJET NDËRTIMORE, MJEDISORE DHE LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2023 ËSHTË: TOTAL: 1,756,887.55€
Legalizime: 49,044.12Euro



PËR : Kryetarin e Komunës Pejë / **Z. Gazmend Muhaxheri**

NGA: Drejtori për Zhvillim Ekonomik / **Z. Nasret Hajrizi**

LËNDA: Raporti i punës për Drejtorin për Zhvillim Ekonomik për periudhën Janar – Dhjetor 2025

Data: 16.12.2025

Në bazë të kërkesës **Tuaj** dhe duke u mbështetur në planin dhe programin e paraparë të punës për realizimin e punëve dhe detyrave po ju dergojm raportin për periudhën Janar – Dhjetor 2025 nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

SHTOJCA : RAPORTI

VËREJTJE: Raporti i paraqitur është i ndar në tri pjesë ku secila pjesë prezanton veç e veç punën e sektorve në DZHE.

1. RAPORTI I SEKTORIT TË TURIZMIT

1. Është punuar raporti narativ vjetor i punës për vitin 2024, janë bërë vlerësimet e stafit si dhe është punuar programi i punës për vitin 2026.

2. Kemi vazhduar me takimet dhe bashkëpunimet tjera me operatorët e turizmit nga sektori privat për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2025. Gjatë kësaj kohe kemi takuar mbi 70 biznese të sektoreve të ndryshme. Qëllimi i takimeve ka qenë i orjentuar në marrjen e sa më shumë informatave për zhvillimet në sektorin e ekonomisë dhe mundësit e bashkëpunimeve më të afërta në të ardhmen me qëllim të krijimit të një oferte më të konsoliduar dhe më të pasur për të plasuar pastaj në nivel vendi dhe ndërkombëtar.

3. Zhvillimi i takimeve pune me OJQ-të, nga Peja, Kosova dhe ndërkombëtare të cilat kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë dhe turizmit në komunën e Pejës. Janë diskutuar tema të ndryshme për zhvillimin e ekonomisë së qëndrueshëm dhe mundësit e bashkëpunimeve në projektet e ardhshme si dhe kordinimi i mundshëm i projekteve të përbashkëta. Në total gjatë vitit 2025 kemi takuar 25 OJQ.

4. Menaxhimi i Zyreve Informative të Turizmit. Kemi vazhduar me punët në kontinuitet për një menaxhim sa më të mirë të këtyre zyreve informative. Janë zhvilluar punë përgatitëse për shfrytëzimin sa më të mirë të potencialeve turistike të komunës, shërbimet e nevojshme informative për turistë si transporti, informata rreth shtigjeve malore, shtegu kulturor, etj. Zyret informative janë aktive dhe funksionojnë sipas planifikimeve. Vlen të theksohet se këto zyre janë duke u vlerësuar shumë nga të gjithë akterët e turizmit për punën profesionale.

5. Mbledhja dhe përpunimi i statistikave të vizitave në zyret informative. Statistikat janë të përpunuara për periudhën Janar – Dhjetor 2025 dhe në përgjithsi informacion kan kërkuar 14.321 vizitorë.

6. Interpretimi i statistikave nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Në tabelle më poshtë do të gjeni një kronologji të paraqitur nga agjencioni i Statistikave të Kosovës për vitin 2025.

Viti 2025			
Nr.	Muaji	Vizitor	Net-fjetje
1	Janar	12.155	39.681
2	Shkurt	8.564	26.215
3	Mars	4.592	14.562
4	Prill	7.661	28.821
5	Maj	8.451	31.197
6	Qershor	7.616	27.215
7	Korik	9.208	25.734
8	Gusht	13.914	37.200
9	Shtator	8.281	25.048
10	Tetor		
11	Nentor		
12	Dhjetor		
	TOTAL	80.442	255.673

Statistikat sipas ASK janë llogaritur deri në muajin Shtator dhe kemi 80.442 vizitorë ndërsa net-fjetje kemi 255.673

7. Edhe në vitin 2025 kemi vazhduar me menaxhimin e rrjeteve sociale të cilat kan një ndikim të madh në promovime andaj këto rrjete sociale janë shfrytëzuar për qëllim të promovimit në masë më të madhe dhe janë menaxhuar vazhdimisht faqet në:

- **Facebook** - “Peja Tourist Information”
- **Instagram** - “Visitpeja” dhe “Pejatourism” ;
- **Twitter** - “Visitpeja” dhe “PejaTourism”
- **LinkedIn** – Peja Tourist Informatoin Office
- **Facebook te projekteve** - “Culture Heritage Treasure of Cross border Region” dhe “Accursed Mountains Kosovo” të cilat gjithashtu promovojn komunën tonë por edhe rajonin;
- Gjithashtu jemi gjithmon të angazhuar në plotësimin e Web faqes me të dhëna të reja.

Të gjitha këto kalojn mbi 15.000 ndjeks ndërsa vizitueshmëria arrin mbi 200.000 shiqime.



8. Kemi vazhduar bashkëpunimin me MINT-Divizionin e Turizmit. Kemi qenë pjesë e zhvillimeve dhe bashkëpunimet tjera në furnizimin me materjal promovues për pjesëmarrje në panaire, si dhe pjesë e takimit të përgjithshëm për prezantimet e raporteve vjetore.

9. Kemi zhvilluar takime me organizatën SwissContact me të cilët kemi zhvilluar disa aktivitete si përfundimi i Strategjisë së Turizmit në Komunën e Pejës, Hartimi i Rregullorës për taksen në fjetje”, Punimi i hartës kulturore të qytetit, Punimi i hartës 3D të bejshkëve si dhe harta interaktive në 2D e vendosur në Web.

10. Ka vazhduar bashkëpunimi me grupin kordinues në mes të Pejës, Shkodrës dhe Plavës për projektin “Majat e Ballkanit”. Gjithashtu në bazë të vlerësimeve nga Tour Operatorët viti 2025 ka qenë një vit i mirë për numër të vizitorve në shtegun Majat e Ballkanit. Kordinime ka pasur edhe me projektet tjera ndërkufitare si “Culture Heritage Treasure of Cross border Region” dhe “Accursed Mountains Kosovo”.

11. Me ftesë të EU projektet IPA cross border kemi marrë pjesë në takime të ndryshme në promovimin e projekteve ndërkufitare, ndërsa në si drejtori kemi prezantuar në konferenca is shëmbull sukse si në menaxhimin e projekteve dhe vazhdimin e mirëmbajtjes së projekteve.

12. Kemi zhvilluar takim e të ndryshme me Universitetin Publik “Hahxi Zeka” për bashkëpunim ne Forumin Ekonomik Rajonal, kemi pranuar student të cilët kanë zhvilluar praktikën ne Sektorin e Turizmit si dhe jemi në proces të zhvillimit të projektit për ndërtimin e Inkubatorit .

13. Së bashku me zyrën e kryetarit kemi organizuar pritjen e 5 kryetarve të rajonit për projektin “Trekufiri”. Komunat ishin nga Peja, Deçani, Juniku nga Kosova, Plava dhe Gucia nga Mali i zi dhe Tropoja nga Shqipëria.

14. Me zhvillimin e projektit ndërkufitarë “Tourism for Future” kemi bërë certifikimin e 12 hoteleve me vulen “GreenLabel” duke e futur Pejën në hartën e botës me hotele të cilat janë të certifikuar me këtë vule mjaft të rëndësishme për zhvillimin e destinaconit turistik.

15. Së bashku me zyrtarët nga Projekti Natur Kosovo – Via Dinarica kemi marr pjesë në panairin ndërkombëtar BIT në Milano dhe në Expo Tiranë ku kemi prezantuar ofertën turistike të Pejës në nivle lokal, rajonal dhe ndërkufitarë.

16. Duke treguar një punë mjaft të madhe në menagjimin e ofertës turistike dhe duke qenë shembull i zhvillimit të turizmit në rajon në muajin shkurt të vitit 2025 kemi fituar çmimin e parë nga “Albania Tourism Excellence” në kategorin e promovimit të qëndrueshëm për “Majet e Ballkanit”.

17. Me kërkesë nga zyra e kryetarit kemi përcjell një grup të Gazetarve (70 në numër) nga rajoni. Për ta është pregaditur një program të vizitave në trashëgimi kulturore dhe natyrore të Pejës duke promovuar Pejën si destinacion turistik.

18. Kemi marr pjesë në zhvillimin e konferencës në projektin ndërkufitarë “CulToure” të zhvilluar nga Marimangat e Pejës dhe partner nga Mali i Zi. Konferenca ka qenë e orjentuar në promovimin e turizmit kulturor dhe bashkëpunimet në mes të dy vendeve në trashëgimi.

19. Gjatë vitit 2025 kemi përmbyllur me sukses 2 projektet ndërkufitare që janë realizuar nga komuna e Pejës. Projekti “*Nera*” dhe projekti “*Rural Tourism*” ishin dy projektet të cilat janë financuar nga EU dhe kanë treguar mjaft sukses në aktivitetet për mbrojtje të mjedisit si dhe zhvillimin e turizmit rural.

20. Kemi qenë pjesë e zhvillimeve të organizimit të festivaleve “*Via Dinarica*” dhe “*Peja Outdoor*” të cilat kanë treguar një sukses të madh në promovim dhe tërheqje të audiencës turistike në Pejë duke e bërë Pejën destinacion të turizmit të aventurës që gjithashtu është në vijë me Strategjin e Turizmit.

21. Nën organizimin e Federatës së bjeshkatarisë dhe ngjitjes sportive të Kosovës kemi qenë të angazhuar dhe pjesë e zhvillimit të organizmit të Asambles Gjenerale të UIAA si një nga aktivitetet më të mëdha për vitin 2025. Në këtë takim kanë qenë 70 shtete pjesëmarrëse dhe rreth 110 participues nga vende të ndryshme të botës. Për të arritur këtë organizim ka qenë një garë në mes të Nepalit dhe USA ndërsa besimi është dhënë tek Kosova dhe Peja në përgjithësi. Ky takim ka qenë edhe një promovim i destinacionit të Pejës duke pritur dhe promovuar potencialet tona tek federatat e bjeshkatarisë dhe ngjitjes të shteteve që kanë qenë pjesëmarrëse në këtë organizim.

22. Jemi në zhvillim të aktiviteteve me projektin Phoenix4.0. Ky është një projekt që promovon ndërmarrësinë dhe ofron bashkëpunim dhe lidhje mes të bizneseve nga 5 shtete (Itali, Spanjë, Kosovë, Kroaci dhe Slloveni)

23. Kemi zhvilluar projektin “Turizmi Kulturor – Diversifikimi i ofertës turistike përmes trashëgimisë kulturore dhe promovimi i traditave” të financuar nga MAPL-DEMOS. Kryesisht projekti ka qenë i fokusuar në përmirësimin e vizibilitetit të Muzeut të Pejës dhe Mullirit të Haxhi Zekës, por gjithashtu ka intervenuar në aktivitete tjera për të

arritur një lidhje sociale sa më të mirë të trashëgimisë kulturore me banorët e Pejës dhe turistët të cilët vizitojnë Pejë.

24. Kemi përcjell dhe kemi qenë gjithashtu pjesë e zhvillimit të aktiviteteve të projektit “Time Travel” të cilat janë zhvilluar në Pejë. Projekti është financuar nga fondet EU bahskëpunimi ndërkufitarë ndërsa është menaxhuar nga CDF (Community Development Fund),

25. Kemi zhvilluar takime të vazhdueshme me AZHR-Perëndim për të zhvilluar dokumentin për planifikimin e projekteve për vitin 2026 e cila do të prezantohet në MZHR për 4 vitet e ardhme që është gjithashtu mundësia e financimit.

26. Kemi zhvilluar takim të vazhdueshme me KFOR-Italian për bashkëpunimet dhe ndihmen e mundshme për OJQtë që zhvillojnë aktivitete të cilat i ndihmojnë turizmit në Komunën e Pejës.

27. Kemi aplikuar me projekte ndërkufitare me Malin e Zi dhe Shqipërinë. Me Malin e Zi kemi aplikuar me 2 projekte ndërsa me Shqipërinë me 3 projekte të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e ambientit dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

PROJEKTET ME BUXHET KOMUNAL

Projektet për vitin 2025 janë:

- Materjale Promovuese - Projekti ka përfunduar
- Panairi Veror – Projekti ka përfunduar
- Peja Outdoor Festival – Projekti ka përfunduar
- Ndërtimi i Muzeut të Bjeshkatarisë- Projekti është në afat 2 vjeçar. Punimet do të vazhdojnë edhe në vitin 2026.

- Ndërtimi i Zip Line në zonën e Podgurit – Projekti është në afat 2 vjeçar. Punimet do të vazhdojnë edhe në vitin 2026.

PROJEKTET ME DONATORËT TJERË

Projektet në përgjithësi janë implementuar në mënyrën më të mirë të duhur. Nuk ka ndonjë vërejtje nga EU sa i përket rrjedhës së projekteve. Të gjitha projektet kanë përfunduar në periudhën Janarë – Qershor të vitit 2025.

Më poshtë gjeni projektet të implementuara:

Projektet me fondet e EU – Programi ndërkufitarë Kosovë – Mali i Zi

- **NERA – New Environment Revitalization Approach** - me vlerë prej 479.027 ku vlera për pjesën e Pejës është 223.774 ndërsa participimi i komunës është 42.900 Euro

Përmes këtij projekti kemi furnizuar kompanin e pastrimit “EkoSig” me pajisje të nevojshme si shara të ndryshme, trimer, kolica, lopata, uniforma dhe kërkesa tjera. Gjithashtu i kemi furnizuar me makineri si thithëse pluhuri automatike me rymë dhe më një kamionetë që do të shërbejnë për një menaxhim më të mirë të punës dhe për një qytet më të pastër. Përmes këtij projekti kemi realizuar edhe “Planin Lokal për Veprim në Mjedis 2024 - 2028” si një dokument shumë i rëndësishëm për komunën e Pejës.

Trajnime të nevojshme dhe vizita studimore për të parë storie suksesi janë zhvilluar në komunën e Tuzit me menaxhmentin e “EkoSig” dhe ndërmarrjes publike “Ambienti” Pejë, ndërsa edhe menaxhmenti nga Tuzi kanë vizituar Pejën për të njëjtën arsye.

Në 6 shkolla në total 350 nxënës të Pejës janë mbajtur trajnime për vetëdijësim për ambient ndërsa ato 6 shkolla dhe 4 institucione tjera publike kanë përfituar nga 4 kontiner plastik (në përgjithsi 40) për ndarjen e mbeturinave. Projekti ka vendos edhe 40 shporta të mbeturinave nga metali përgjatë lumit Lumbardhi. Gjithashtu në shkolla janë vendos ulëse dhe janë mbjellë drunjë për ta festuar ditën e tokës së bashku me nxënës duke dhënë një mesazh për të mbrojtur ambientin.

Projekti ka përfunduar .

- **Turning our village in tourism destination** - me vlerë prej 456.106 Euro ku vlera për pjesën e Pejës është 228.000 dhe participimi i komunës është 34.208 Euro

Përmes këtij projekti kemi zhvilluar trajnime për banorët lokal në zonat rural të cilët ofrojnë akomodime ndërsa aktivitetet tjera nga ky projekt kanë të bëjnë me zhvillimin e shtigjeve të çiklizmit në zonat rurale, sinjalizimi i tyre, sinjalizimi trashëgimis kulturore, interevenimi në regullime, si dhe ndihma e banorve lokal për krijimin e kushteve më të mira për pritjen e vizitorve.

Gjithashtu projekti në zhvillimin e tij ka përfshirë edhe pjesën e promovimit të ofertës turistike dhe përmes këtij projekti kemi punuar në ngritjen e diversitetit të destinacionit turistik të Pejës duke e bërë një destinacion atraktiv për vizitor.

Projekti ka përfunduar

Projekti NATURKOSOVO

Projekti ka qenë iniciativë e qeveris Italiane e cila e ka ofruar fondin financiar ndërsa implementues të projektit kanë qenë organizatat Italiane CESVI dhe CELIM. Projekti ka të bëjë me zhvillimin e turizmit malorë në komunat Pejë, Deçan dhe Junik. Projekti ka realizuar zhvillime në drejtim të ngritjes së kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve, intervenim në infrastrukturë dhe promovim të destinacionit dhe ka vlerën 1.800.000 Euro. Projekti ka filluar implementimin duke bërë vlerësimin e shtegut Via Dinarica dhe është bërë sinjalizimi dhe markimi. Pjesë e projektit ka qenë zhvillimi i trajnimeve profesionale për ekipet kërkim shpëtim si dhe trajnime për guidave për udhëheqje në male. Në pjesën e fondit për subvencionim të bizneseve janë përkrahur në përgjithësi 11 biznese të shërbimeve turistike. Në pjesën e promovimit janë zhvilluar aktivitete si pjesëmarrja në panaire, organizimi me bloger dhe media të huaja që kanë bërë shkrime për produktin Via Dinarica e në veçanti për Pejën.

Përmes këtij projekti është investuar në regullimin e strehimit të kilometrit të 5'të si dhe murit zbulues nga guri e gjithashtu intervenim në shtegun tematik në Ujvaren në Shtupeq të Madh.

Projekti ka përfunduar

PROJEKTI “TOURISM FOR FUTURE” - Është projekt ndërkufitar më Malin e Zi ndërsa komuna është bashk-financuese. Projekti ka realizuar Çertifikimet e destinacionit dhe bizneset me standardin internacional EcoLabel duke krijuar mundësi të menaxhimit të vetqëndrueshëm të turizmit në Pejë. Edhe ky projekt ka zhvilluar aktivitete si ngritje të kapaciteteve njerëzore, zhvillim të infrastrukturës së lehtë, zhvillimi i aktiviteteve për çertifikime dhe promovim të Pejës si destinacion të qëndrueshëm dhe EcoTurizem. Projekti ka realizuar çertifikimn e 16 bizneseve dhe 12 auditorë të cilët do të përcjellin standardet në të ardhmen. Në si drejtorat bashkërisht me këtë projekt në vitin 2023 kemi organizuar edhe festivalin e Turizmit “Peja Tourism Outdoor Festival” që ka bërë bujë të madhe në promovimin e destinacionit tonë për turizmin e aventurës.

2. SEKTORI I EKONOMISË.

AKTIVITETI ▼ PERIUDHA ►	Janar	Shkurt	Mar s	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shta tor	Tetor	Nentor
Licenca për Alkool	12	03	04	13	14	08	16	6	1	//	//
Licenca Speciale	03	//	//	//	//	01	01	//	//	//	//
Licenca për Auto Taxi	02	//	01	//	//	//	//	//	//	//	//
Licenca për Radio Taxi	//	//	//	//	//	//	//	//	10	//	//
Licenca për Autobus	03	//	//	//	//	01	//	//	//	//	//
Rendi i Udhëtimit	01	01	01	02	//	//	//	//	//	//	//
Vërtetim për Pension	10	08	03	02	04	03	04	05	03	07	06
Referenca	//	//	//	//	//	//	//	//	//	//	//
Ankesa	//	//	//	//	05	//	//	//	//	//	//
Lënd të Proceduara për subvencion e	//	//	01	79	//	//	//	//	//	//	//
Lënd te procesuara gjatë vitit	31	12	10	96	23	13	21	11	14	07	06

3. SEKTORI I REXHISTRIMIT TE BIZNESEVE

Nr.	Aktivitetet	Numri	Verejtje
1	Regjistrimi i bizneseve të reja	480	
2	Ndryshime ne biznes	345	
3	Shuarje te biznesit	35	
4	Kerkesa te Ndryshme Vertetime, ndrrime te certifikatave etj.	610	
Gjithësejt të perpunuara : 1470 lëndë			

4. Problemet

Drejtoria për zhvillim ekonomik gjatë vitit 2025 është ballafaquar me mjaft probleme të natyrave të ndryshme që kanë shkaktuar vështirësi në zhvillimin e aktiviteteve të parapara në planin e punës.

Një nga problemet është mungesa e Strategjis për Zhvillim Ekonomik Lokal e cila është gjithashtu kërkesë nga niveli nacional qeverisës për ta hartuar.

Mungesa e stafit po e bënë mjaft të vështirë funksionimin e kësaj drejtorie. Pjesa e sektorit të turizmit ka mungesë të stafit për ta mbajtur hapur Zyrën për Informacion Turistik. Gjithashtu mungesë të stafit në menaxhimin e kontratave ku starfi i tanishëm (2 persona) duhet të angazhohet me shumë punë të natyrave të ndryshme si në menaxhimin e zyreve informative, realizimin e projekteve infrastrukture, përcjellja e projekteve me donacionet e huaja, pjesëmarrje në takime strategjike, vizitat në terren, promovim dhe mirëmbajtje të rrjeteve sociale, Webfaqen e turizmit etj etj. Andaj angazhimi i stafit të ri (dy zyrtarë) do të mundëson zhvillimin e punës në mënyrë shumë me efikase dhe më profesionale.

Gjithashtu për mungesë të stafit në sektorin e Ekonomisë jemi të bllokuar në pjesëmarrjen e shumë takimeve strategjike të cilat do të nikojnë në zhvillimin e ekonomisë së qëndrueshme në Komunën e Pejës. Për këtë propozojmë që edhe në sektorin e ekonomisë të kemi edhe një staf mbështetës për zhvillimin e punëve në mënyrë të suksesshme.

Mungesa e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve njerzore gjithashtu është një problematikë që ndikon në menaxhimin e suksesshëm të punës. Stafi gjithnjë paraqet kërkesa për trajnime për tu avancuar me qëllim të realizimit të punëve me efikasitet dhe profesionalizem.

5. Rekomandim

Rekomandojmë që në të ardhmen të mundësohet punësimi i së paku tre personave që do të udhëheqin punë specifike në drejtin për zhvillim ekonomik dhe të ofrohen

mundësi për trajnime të stafit me qëllim të profesionalizimit për një menaxhim më të mirë të punëve dhe detyrave që ju takojnë në drejtori.



ZYRA E PERSONELIT

Pejë, me 17.12.2025

Zyrtarisht

P ë r : Kryetarin e Komunës Gazmend Muhaxheri.

N g a : Zyra e Personelit

Lënda: Raporti për periudhën 1(një) vjeçare për vitin 2025

9. **Programet e shkollave dhe kopshtit në shenjë solidariteti** –
 - Shkolla fillore “8 Marsi”, Shkolla fillore “Asdreni” dhe Kopshti i fëmijëve “Pëllumbat e Paqes” u bashkuan me programet e tyre në shenjë solidariteti me fëmijët me Sindromën Down.
 - Nxënësit dhe fëmijët organizuan aktivitete të ndryshme artistike dhe edukative së bashku me fëmijët me Sindromën Down, duke krijuar një atmosferë përfshirëse dhe të ngrohtë.
10. **Animacion me maskota** – U angazhuan dy maskota për argëtimin e fëmijëve.

Pjesëmarrësit dhe kontributet

- **Numri total i pjesëmarrësve:** Rreth 200 persona, përfshirë gra, burra, vajza dhe djem.
- **Institucionet dhe organizatat pjesëmarrëse:**
- **Donatorët dhe mbështetësit:**
 - **Hotel Dukagjini** – Siguroi ëmbëlsira, tavolina dhe karrika
 - **Libraria Dukagjini** – Dhuroi 100 çanta me libra për ngjyrosje
 - **Corporata Devolli** – Siguroi dy maskota dhe dhurata për fëmijët
 - **Fabrika e Ujit Rugove** – Siguroi ujë për pjesëmarrësit

Rezultatet dhe ndikimi

- Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e personave me SindromënDown
- Inkluzioni i fëmijëve me SindromënDown në aktivitete sociale dhe argëtuese
- Angazhimi i shkollave dhe kopshtit për të krijuar programe përfshirëse për fëmijët me SindromënDown
- Bashkëpunimi i suksesshëm midis institucioneve, OJQ-ve dhe bizneseve lokale
- Pjesëmarrje aktive dhe angazhim i madh i komunitetit

Rekomandime për aktivitetet e ardhshme

- Zgjerimi i aktiviteteve për të përfshirë edhe fëmijë nga rajone të tjera.
- Organizimi i trajnimeve për mësuesit dhe prindërit mbi mbështetjen e fëmijëve me SindromënDown.
- Krijimi i një programi të qëndrueshëm për ndërgjegjësim dhe edukim në lidhje me SindromënDown.
- Vazhdimi i bashkëpunimit me shkollat dhe kopshtet për përfshirjen e fëmijëve me SindromënDown në aktivitetet e tyre të përditshme.

Përfundimi

Aktiviteti për Ditën Botërore të SindromësDown u realizua me sukses falë bashkëpunimit të gjerë midis institucioneve publike, organizatave joqeveritare dhe bizneseve vendore. Pjesëmarrja e 200 personave, përfshirja e Asamblesë Komunale të Fëmijëve dhe angazhimi i shkollave “8 Marsi” dhe “Asdreni” si dhe kopshtit “Pëllumbat e Paqes” me programet e tyre unike, treguan rëndësinë dhe impaktin e këtij aktiviteti në komunitet. Kjo ngjarje ndihmoi në promovimin e përfshirjes dhe diversitetit, duke dhënë një mesazh të fuqishëm për barazinë dhe pranimin e dallimeve në shoqëri.





- **Aktiviteti 6: Trajnim**
- **Data: 15 korrik 2025**
- **Vendi: Salla e Kuvendit, Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 16 gra**

1.1.2. Fuqizimin e grave në lidërsip dhe të drejtat e tyre

Në kuadër të angazhimeve për barazi gjinore, u realizua trajnimi për fuqizimin e grave në lidërsip dhe të drejtat e tyre, aktivitet i paraparë në pikën 1.1.2 të Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore në Komunën e Pejës.

Trajnimi u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal, me mbështetjen e **UN WomenKosovo**, organizatë që ka qenë edhe partnere në hartimin e këtij Plani të Veprimit.

Trajnimin e udhëhoqi znj. Brikena Avdyli, trajnere dhe konsulente në UN Women, e cila ndau me pjesëmarrëset përvojat dhe njohuritë e saj rreth fuqizimit të grave në udhëheqje dhe avancimin e të drejtave të tyre.

Në trajnim morën pjesë gra nga biznese të ndryshme, të cilat diskutuan sfidat dhe mundësitë për përfaqësim më të madhë në vendimmarrje.






 **Funded by the European Union**

 **UN WOMEN**

Lista e pjesëmarrësve

Vendi: Pejë Trajnim për integrim gjinor fuqizimin e grave për
Data: 15/07/2023 leadership


	Emri dhe mbiemri	Komuna	Pozita	Email adresa	Nënshkrimi
1	DETA KRASHKA	Pejë	Shkollë e Mesme	deta.krashka@gmail.com	
2	Donjeta Murrina	Pejë	Shkollë e Mesme	donjeta.murrina@gmail.com	
3	ANIL DAVOCU	PEJË	Shkollë e Mesme	anil.davocu@gmail.com	
4	Martha Kelmendi	PEJË	BLETARE	Martha.kelmendi@gmail.com	
5	LITAFETE KASHANI	TURJAK-PEJË	BLETARE	litafete.kashani@gmail.com	
6	Mirsad Zogaj	Pejë	HERMANI - PAM-PEJË	mirsad.zogaj@gmail.com	
7	Amrita Turanaj	Pejë	BLETARE	amrita.turanaj@gmail.com	
8	Adrita Kashteci	Pejë	Fotomate	adrita.kashteci@gmail.com	
9	Shigjetë Berisha	Pejë	Fernere	shigjeta.berisha@gmail.com	
10	Shqipe Kastrati	Dobërdol	Pentecost	shqipe.kastrati@gmail.com	

 **Funded by the European Union**

 **UN WOMEN**

Lista e pjesëmarrësve

Vendi: Trajnim për integrim gjinor
Data:

	Emri dhe mbiemri	Komuna	Pozita	Email adresa	Nënshkrimi
11	SABINA MALOCU	PEJË	MAKE UP ARTIST	sabinamalocu3@gmail.com	
12	Merlinda Smajli	Pejë	Estetikë, thirrje	merlinda.smajli@gmail.com	
13	ARITA BOJKU	PEJË	PASTIGERI	arita.bojku@gmail.com	
14	Shake Mula	Pejë	Bletari	shake.mula@gmail.com	
15	ARLINDA KASTRATI	Pejë	Bletari Elisa	arlinda.kastrati@gmail.com	
16	Brittany Andryli	Prishtinë	Konsulente	brittany.andryli@gmail.com	

- **Aktiviteti 7: Panelistenë** sessionin informues “Question Time: Të Rinjtë dhe të Drejtat Pronësore”

- **Data:** 13 gusht 2025
- **Vendi:** Qendrën Rinore "Dardania" – Pejë
- **Numri i pjesëmarrësve:** 35 (20 vajza dhe 15 djem)

1.1.9. Takime informuese për rendësin e regjistrimit të pronave në emër të dy bashkëshorteve dhe në emër të grave.

Organizatorët:

YMCA in Kosovo, në bashkëpunim me ATRC dhe me mbështetje nga Banka Botërore

Pjesëmarrja dhe përbërja gjinore:

Në aktivitet morën pjesë gjithsej **35 të rinj nga shkollat e mesme**, prej të cilëve **20 vajza dhe 15 djem**. Kjo strukturë pjesëmarrjeje reflekton një përfshirje të balancuar gjinore dhe interes të lartë të të rinjve për çështjet e barazisë dhe të drejtave pronësore.

Përshkrimi i aktivitetit:

Aktiviteti "Question Time: Të Rinjtë dhe të Drejtat Pronësore" u zhvillua në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të të rinjve për të drejtën e barabartë në pronë dhe trashëgimi.

Në këtë ngjarje pata kënaqësinë të marr pjesë si **paneliste**, duke kontribuar në diskutimet mbi rëndësinë e informimit ligjor, pjesëmarrjes aktive të të rinjve dhe fuqizimit të vajzave e grave në ushtrimin e të drejtave të tyre pronësore.

Temat dhe pikat kryesore të diskutimit:

- Rëndësia e njohjes së të drejtës ligjore për pronë dhe trashëgimi nga të rinjtë;
- **Regjistrimi i pronës në emër të të dy bashkëshortëve dhe nxitja e regjistrimit të pronës në emër të grave** si një hap i domosdoshëm drejt barazisë ekonomike;
- Sfida që hasin vajzat dhe gratë në ushtrimin e të drejtave pronësore dhe trashëgimore;
- Roli i të rinjve si agjentë ndryshimi në promovimin e barazisë gjinore në komunitet;
- Mënyrat praktike për fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave përmes pronësisë dhe qasjes në resurse ekonomike.

Rezultatet e arritura:

- U rrit ndërgjegjësimi i pjesëmarrësve mbi rëndësinë e regjistrimit të përbashkët të pronës dhe përfitimet që sjell barazia në pronësi;
- U theksua rëndësia e përfshirjes së grave në proceset e vendimmarrjes dhe në dokumentet zyrtare të pronësisë;
- U inkurajuan vajzat dhe djemtë që të informohen dhe të avokojnë për të drejtat e tyre ligjore dhe pronësore;
- U krijua një hapësirë gjithëpërfshirëse për dialog ndërmjet të rinjve, organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve institucionalë.

Ndikimi në kuadër të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore:

Ky aktivitet kontribuon në përmbushjen e objektivave të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore, duke:

- Promovuar **barazinë ligjore dhe ekonomike midis grave dhe burrave** në pronësi;
- Fuqizuar **vajzat dhe gratë e reja** për të qenë pjesë aktive në vendimmarrje dhe në ushtrimin e të drejtave të tyre ligjore;
- Rritur **ndërgjegjësimin e brezit të ri** për rëndësinë e regjistrimit të përbashkët të pronës si mjet i fuqizimit ekonomik dhe social;
- Mbështetur zbatimin e politikave për barazi gjinore në nivel lokal dhe kombëtar.

Përfundim:

Takimi informues shërbeu si një platformë e rëndësishme për diskutim dhe ndërgjegjësim mbi barazinë gjinore dhe të drejtat pronësore. Diskutimet e hapura për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve dhe në emër të grave kontribuan në kuptimin më të thellë të rëndësisë që ka pronësia e barabartë për fuqizimin e grave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit. Shpreh mirënjohje për organizatorët – YMCA in Kosovo, ATRC dhe Bankën Botërore – për mbështetjen dhe angazhimin në fuqizimin e zërit të të rinjve për barazi dhe drejtësi gjinore.



- **Aktiviteti 9: Punëtorja: “Nisma për të Drejtën e Pronës (NDP)”**
- **Data: 14 gusht 2025**
- **Vendi: Salla Kuvendit – Pejë**

- **Numri i pjesëmarrësve: 30 (25 gra dhe 5 burra)**

1.1.9. “Nisma për të Drejtën e Pronës (NDP)”

Organizator:

Instituti KLG (KosovoLocalGovernment Institute), në bashkëpunim me **Komunën e Pejës**

Zbatues:

Projekti zbatohet nga ATRC dhe KLG, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe Fondit për Paqe dhe Shtetndërtim.

Përshkrimi i aktivitetit:

Në kuadër të projektit “Nisma për të Drejtën e Pronës”, u organizua një punëtori me pjesëmarrjen e **zyrtarëve komunalë, grave, të rinjve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.**

Si pjesëmarrëse në këtë aktivitet, ata mundësinë të kontribuojnë në diskutimet mbi **fuqizimin e grave përmes të drejtës së pronës**, duke theksuar rëndësinë e informimit, ndërgjegjësimit dhe regjistrimit të pronës në **emër të të dy bashkëshortëve dhe në emër të grave.**

Pikat kryesore të diskutimit:

- Sfidat që përballen gratë në realizimin e të drejtave pronësore;
- Rëndësia e bashkëpunimit mes institucioneve lokale dhe komunitetit;
- Nevoja për mekanizma mbështetës dhe fushata ndërgjegjëse për barazi gjinore në pronësi.

Rezultat i arritur:

Punëtorja kontribuoi në **rritjen e vetëdijesimit për barazinë gjinore në pronësi** dhe nxitjen e grave për të ushtruar të drejtat e tyre ligjore mbi pronën.

Mesazhi kryesor:

“Bëje tënden – Regjistroje pronën!”





- **Aktiviteti 10: Titulli i aktivitetit:** Ligjëratë publike “Aktivizmi Feminist dhe Arti Feminist”
- **Data:** 16 shtator 2025
- **Vendi:** Qendra Kreative “Dukagjini”, Pejë
- **Numri i pjesëmarrësve:** 60 (35 vajza dhe 25 djem)
- **Organizuar nga:** Indefinite Institute
- **Mbështetur nga:** Friedrich Ebert Stiftung (FES)
- **Në bashkëpunim me:** Zyrën për Barazi Gjinore, Drejtorinë e Arsimit dhe organizatën jo qeveritare Anibar

Pika 1.1.3 – Takime informuese mbi Ligjin për Barazi Gjinore dhe masat afirmative që parashikohen për t’u zbatuar si detyrim i këtij ligji

2. Qëllimi i aktivitetit

Ky aktivitet është realizuar në kuadër të zbatimit të pikës 1.1.3 të Planit të Veprimit Lokal për Barazi Gjinore, me synim:

- Informimin dhe vetëdijesimin e të rinjve mbi **Ligjin për Barazi Gjinore** dhe **masat afirmative** që ky ligj parasheh për institucionet publike dhe shoqërinë;
 - Nxitjen e të rinjve që të përdorin **artin dhe aktivizmin** si mjete për **ndryshim shoqëror dhe barazi gjinore**;
 - Promovimin e **pjesëmarrjes së barabartë gjinore** në fushat e artit, arsimit dhe aktivizmit qytetar.
-

3. Pjesëmarrësit

Në aktivitet morën pjesë gjithsej **60 nxënës** nga tri shkolla të mesme të Komunës së Pejës, prej tyre **35 vajza** dhe **25 djem**.

Shkollat pjesëmarrëse:

- ☐ Shkolla Teknike “RifatGjota”
- ☐ Shkolla e Artit “OdhisePaskali”
- ☐ Gjimnazi "Bedri Pejani"

Kujdestaret shoqëruese:

- ErmondaFoniqi – mësimdhënëse në Gjimnazin "Bedri Pejani"
- Rina Vuthi – mësimdhënëse në “RifatGjota”
- Arta Kollqaku – mësimdhënëse në “OdhisePaskali”Pjesëmarrësit u angazhuan aktivisht në diskutime, punë në grupe dhe ushtrime ndërvepruese që lidhin **aktivizmin qytetar me artin feminist**.

4. Përmbajtja dhe temat e trajtuara

Ligjërata përfshiu kombinimin e **aspekteve ligjore, sociale dhe artistike**, duke u fokusuar në:

- Parimet kryesore të **Ligjit për Barazi Gjinore në Republikën e Kosovës**;
 - **Masat afirmative** për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në sferën publike;
 - Rolin e **artit si mjet emancipues dhe kritik shoqëror**;
 - Modele të **aktivizmit feminist** në Kosovë dhe rajon;
 - Diskutim të hapur mbi **sfidat e vajzave të reja** në qasje të barabartë në arsim, kulturë dhe punësim.
-

5. Rezultatet dhe ndikimi

- Nxënësit u **informuan për detyrimet ligjore** që burojnë nga Ligji për Barazi Gjinore dhe mënyrat e zbatimit në nivel lokal;
- U rrit **ndërgjegjësimi gjinor** dhe u promovua **pjesëmarrja e barabartë** e vajzave dhe djemve në aktivitete kulturore e edukative;
- Aktiviteti kontribuoi në **zbatimin e masave afirmative** përmes përfshirjes së balancuar gjinore në fushat e artit dhe edukimit;
- U krijua **hapësirë për dialog** mes nxënësve, mësimeve dhe institucioneve lokale mbi rolin e artit në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

6. Falënderime

Falënderim i veçantë për:

- **Indefinite Institute** – për organizimin profesional të ligjëratës;
- **FriedrichEbertStiftung (FES)** – për mbështetjen financiare dhe logjistike;
- **Anibar dhe Drejtoria e Arsimit Pejë** – për bashkëpunimin institucional;
- **Shkollat pjesëmarrëse dhe mësimeve kujdestare** – për angazhimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të të rinjve.

7. Përfundim

Ky aktivitet përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në zbatimin e pikës 1.1.3 të Planit të Veprimit Lokal për Barazi Gjinore në Komunën e Pejës.

Përmes ndërthurjes së **arsimit, artit dhe aktivizmit**, janë fuqizuar të rinjtë si **promotorë të barazisë dhe drejtësisë sociale**, duke nxitur një kulturë të **përfshirjes, respektit dhe vetëdijes gjinore** në komunitet.





- **Aktiviteti 11: Titulli i aktivitetit: Fuqizim përmes aftësimit profesional**
- **Data: 22 shtator 2025**
- **Vendi: Zyra e Punësimit dhe Qendra e Aftësimit Profesional, Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 13 (6 gra dhe 7 gra)**

Pika 1.1.2 – Sesione të hapura për fuqizimin e grave në lidhësi dhe të drejtat e tyre

Tema: Fuqizim përmes aftësimit profesional

Kohëzgjatja: 3 muaj

Organizuar nga: Zyra për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës

Në bashkëpunim me: Zyrën e Punësimit dhe Qendrën e Aftësimit Profesional

Përmbajtja e aktivitetit

Në kuadër të objektivit 1.1.2 për fuqizimin e grave dhe vajzave në lidhësi dhe avancimin e të drejtave të tyre, Zyra për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës ka organizuar një iniciativë konkrete që synon rritjen e pavarësisë ekonomike përmes **aftësisë profesionale**.

Ky aktivitet përfshin **krijimin e grupeve të grave dhe vajzave** që ndjekin **kurse profesionale 3-mujore** në Qendrën e Aftësisë Profesionale. Trajnimet ofrojnë **aftësi praktike dhe teorike** në fusha që rrisin mundësitë për punësim, vetëpunësim dhe avancim në tregun e punës.

Pjesëmarrësit

Në këtë cikël trajnimesh janë përfshirë gjithsej **13 pjesëmarrëse**, prej të cilave:

- **6 gra**, dhe
- **7 vajza të reja**.

Ky përbërje e balancuar kontribuon në përfshirjen ndërbreznore të grave në proceset e fuqizimit profesional dhe ekonomik.

Qëllimet e aktivitetit

- Të fuqizohen gratë dhe vajzat përmes aftësisë praktik e profesionale;
- Të përmirësohen aftësitë për punësim dhe pavarësi ekonomike;
- Të promovohet barazia gjinore dhe pjesëmarrja aktive e grave në tregun e punës;
- Të forcohet vetëbesimi dhe lidhësi te gratë pjesëmarrëse.

Rezultatet e pritura

- Rritja e përfshirjes së grave dhe vajzave në programe të aftësisë profesionale;
- Përmirësimi i mundësive për punësim dhe vetëpunësim;
- Ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe social të grave pjesëmarrëse;
- Rritja e ndërgjegjësisë për rëndësinë e investimit në edukim dhe aftësim të vazhdueshëm.



- **Takim: Takim Koordinues me anëtarët e MKDhF**
- **Data: 27tetor 2025**

- **Vendi: Komuna Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 8 (3 gra dhe 5burra)**

Në zyren për barazi gjinore, Komuna Pejëu mbajt një takim koordinues nën organizimin e Zyrtares për Barazi Gjinore, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje.

Qëllimi i këtij takimi ishte planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve në kuadër të fushatës vetëdijesuese për parandalimin e trafikimit me njerëz, me fokus në rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për këtë dukuri shqetësuese dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional.

Gjatë takimit u diskutuan hapat konkretë për organizimin e fushatës, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse, si dhe rëndësia e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit me njerëz. Takimi shërbeu si bazë për koordinim të mëtejshëm dhe veprime të përbashkëta në funksion të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave.

Ky aktivitet kontribuon në forcimin e mekanizmave lokalë për parandalimin e trafikimit me njerëz dhe në ndërtimin e një qasjeje të koordinuar për adresimin e kësaj dukurie në Nivel Komunal.



- **Aktiviteti 12: Titulli i aktivitetit: Fuqizim përmes aftësimit profesional**
- **Data: 30 tetor 2025**

- **Vendi: Qendra e Aftësimit Profesional, Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 10 (9 gra dhe 1 burrë)**

Pika 1.1.2 – Sesione të hapura për fuqizimin e grave në leadership dhe të drejtat e tyre

Zyrtarja për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës, në bashkëpunim me përfaqësuesen e Zyrës së Punësimit, realizoi një vizitë në Qendrën e Aftësimit Profesional në Pejë, ku po zhvillohen trajnime profesionale për grupe të grave dhe vajzave të përfshira në programet e përbashkëta të këtyre institucioneve.

Këto trajnime tre-mujore kanë për qëllim pajisjen e pjesëmarrëseve me aftësi praktike dhe profesionale, duke rritur mundësitë e tyre për punësim dhe duke kontribuar në fuqizimin e tyre ekonomik. Gjatë vizitës u diskutua me stafin e qendrës për ecurinë e trajnimeve, si dhe për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit institucional në të ardhmen.

Ky aktivitet pasqyron angazhimin e Komunës së Pejës dhe të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës në promovimin e barazisë gjinore përmes krijimit të mundësive konkrete për aftësim profesional dhe integrim të grave në tregun e punës.



- **Takim me përfaqësuesit e OSBE-së**
- **Data: 5 nëntor 2025**

- **Vendi: Komuna Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 3 (2 gra dhe 1 burrë)**

Në Zyrën për Barazi Gjinore të Komunës së Pejës u mbajt një takim me përfaqësuesit e Misionit të OSBE-së në Kosovë, znj. Sabina Medenović Lluka dhe z. Aleksandar Vasiljević.

Gjatë takimit u diskutua për projektet aktuale në fushën e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale, si dhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Pejës dhe Misionit të OSBE-së. U vlerësua interesimi dhe mbështetja e OSBE-së për avancimin e politikave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore dhe përfshirjen e komunitetit.

Takimi shërbeu si bazë për vazhdimin e bashkëpunimit me fokus në veprime konkrete dhe ndikim afatgjatë në nivel lokal.



- **Aktiviteti 13: Ligjëratë sensibilizuese për parandalimin e trafikimit me njerëz**

- **Data: 6 nëntor 2025**
- **Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 36 (30 gra dhe 6 burra)**

Pika 3.1.9 – Aktivitete informuese me koordinatorët e shkollave fillore dhe të mesme

Në kuadër të fushatës sensibilizuese “Parandalimi i trafikimit me njerëz”, e organizuar nga Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Njerëz, në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore të Komunës së Pejës, u mbajt një ligjëratë sensibilizuese me koordinatorët e shkollave fillore dhe të mesme të komunës, ndërsa në mungesë të tyre u ftuan psikologët shkollorë.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që informacionet dhe njohuritë e ofruara nga ekspertët e fushës të përcillen më pas në institucionet arsimore ku veprojnë pjesëmarrësit, duke kontribuar në rritjen e vetëdijes dhe parandalimin e rasteve të trafikimit me njerëz në mesin e fëmijëve dhe të rinjve.

Ligjërata u zhvillua në sallën e Kuvendit Komunal dhe në të morën pjesë përfaqësues të Policisë së Kosovës, si dhe ligjëruesit znj. Lindita Pajaziti, z. Blerim Seferi dhe Dr. Nusret Pepaj, psikiatër dhe anëtar i Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje.

Ky aktivitet theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional në mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e mekanizmave lokalë për parandalimin e trafikimit me njerëz.





- **Aktiviteti 14: Shkëmbim përvojash dhe rrjetizim ndërmjet grave sipërmarrëse/bletare**
- **Data: 7 nëntor 2025**
- **Vendi: Fsh. Dobordol, Komuna Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 12 gra**

Pika 2.1.10 – Sesione informuese me gratë bletare

Më 7 nëntor 2025, në Pejë u organizua një aktivitet i shkëmbimit të përvojave dhe rrjetizimit ndërmjet grave sipërmarrëse nga Komuna e Pejës dhe Komuna e Fushë Kosovës. Në këtë kuadër, Zyrtarja për Barazi Gjimore e Komunës së Fushë Kosovës, znj. Lindita Dervisholli-Prebreza, së bashku me një grup grash fermere dhe bletare, realizuan një vizitë studimore në biznesin “EkoMjalta”, në fshatin Dobërdol, Pejë, në pronësi të sipërmarrëses ArditaKastrati.

Gjatë këtij takimi, znj. ArditaKastrati ndau me pjesëmarrëset përvojën e saj profesionale dhe rrugëtimin nga hapat e parë në bletari deri në ndërtimin e një biznesi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm me markën “EkoMjaltë”. Gratë pjesëmarrëse patën mundësi të shkëmbejnë përvoja, të diskutojnë sfidat dhe sukseset në zhvillimin e bizneseve të tyre, si dhe të identifikojnë mundësi konkrete për bashkëpunim në të ardhmen.

Ky aktivitet u mbështet nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe përfaqëson një praktikë të mirë të bashkëpunimit ndërkomunal, rrjetizimit të grave sipërmarrëse dhe fuqizimit ekonomik të grave, duke kontribuar në ndërtimin e një komuniteti më të barabartë dhe më të fuqishëm.





- **Aktiviteti 15: Ligjëratë informuese për parandalimin e trafikimit me njerëz me nxënësit e klasës së 10-të**
- **Data: 11 nëntor 2025**
- **Vendi: Shkollën e Mesme Ekonomike “AliHadri” në Pejë.**
- **Numri i pjesëmarrësve: 26 (10 gra, 1 burrë, 10 vajza, 5 djem)**

Pika 3.1.9 – Aktivitete informuese me nxënësit/et në shkollë, mbi trafikimin e grave, dhe vajzave

Në kuadër të fushatës vetëdijesuese kundër trafikimit me njerëz, Zyra për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës organizoi një ligjëratë informuese me nxënësit e klasës së 10-të në Shkollën e Mesme Ekonomike “AliHadri” në Pejë. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me anëtarët e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje dhe Njësitin Anti-Trafikim, si dhe në koordinim me Drejtorinë e Arsimit në Pejë.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve relevante, përfshirë prokuroren nga Prokuroria Themelore, përfaqësues policor nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Njerëz, si dhe përfaqësues nga Shërbimi Sprovues dhe Mbrojtja e Viktimave.

Gjatë ligjëratës u diskutua për format e trafikimit me njerëz, mënyrat e identifikimit të rasteve, mekanizmat e mbrojtjes dhe rëndësinë e raportimit, duke u ofruar nxënësve njohuri të qarta dhe të dobishme për mbrojtjen e tyre personale dhe sociale.

Ky aktivitet kontribuoi në rritjen e vetëdijes së të rinjve për rreziqet e trafikimit me njerëz dhe në forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional për parandalimin e kësaj dukurie në nivel lokal.



“RifatGjota” Pejë

- Numri i pjesëmarrësve: 38 (7 gra, 1 burrë, 10 vajza, 20 djem)

➤ **Aktiviteti 16: Ligjërata informuese për parandalimin e trafikimit me njerëz me nxënësit e klasës së 10-të**

➤ **Data: 12 nëntor 2025**

➤ **Vendi: Qendrën për Karrierë IAAP**

Pika 3.1.9 – Aktivitete informuese me nxënësit/et në shkollë, mbi trafikimin e grave, dhe vajzave

Në kuadër të fushatës vetëdijësuese kundër trafikimit me njerëz, Zyra për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës organizoi një ligjërata informuese me nxënësit e klasës së 10-të në Qendrën për Karrierë IAAP “RifatGjota” në Pejë. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me anëtarët e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje, Njësitin Anti-Trafikim dhe në koordinim me Drejtorinë e Arsimit në Pejë.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve relevante: prokurorja nga Prokuroria Themelore, përfaqësues policor nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Njerëz, përfaqësues nga Shërbimi Sprovues dhe Mbrojtja e Viktimave, si dhe një neuropsikiatër nga Qendra e Shëndetit Mendor.

Gjatë ligjëratës u diskutua për format e trafikimit, mënyrat e identifikimit të rasteve, mekanizmat e mbrojtjes dhe rëndësinë e raportimit, duke i ofruar të rinjve njohuri të vlefshme për parandalimin dhe mbrojtjen e tyre.

Ky aktivitet nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rolin e të rinjve në parandalimin e trafikimit me njerëz, duke kontribuar në ndërtimin e një sistemi të fortë mbrojtjeje dhe në sigurimin e një të ardhme më të sigurt për të gjithë qytetarët e komunës.



Paneliste: Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të të

Drejtave të Fëmijëve

- **Data: 20 nëntor 2025**
- **Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 44 (10 gra, 4 burra, 15 vajza, 13 djem)**

Komuna e Pejës, në bashkëpunim me Zyrën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim, Asamblenë Komunale të Fëmijëve, Drejtorinë për Administratë dhe Drejtorinë për Arsim, organizoi aktivitetin qendror me moton **“Barazi për çdo fëmijë”**, në kuadër të 20 Nëntorit – Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve komunale, mësimdhënës, psikologë, këshilli i nxënësve, këshilli i prindërve, si dhe vetë fëmijët, të cilët janë zëri dhe forca kryesore e

këtij qëllimi. Programi u hap me fjalimet përshëndetëse të Kryetarit të Komunës së Pejës, z. Gazmend Muhaxheri, Komandantit të Stacionit të Policisë në Pejë, z. Faik Jahmurataj, Drejtorit për Arsim, z. Naser Gega dhe Kryetarit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve, z. Arion Kuqi.

Nxënësit e shkollave të Pejës prezantuan një skeç të titulluar **“E Drejta Ime”**, ndërsa u shpërndanë mesazhe sensibilizuese mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve. Pjesëmarrësit morën pjesë në një debat të hapur mbi rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla, luftimin e dhunës dhe bullizmit, si dhe rolin e institucioneve në garantimin e të drejtave të tyre. Në kuadër të aktivitetit, në objektin e Kuvendit Komunal u vendos **“Kutia e të Drejtave të Fëmijëve”**, një hapësirë simbolike ku fëmijët mund të shprehnin mendimet dhe idetë e tyre. Ngjarja u përmbyll me lëshimin e balonave në Parkun “Ibrahim Rugova”, si shenjë e shpresës dhe përkushtimit për një të ardhme më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë fëmijët.

Në këtë aktivitet, Zyrtarja për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës, znj. Samka Drançolli, mori pjesë si **paneliste**, duke kontribuar në diskutimet mbi barazinë dhe të drejtat e fëmijëve.

Ky aktivitet theksoi përkushtimin e Komunës së Pejës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve çdo ditë dhe nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional në mbrojtjen e rinjve





- Aktiviteti 17: 25 Nëntor – Viktimat e moshave të ndjeshme dhe Fushata Globale “16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”
- Data: 25 nëntor 2025
- Vendi: Salla Bardhë, Hotel Dukagjini, Pejë
- Numri i pjesëmarrësve: 30 (20 gra, 10 burra)

Pika 2.5 – Sipas PLVDhF – Shënimi i 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Prokuroria Themelore në Pejë, Zyra për mbrojtjen e viktimave në Pejë, në mbështetje të misionit të OSCE-së, organizuan tryezë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, ku temë diskutimi me

theks të veçantë ishte “Dhuna ndaj viktimave të ndjeshme, të moshuar dhe të mitur” dhe zbatimi i Konventës së Stambollit. Panelistë ishin Kryeprokurorja e Prokurorisë Themelore të Pejës, znj. Lumturije Vuçetaj, udhëheqësi i Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave, z. Demë Hasanaj, koordinatoreja nacionale e veprave penale kundër dhunës në familje, prokurorja e shtetit, znj. Laura Pula, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë, Kolonal Shaban Shala, zëvendës-Kryeprokurorja Arlinda Nallbani Gacaferri, dhe përfaqësuesja e OSCE-së, znj. Yulia Safronova.

Gjatë tryezës, u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndër-institucional dhe mbështetjes nga misionet ndërkombëtare për trajtimin efikas të rasteve të dhunës në familje. Me pjesëmarrjen e rreth 40 zyrtarëve vendorë dhe ndërkombëtarë, u lëshuan tri video sensibilizuese për orientimin e qytetarëve drejt Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës dhe Zyrës për mbrojtjen e viktimave. Gjithashtu, u shpërndanë broshura informative për të drejtat e viktimave dhe kontaktet e Prokurorisë Themelore të Pejës.

Po ashtu, në kuadër të Fushatës Globale “16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, Qendra për Mirëqenien e Gruas, në bashkëpunim me Komunën e Pejës dhe me koordinimin e Zyrtares për Barazi Gjinore, znj. Samka Drançolli, vendosen një **panel të madh me mesazhe sensibilizuese**. Ky panel shërben si mjet ndërgjegjësimi për qytetarët mbi të drejtat, mbrojtjen nga dhuna dhe rëndësinë e raportimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Aktiviteti synon promovimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e komunitetit, duke forcuar bashkëpunimin ndër-institucional dhe atë me organizatat qytetare.

Tema globale e fushatës për këtë vit ishte “**BASHKOHUNI për t’i Dhënë Fund Dhunës Dixhitale ndaj të Gjitha Grave dhe Vajzave**”, e cila zhvillohet çdo vit nga 25 nëntori deri më 10 dhjetor, në përkujtim të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe Ditës së të Drejtave të Njeriut.





- Aktiviteti 18: 25 Nëntor – Përkushtim ndaj parandalimit të dhunës digjitale: Fushata “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”
- Data: 27 nëntor 2025
- Vendi: Hotel Palace, Mitrovicë
- Numri i pjesëmarrësve: 21 (20 gra, 1 burrë)

Pika 2.5 – Sipas PLVDhF – Shënimi i 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Në kuadër të aktiviteteve të Kolegjiumit të Zyrtarëve për Barazi Gjinore të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Zyrtarja për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës, znj. Samka Drançolli, përgatiti dhe prezantoi raportin mbi lansimin e fushatës “**16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore**”, me fokus te **dhuna digjitale ndaj grave dhe vajzave**. Kjo formë dhune shpesh mbetet e padukshme, prandaj ndërgjegjësimi dhe veprimi institucional janë të domosdoshëm.

Gjatë aktivitetit u evidentuan sfidat kryesore me të cilat përballen gratë dhe vajzat në hapësirën digjitale: ngacmimet, kërcënimet, përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe publikimi i paautorizuar i materialeve personale. U theksua rëndësia e mbështetjes institucionale, edukimit digjital dhe krijimit të mekanizmave të sigurt për raportim dhe mbrojtje.

Mesazhi kryesor ishte se **hapësira digjitale duhet të jetë vend i sigurisë dhe respektit, jo i frikës dhe dhunës**, dhe se institucionet duhet të bashkëpunojnë për të garantuar këtë.

Slogani i fushatës:

“Kur heshtim para dhunës, i japim asaj fuqi. Kur veprojmë, i japim fuqi njëra-tjetrës.”

Ky aktivitet reflekton përkushtimin e Komunës së Pejës dhe partnerëve institucionalë në promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës në të gjitha format e saj, duke përfshirë edhe dhunën digjitale.



1 Dhjetor – Radio Intervistë për “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”

Zyrtarja për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës, znj. **Samka Drançolli**, së bashku me **Ardita Balën**, Drejtoreshë e Qendrës për Mirëqenien e Gruas, morën pjesë në një intervistë në programin e mëngjesit me Veneren, në **Radio 1 FM**.

Gjatë bisedës u trajtuan temat kyçe:

- Situata e dhunës ndaj grave në komunën e Pejës;
- Sfidat në raportimin e rasteve të dhunës;
- Roli i institucioneve në mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave;
- Rëndësia e ndërgjegjësimit të qytetarëve për parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

Intervista shërbeu për të theksuar mesazhin e fushatës **“16 Ditët e Aktivizmit”**, duke u bërë thirrje qytetarëve: **“Dhuna nuk është çështje familjare – është çështje shoqërore. Barazia nuk është luks – është mbrojtje, dinjitet dhe jetë.”**

Ky aktivitet reflekton angazhimin e përbashkët të institucioneve dhe organizatave për mbrojtjen dhe fuqizimin e grave dhe vajzave, duke përforcuar mesazhet e ndërgjegjësimit dhe parandalimit të dhunës në komunitet.



- Aktiviteti 19: – Vizitë pune në Strehimoren e Pejës, Qendra për Mirëqenien e Gruas
- Data: 3 dhjetor 2025
- Vendi: Vizitë pune në Strehimoren e Pejës, Qendra për Mirëqenien e Gruas, Pejë
- Numri i pjesëmarrësve: 12 (9 gra, 3 burra)

Pika 2.5 – Sipas PLVDhF – Shënimi i 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Në cilësinë e **Zyrtares për Barazi Gjinore dhe Koordinatorës së Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore**, znj. **Samka Drançolli**, së bashku me anëtarët e Mekanizmit, realizoi një **vizitë pune në Strehimoren e Pejës – Qendra për Mirëqenien e Gruas/WomenWellnessCenter**, e dedikuar për gra dhe fëmijë.

Gjatë vizitës u zhvilluan aktivitete të vlerësimit dhe njohjes së shërbimeve:

- Takim me gratë dhe fëmijët që marrin mbështetje dhe siguri në strehimore;
- Vlerësim i punimeve të dorës të krijuara nga përfituesit, që reflektojnë forcë, durim dhe vullnet për rimëkëmbje;
- Diskutim mbi sfidat dhe nevojat reale të viktimave, për të përmirësuar reagimin dhe mbështetjen e koordinuar.

Kjo vizitë ka rëndësi të veçantë për Zyrën për Barazi Gjinore, duke mundësuar **monitorim nga afër të shërbimeve dhe veprimeve mbrojtëse**. Mesazhi kyç i aktivitetit është: **asnjë viktimë e dhunës të mos mbetet e vetme**.

Shpreh mirënjohje të veçantë për Drejtoreshën e Strehimores dhe stafin për **bashkëpunimin, mikpritjen dhe profesionalizmin** e treguar çdo ditë.

Ky aktivitet reflekton angazhimin e Komunës së Pejës për të siguruar **mbrojtje, mbështetje dhe fuqizim për çdo grua dhe fëmijë**.



- **Aktiviteti 20: – Aktivitet edukues për parandalimin e dhunës dhe bullizmit në SHFMU “7 Shtatori”, Vitomiricë**
- **Data: 5 dhjetor 2025**
- **Vendi: SHFMU “7 Shtatori”, Vitomiricë, Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 30 (9 gra, 13 vajza, 8 djem)**

Pika 2.5 – Sipas PLVDhF – Shënimi i 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Zyra për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës, në koordinim me Drejtorinë për Arsim – Pejë dhe anëtarët e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore, organizoi një **aktivitet edukues me nxënësit e klasës së 6-të**, duke përfshirë edhe nxënës nga komunitete të ndryshme, në SHFMU “7 Shtatori” – Vitomiricë.


Aktiviteti përfshiu:

- **Shikimin e një filmi të metrazhit të shkurtër**, që trajton bullizmin dhe mënyrat e reagimit në situata të vështira;
- **Diskutim të hapur dhe të singertë** me nxënësit mbi dhunën, raportimin dhe kërkimin e ndihmës;
- Prezantimin e **rolit të secilit anëtar të Mekanizmit Komunal** dhe mënyrën se si ofrohet ndihmë për viktimat;
- **Skena praktike të improvizuara** nga nxënësit, psikologjia e shkollës dhe Zyrtarja për Barazi Gjinore, për të afruar mësimin me realitetin e tyre.

Ky aktivitet u mbështet nga **OSCE Mission in Kosovo**, partner kyç në forcimin e mekanizmave lokalë dhe promovimin e mjediseve të sigurta për fëmijët.

Zyrtarja për Barazi Gjinore dhe stafi i shkollës vlerësuan bashkëpunimin, profesionalizmin dhe përkushtimin e nxënësve dhe mësimeve, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe mbështetëse. Një falënderim i veçantë shkon për **psikologjen Ergita Zajmi**, për përzgjedhjen e filmit që pasuroi aktivitetin dhe diskutimin me nxënësit.

Ky aktivitet nxiti **ndërgjegjësimin, edukimin dhe fuqizimin e nxënësve** në trajtimin e dhunës dhe bullizmit, duke forcuar kapacitetet e komunitetit shkollor për t’u kujdesur për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve.





- **Aktiviteti 21:** – Aktivitetet edukuese në kuadër të fushatës “16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës në Bazë Gjinore”
- **Data:** 8 dhjetor 2025
- **Vendi:**
- **1.SHFMU “Lidhja e Prizrenit” – Pejë (klasa e 5-të)**
- **2.Shkolla “Asdreni” – Pejë - (klasa e 5-të)**
- **Numri i pjesëmarrësve:** 53 (13 gra, 25 vajza, 20 djem)

Pika 2.5 – Sipas PLVDhF – Shënimi i 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Në kuadër të fushatës globale “16 Ditët e Aktivizmit”, Zyra për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës, në koordinim me **Drejtoria për Arsim – Pejë** dhe anëtarët e **Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore**, zhvilloi aktivitet edukues në dy shkolla të komunës:

1. **SHFMU “Lidhja e Prizrenit” – Pejë (klasa e 5-të)**
2. **Shkolla “Asdreni” – Pejë**

Aktiviteti përfshiu:

- Shikimin e **filmit sensibilizues** mbi bullizmin dhe reagimet e duhura ndaj dhunës;
- **Diskutime të hapura** mbi raportimin e rasteve të dhunës dhe respektin për njëri-tjetrin;
- **Improvizime praktike** nga nxënësit, psikologet, Zyrtarja për Barazi Gjinore dhe anëtarët e Mekanizmit Komunal, duke demonstruar mënyrat e trajtimit të rasteve dhe rëndësinë e bashkëpunimit për një ambient të sigurt dhe mbrojtës për fëmijët.

Aktivitetet u zhvilluan në një atmosferë të ngrohtë dhe mbështetëse, duke nxitur **kurajon, pjesëmarrjen aktive dhe reflektimin** e nxënësve mbi temat e dhunës dhe bullizmit.

Ky aktivitet u mbështet nga **OSCE Mission in Kosovo**, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe promovimin e mjediseve të sigurta për fëmijët.

Mesazhi kryesor: Çdo fëmijë meriton dashuri, respekt dhe mbrojtje – stop dhunës!





- **Aktiviteti 22: – Promovimi i muralit “Stop Bullizmit” në ShFMU “RamizSadiku” – Pejë**
- **Data: 9 dhjetor 2025**
- **Vendi: ShFMU “RamizSadiku”, Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 6 (4 gra, 2 burra)**

Pika 2.5 – Sipas PLVDhF – Shënimi i 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Me iniciativën e **Zyrës për Barazi Gjinore të Komunës së Pejës**, në kuadër të fushatës ndërkombëtare **“16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës në Bazë Gjinore”**, është ndërmarrë një projekt edukativ për parandalimin e dhunës dhe bullizmit në ambientet shkollorë, përmes realizimit të muraleve me mesazh sensibilizues.

Ky projekt është realizuar në koordinim me **Drejtorinë për Arsim – Pejë** dhe me **mbështetje financiare nga OSCE Mission in Kosovo**, dhe ka për qëllim promovimin e vlerave të respektit, barazisë gjinore, sigurisë dhe mirëqenies së fëmijëve në shkolla, si masa parandaluese kundër dhunës në bazë gjinore dhe bullizmit.

Aktiviteti i parë në kuadër të këtij projekti është realizuar në **ShFMU “RamizSadiku”**, ku është promovuar murali me mesazhin **“Stop Bullizmit”**. Në realizimin e muralit kanë kontribuar drejtoresha e shkollës, psikologja, arsimtari i artit dhe nxënësit, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të komunitetit shkollor dhe duke krijuar një ndjenjë përgjegjësie të përbashkët për ndërtimin e një mjedisi shkollor të sigurt dhe gjithëpërfshirës. Ky aktivitet ka shërbyer si mjet edukues dhe simbolik për vetëdijesimin e nxënësve mbi rëndësinë e respektimit të diversitetit, barazisë dhe mosdhunës, si dhe ka përcjellë një mesazh të qartë institucional për tolerancë zero ndaj bullizmit dhe çdo forme të dhunës. Në kuadër të këtij projekti janë planifikuar realizimi i muraleve në **tri shkolla të Komunës së Pejës**, ndërsa **dy shkolla të tjera janë aktualisht në proces të realizimit**, me synim zgjerimin e ndikimit të kësaj nisme edukative dhe përf forcimin e kulturës së sigurisë dhe barazisë në institucionet arsimore.

Ky projekt përfaqëson një praktikë të mirë të ndërhyrjeve parandaluese në nivel lokal dhe kontribuon drejtpërdrejt në objektivat e Komunës së Pejës për promovimin e barazisë gjinore, mbrojtjen e fëmijëve dhe krijimin e mjediseve shkollore të sigurta dhe pa dhunë.



10
Takim
për

kundër
bazë



Dhjetor –
koordinues
forcimin e
mekanizmave
dhunës me
gjinore

Sot,
Barazi Gjinore e Komunës së Pejës, znj. **Samka Drançolli**, zhvilloi një takim të frytshëm me:

Zyrtarja për

- znj. **Delina Fico** nga **East-West Management Institute**,
- znj. **Besarta Breznica** – Zyrtare për Adresimin e Dhunës në Bazë Gjinore,
- znj. **Besa Shehu** – Drejtore e Programit për Financa në **Kosova Women's Network**.

Diskutimi u fokusua në:

- Funksionimin e mekanizmit koordinues në komunë,

- Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional,
- Identifikimin e sfidave dhe mundësive për adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Ky takim përbën një hap të rëndësishëm drejt **përmirësimit të reagimit institucional**, rritjes së mbështetjes për viktimat dhe ngritjes së kapaciteteve të institucioneve për t’u përgjigjur në mënyrë efikase ndaj rasteve të dhunës me bazë gjinore.

Znj. Drançolli vlerësoi **angazhimin dhe profesionalizmin e pjesëmarrësve**, duke theksuar se bashkëpunime të tilla janë themel për ndërtimin e një **komuniteti më të sigurt dhe më të barabartë**.



- Aktiviteti 22: – Mbyllja e 16 Ditëve të Aktivizimit me shfaqjen “Këmisha e Lirisë”
- Data: 10 dhjetor 2025
- Vendi: Qendra Kreative Dukagjini, Pejë.
- Numri i pjesëmarrësve: 45 (10 gra, 20 vajza, 15 djem)

Pika 2.5 – Sipas PLVDhF – Shënimi i 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Në kuadër të **mbylljes së 16 Ditëve të Aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore**, dhe në shënim të **Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut**, Zyra për Barazi Gjinore e Komunës së Pejës organizoi shfaqjen teatrale “Këmisha e Lirisë” për nxënësit e shkollave të mesme, studentët e **Universitetit Haxhi Zeka**, anëtarët e Mekanizmit Komunal kundër Dhunës dhe pjesëmarrës të tjerë në **Qendra Kreative Dukagjini, Pejë**.

Shfaqja solli përpara tre histori reale dhe prekëse, duke theksuar rëndësinë e **mosheshtjes së dhunës dhe rolit të ndërgjegjësimit në komunitet**. Aktoret **Safete Rogova, Kumrije Hoxha dhe IgballeQena** transmetuan mesazhe të fuqishme mbi viktimat dhe nevojën për mbështetje aktive.

Ky aktivitet u realizua në koordinim me:

- **Drejtorja Arsimit Pejë,**
- Anëtarët e **Mekanizmit Komunal kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore,**
- **Kosova Women'sNetwork** për mbështetjen dhe mundësimin e shfaqjes.

Faleminderim i veçantë për aktoret, anëtarët e Mekanizmit dhe të gjithë pjesëmarrësit që kontribuan në përhapjen e mesazhit të fuqishëm kundër heshtjes dhe dhunës. Ky aktivitet përforcon **rolin e Komunës së Pejës dhe Zyrës për Barazi Gjinore në mbështetjen e viktimave dhe promovimin e barazisë gjinore** në komunitet.

Institucionet e përfshira: Komuna e Pejës, Qendra për Karrierë IAAP "RifatGjota" – Pejë, Shkolla e Mesme e Mjekësisë – Pejë.





- **Aktiviteti 23: – Promovimi i muralit “Stop Bullizmit”**
- **Data: 11 dhjetor 2025**
- **Vendi: Shkolla Sami Frashëri, Ozdrim– Pejë**
- **Numri i pjesëmarrësve: 35 (10 gra, 2 burra, 15 vajza, 10 djem)**

Pika 2.5 – Sipas PLVDhF – Shënimi i 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Me iniciativën e **Zyrës për Barazi Gjinore të Komunës së Pejës**, në kuadër të aktiviteteve sensibilizuese për parandalimin e dhunës dhe bullizmit në shkollë, është realizuar promovimi i muralit me mesazhin **“Stop Bullizmit”** në Shkollën **“Sami Frashëri” – Ozdrim**. Kjo nismë ka për qëllim promovimin e respektit, barazisë dhe sigurisë në ambientin shkollor, si elemente thelbësore për parandalimin e dhunës dhe bullizmit.

Aktiviteti është zhvilluar në koordinim me **Drejtorinë e Arsimit – Pejë** dhe me **mbështetje financiare nga OSCE Mission in Kosovo**. Një falënderim i veçantë i shkon OSCE Mission in Kosovo për mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e aktiviteteve sensibilizuese, si dhe drejtoreshës së shkollës, psikologes, arsimtares së artit dhe nxënëseve, të cilat me kreativitet dhe përkushtim e shndërruan muralin në një mesazh të fuqishëm kundër bullizmit.

Përveç kësaj shkolle, edhe një shkollë tjetër ndodhet në fazën përfundimtare të realizimit të muralit dhe pritet të promovohet së shpejti. Ky aktivitet dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të Komunës së Pejës, përmes iniciativave të Zyrës për Barazi Gjinore, për krijimin e shkollave të sigurta, të barabarta dhe pa dhunë.



- ✓ **Aktiviteti 24: – Promovimi i muralit “Stop Bullizmit”**
- ✓ **Data: 19 dhjetor 2025**
- ✓ **Vendi: Xhemaj Kada – Pejë**
- ✓ **Numri i pjesëmarrësve: (2 gra, 2 burra)**

burra)

Pika 2.5 – Sipas PLVDhF – Shënimi i 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

Gjatë vitit 2025, Zyra për Barazi Gjinore – Komuna e Pejës ka realizuar aktivitete sensibilizuese për parandalimin e dhunës dhe bullizmit në shkolla, në kuadër të të cilave është promovuar një mural me mesazh kundër bullizmit në SHFMU “Xhemajl Kada” në Pejë. Ky aktivitet është pjesë e një projekti që ka përfshirë tri shkolla në Komunën e Pejës.

Aktiviteti është zhvilluar në kuadër të iniciativës së Zyrës për Barazi Gjinore për krijimin e muraleve edukative në shkolla, me qëllim promovimin e respektit, barazisë dhe sigurisë në ambientin shkollor. Zbatimi i aktivitetit është realizuar në koordinim me Drejtorinë e Arsimit në Pejë, me mbështetje financiare nga OSCE Mission in Kosovo.

Në realizimin e aktivitetit kanë kontribuar drejtorja e shkollës, psikologja shkollore, arsimtarja e artit Melisa Ukshinaj, si dhe nxënëset e shkollës, të cilat përmes angazhimit dhe kreativitetit të tyre kanë përcjellë mesazhe të qarta kundër dhunës dhe bullizmit.

Zyra për Barazi Gjinore – Komuna e Pejës mbetet e përkushtuar në zbatimin e aktiviteteve parandaluese dhe edukative që synojnë ndërtimin e mjedisve shkollore të sigurta, të barabarta dhe pa dhunë.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

NJËSIA E INFORMIMIT PUBLIK

Nr.01 zyrtarisht

Data:15.12.2025

Arianit.demaj@rks-gov.net

zip-peje@hotmail.com

<http://kk.rks-gov.net/peje>

Për: Kryetarin e Komunës – Ing.Gazmend Muhaxheri

CC: Shefin e Kabinetit – Kastriot Belegu

Nga: Njësia e Informimit Publik në Pejë

Lënda: RAPORTI I PUNËS JANAR – DHJETOR - 2025

Njësia e Informimit Publik e Komunës së Pejës, më punën e vet më mediat dhe më opinionin publik angazhohet që të siguroi transparencën dhe kështu ta njoftoi opinionin më punën, efikasitetin dhe angazhimet e pushtetit lokal, që do të thotë inkurajimin e qytetarëve në vendimmarrje.

Njësia e Informimit Publik, e cila si angazhim primar ka përcjelljen e punës dhe të aktiviteteve të Zyrës së Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal (legjislativ) përkatësisht Këshillit të Drejtorëve dhe organeve të tyre gjatë këtij viti, që të kryejë më sukses funksionin e vetë si një zyrë efikase. Në këtë frymë kemi bërë përpjekje që të japim kontributin tonë në afirmimin dhe prezantimin e vendimeve të Kryetarit të Komunës, të Asamblesë dhe të Shërbimit Civil Komunal dhe zbatimin e tyre në favor të mirëqenies së të gjithë qytetarëve.

Njësia e Informimit Publik gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 pos punëve të zakonshme (rutine) vazhdimisht ka bërë azhurnim e Web-faqes me të dhënat më karakteristike për Komunën e Pejës, siç janë:

1. Njoftimet, raportet, takimet dhe vendimet nga Zyra e Kryetarit, Kuvendi dhe organet e tij,
